



STUDIME PASDIPLOMIKE – CIKLI I DYTË

DREJTIMI PENAL

TEZA:

**“Aspekti juridiko-penal i prostitucionit në Republikën e Maqedonisë së Veriut  
prej vitit 2016-2021”**

Mentor:

Prof.Dr. Ismail Zejneli

Kandidat:

Rudina Shaqiri

Tetovë, 2022

## **PËRMBAJTJE**

|                                                                       |           |
|-----------------------------------------------------------------------|-----------|
| <b>HYRJE.....</b>                                                     | <b>5</b>  |
| Lënda e hulumtimit.....                                               | 7         |
| Metodologjia e hulumtimit .....                                       | 8         |
| Qëllimi i hulumtimit .....                                            | 9         |
| <b>KAPITULLI I PARË.....</b>                                          | <b>10</b> |
| <b>TRAJTIMI SOCIOLOGJIK - KRIMINOLOGJIK I PROSTITUCIONIT.....</b>     | <b>10</b> |
| 1.1 Kuptimi i prostitucionit.....                                     | 10        |
| 1.2 Llojet e prostitucionit.....                                      | 11        |
| 1.2.1 Prostitucioni ritual.....                                       | 12        |
| 1.2.2 Prostitucioni religjioz.....                                    | 13        |
| 1.2.3 Prostitucioni kompensacional dhe substitucional .....           | 14        |
| 1.2.4 Prostitucioni profesional .....                                 | 15        |
| 1.3 Shkaqet e prostitucionit.....                                     | 19        |
| 1.4 Zhvillimi historik i prostitucionit.....                          | 211       |
| 1.4.1 Kodi i Hamurabit i referohet prostitucionit .....               | 21        |
| 1.4.2 Prostitucioni në Greqinë e Lashtë .....                         | 21        |
| 1.4.3 Prostitucionin sipas krishterizmit.....                         | 22        |
| 1.4.4 Prostitucioni në Romën e Lashtë .....                           | 24        |
| 1.4.5 Prostitucioni në Islam .....                                    | 25        |
| 1.4.6 Prostitucioni në mesjetë .....                                  | 266       |
| 1.5 Prostitucioni si fenomen bashkëkohor .....                        | 26        |
| 1.6 Me se lidhet lindja e prostitucionit?.....                        | 30        |
| 1.7 Konsumatorët e prostitucionit si subjekt i kësaj veprimtarie..... | 31        |

|                                                                                                                                                          |            |
|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------|
| 1.8 Raporti i prostitucioni me kriminalitetin.....                                                                                                       | 333        |
| <b>KAPITULLI I DYTË .....</b>                                                                                                                            | <b>355</b> |
| <b>KORNIZA JURIDIKE-NORMATIVE .....</b>                                                                                                                  | <b>355</b> |
| 2.1 Korniza juridike kombëtare që rregullon prostitucionin.....                                                                                          | 355        |
| 2.2 Prostitucioni në kuadër të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut.....                                                                       | 388        |
| 2.2. Cënimi i të drejtave universale të njeriut në ushtrimin e prostitucionit.....                                                                       | 399        |
| 2.3 Analizë komparative e rregullave të posaçme që shtetet e Europës zbatojnë mbi prostitucionin, në kuadër të relizimit të të drejtave të njeriut ..... | 41         |
| <b>KAPITULLI I TRETË .....</b>                                                                                                                           | <b>477</b> |
| <b>MBROJTJA JURIDIKE DHE E KOMPENSIMIT TË VIKTIMAVE TË PROSTITUCIONIT .....</b>                                                                          | <b>477</b> |
| 3.1 Të drejtat e viktimës.....                                                                                                                           | 488        |
| 3.1.1 E drejta për kompensim .....                                                                                                                       | 488        |
| 3.1.2 E drejta për person të autorizuar .....                                                                                                            | 488        |
| 3.1.3 E drejta e viktimës që të jetë e pranishme.....                                                                                                    | 488        |
| 3.1.4 Të informuarit në lidhje me të drejtat e saj .....                                                                                                 | 499        |
| 3.1.5 E drejta për të propozuar dëshmi të reja .....                                                                                                     | 499        |
| 3.1.6 E drejta për tu parashtruar pyetje dëshmitarëve, ekspertëve dhe të akuzuarve.....                                                                  | 499        |
| 3.1.7 E drejta për të arsyetuar kërkesën pronësoro juridike.....                                                                                         | 499        |
| 3.1.8 E drejta e përkthimit.....                                                                                                                         | 50         |
| 3.1.9 E drejta e mbrojtjes .....                                                                                                                         | 50         |
| 3.1.10 E drejta e gjyqimit në të cilin është përjashtuar publiku.....                                                                                    | 51         |
| 3.1.11 Trajtimi i viktimës pa e mëshiruar dhe me respekt.....                                                                                            | 52         |
| 3.2 Kompensimi i viktimave.....                                                                                                                          | 53         |
| <b>KAPITULLI I KATËRT.....</b>                                                                                                                           | <b>55</b>  |
| <b>ANALIZË PRAKTIKE E PROSTITUCIONIT .....</b>                                                                                                           | <b>55</b>  |

|                                                                                                        |           |
|--------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------|
| 4.1 Prostitucioni në Republikën e Maqedonisë së Veriut – Gjendja nga viti 2016 deri në vitin 2021..... | 55        |
| 4.2 Analizë e të dhënave të përfituara përmes metodës së anketimit .....                               | 57        |
| 4.3 Pengimi i prostitucionit.....                                                                      | 74        |
| <b>PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME.....</b>                                                                 | <b>77</b> |
| <b>SHTOJCA 1.....</b>                                                                                  | <b>80</b> |
| <b>BIBLIOGRAFIA.....</b>                                                                               | <b>83</b> |

## HYRJE

Prostitucioni paraqet një sjellje negative-devijante të shoqërisë e cila ndikon në çrregullimin e funksionimit normal të raporteve në mes të gjinive në shoqëri dhe si e tillë kjo dukuri konsiderohet e dëmshme dhe e papranueshme. Vetë prostitucioni ka të bëjë me dukurinë e marrëdhënieve seksuale kryesisht të personi i gjinisë femër me një numër të pacaktuar të personave të gjinisë mashkullore në këmbim të interesit financiar. Pra është një formë e eksploatimit seksual të gjinisë së kundërt, ku trupi i femrës shndërrohet në mall për shit-blerje.

Studiuesit socialë kanë argumentuar se lindja e prostitucionit lidhet, së pari, me përmbysjen e raporteve midis burrave e grave, pikërisht me kalimin nga e drejta amtare (matriarkati) në të drejtën atërore (patriarkati). Në thelb të këtij shndërrimi të madh, që shënoi disfatën e madhe historike të gjinisë femërore, lindi edhe prostitucioni si institucion. Gruaja humbi pozitën e vet të respektuar, u kthye në shërbëtoreshë, në skllave të epsheve të burrit. Kjo pozitë e poshtëruar e gruas shfaqet lakuriq sidomos te grekët, por edhe te romakët. Procesi i kalimit nga pushteti amtar në atë atëror ishte, njëherësh, procesi i krijimit të familjes monogame, e cila nuk kishte që në fillim pamjen që mori më vonë. Ajo nuk ishte aspak fryt i dashurisë seksuale midis burrit dhe gruas, siç nuk ishte as fryt i një marrëveshjeje me detyrime ndërsjella midis bashkëshortëve të lidhur në martesë. Monogamia u shfaq si shprehje e kontradiktës midis gjinive, pra si skllavërim i një gjinie nga gjinia tjetër, dukuri këto të panjohura në historinë e mëparshme. Familja (ende jo e shenjtë), ishte një, kombinim i sentimentalizmit dhe grindjeve shtëpiake. Ajo u shpik pikërisht për të karakterizuar një organizim të ri shoqëror, kryetari i të cilit ishte zot i gruas, i fëmijëve dhe i skllavëve.

Prostitucioni është një çështje e cili duhet trajtuar me kujdes dhe të mësuarit e tij nga studentët por edhe nga nxënësit, duhet të bëhet në formën e drejtë. Njerëzit duhet të marrin informacion sa më të plotë mbi këtë fenomen në studime dhe në jetën e përditshme. Por, nëse e marrim prostitucionin si pikënisje, me të mund të ngrejme një godinë të tërë shoqërore.

Përmes trajtimit të fenomenit të prostitucionit, në një pikëpamje apo në një tjetër, janë përmendur disa çështje filozofike-sociologjike mbi personalitetin, moralin (të mirën, të keqen, moralin, turpin), etikën, estetikën etj. Nga ana tjetër prostitucioni nuk është një çështje e izoluar, ndaj në këtë studim theksohen disa nga problemet e mprehta të kohës, duke filluar nga liria dhe standardet e saj, cilësia dhe kompleksiteti i marrëdhënieve njerëzore, interesat, komercializimi i

marrëdhëniet sociale, dhuna-antiteza e lirisë, familja dhe martesat, marrëdhëniet gjinore, seksualiteti dhe “rrymat” brenda tij ( nga kënaqësia te grykësia seksuale, homoseksualiteti, lesbizmi e shformimet seksuale), legjislacioni, shteti dhe religjioni.

Prostitucioni, si dukuri socio-patologjike, përveç se vetvetiu është i dëmshëm dhe i rrezikshëm, ka edhe një varg ndikimesh dhe lidhjesh të drejtpërdrejta në disa sjellje kriminale. Me prostitucion janë të lidhura një mori sjelljes kriminale, si vrasjet, mashtrimet, vjedhjet, plaçkitjet, dhunimet, nxitjet dhe joshjet në veprime amorale dhe perversione tjera të rinjve dhe të miturve. Në botën bashkëkohore theksohet se me dukurinë e prostitucionit është e lidhur ngushtë edhe marrja me shpërndarjen dhe shitblerjen e drogave dehëse, tregtia me robër të bardhë, shantazhet, kontrabanda, spiunazhi dhe veprime të tjera të ndaluara dhe kriminale. Në hulumtimet kriminologjike lidhur me lidhjen e prostitucionit me kriminalitetin, theksohet se të ashtuqujturat shtëpi publike, zakonisht paraqesin vendtubimet dhe tregjet më të njohura të grumbullimit të kriminelëve të njohur, bandave dhe grupeve të cilat organizohen dhe kryejnë një varg transaksionesh kriminale.

Prostitucioni në Republikën e Maqedonisë së Veriut ka qënë prezent në masë më të madhe pas vitit 1991. Kjo ka ardhur si pasojë e hyrjes në procesin e tranzicionit politik i cili ka ardhur si pasojë e ndryshimit të sistemit politik. Ky ndryshim erdhi bashkë me problematika të caktuara siç është rritja e disa fenomeneve kriminale të cilat erdhën bashkë me lirinë e zgjeruar me ardhjen e sistemit politik demokratik.

Një ndër veprimtaritë që lulëzoi në atë kohë ishte prostitucioni. Gjatë viteve 90-ta pati një zhvillim të këtij fenomeni, i cili vjen duke u rritur për të arritur kulminacioni gjatë viteve 2000. Metodat dhe veprimet e policisë duket se janë të pafuqishme për të luftuar këtë problem në rritje. Mungesa e profesionalizmit nga ana e disa oficerëve dhe përfshirja e vetë policisë në biznesin e prostitucionit janë dy nga shkaqet kryesore për këtë dështim. Pra, vërehet një rritje e vazhdueshme, siç mund të shihet edhe nga të dhënat e paraqitura më poshtë në këtë punim, prostitucioni vazhdon të ketë rritje deri në vitin 2003 duke u bazuar në numrin e personave të akuzuar për ndërmjetësim në korrupsion. Më pas vitit 2003 vërehet një rënie e dukshme dhe ky në të njëjtën kohë shënon edhe rritjen e luftës së shtetit kundër prostitucionit. Nga këto vite prostitucioni në RMV në një masë të caktuar është vendosur nën kontroll të shtetit, megjithatë

lufta kundër këtij fenomeni nuk është në nivelin e duhur sepse edhe më tej, gjatë gjithë periudhës pasardhëse gjejmë raste të kryerjes së kësaj veprimtarie.

Në literaturën kriminologjike, me të drejtë shtrohet pyetja se çfarë duhet ndërmarrë lidhur me pengimin e kësaj dukurie negative. Qysh në kohërat më të hershme, është shtruar problemi se a duhet të legalizohet apo duhet të ndalohet prostitucioni në një vend. Në këtë drejtim, edhe në teori edhe në praktikë të shteteve të ndryshme, ka patur zgjidhje të llojllojshme.

Autorët dhe mendimtarët të cilët janë për legalizimin e prostitucionit, parashtrojnë disa përparësi. Në rend të parë, prostitucioni i legalizuar mund të kontrollohet nga shteti. Kushtet dhe niveli shëndetësor e higjenik i shtëpive publike dhe prostituteve, në këtë mënyrë mund të jetë përherë në kontroll të institucioneve shëndetësore. Prostitucioni i legalizuar pengon përhapjen e sëmundjeve të ndryshme venerike dhe epidemive të tjera. Nga ana tjetër shteti ka interes të veçantë nga kjo veprimtari, sepse mbledh tatime dhe taksa që mund të përdoren për qëllime dhe nevoja sociale dhe humane. Po ashtu, legalizimi i prostitucionit ngushton rrethin e kyçjes së organizatave dhe grupeve kriminale në organizimin e prostitucionit.

Nga ana tjetër, kundërshtarët e legalizimit të prostitucionit, theksojnë se lejimi i tij është amoral, se kryerja e prostitucionit në mënyrë publike e nxit rininë në mosrespektimin e rregullave dhe normave morale të kontaktit në mes të gjinive dhe ndikon në dobësimin e interesimit të të rinjve për lidhjen e bashkësive martesore në mënyrë të rregullt dhe normale. Po ashtu legalizimi i prostitucionit, sipas këtyre është në kundërshtim me rregullat dhe normat morale e fetare, ngase prostitucion cenon nderin dhe dinjitetin e familjes. Lejimi i prostitucionit ndikon te të rinjtë që ata t'i preferojnë lidhjet dhe kontaktet seksuale në mënyrë të egër dhe të pakontrolluar, nga e cila mund të ketë pasoja të rënda familja edhe shoqëria.

### **Lënda e hulumtimit**

Ky punim shkencor në qendër të lëndës së hulumtimit e ka të vendosur fenomenin social-patologjik të prostitucionit. Fillimisht në këtë punim është hulumtuar mbi përkufizimin teorik-juridik të prostitucionit duke përfshirë këtu aspektet kriminologjike dhe sociologjike, faktorët të cilët kanë ndikuar në krijimin e tij, zhvillimi historik, faktorët bashkëkohor të zhvillimit të prostitucionit, efektet dhe pasojat negative të tij në shoqërinë bashkëkohore. Në këtë formë është arritur të sqarohen qartë të gjitha elementet përbërëse të kësaj veprimtarie.

Në objektin e hulumtimit të këtij punimi shkencor përfshihet edhe korniza juridike-ligjore e Republikës së Maqedonisë së Veriut e cila sanksionon këtë fenomen, duke analizuar normat e Kodit Penal nga aspekti juridiko penal, por jo vetëm. Sa i përket kornizës juridike, janë analizuar edhe normat e Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut, të cilat sanksionojnë liritë dhe të drejtat themelore të njeriut, të cilat në shumë raste cenohen nga zhvillimi i veprimtarisë së prostitucionit.

Në rradhë të tretë, në lëndën e hulumtimit të këtij punimi bën pjesë analiza që i bëhet subjektit pasiv të këtij fenomeni, viktimës së prostitucionit. Në këtë pjesë janë analizuar normat juridike, procedurale kryesisht, që mbrojnë të drejtat e viktimës në procesin e gjyqimit, por edhe të drejta e saj mbi kompensimin e dëmit që asaj i është kryer gjatë ushtrimit të veprimtarisë së prostitucionit.

Në lëndën e hulumtimit të këtij punimi përfshihet edhe analiza praktike e rasteve të prostitucionit në RMV. Aspekti praktik konsiston në analizë rasteve të gjyqimit të veprës penale Ndërmjeticim në kryerjen e prostitucionit në RMV për periudhën 2016-2021 dhe hulumtimin e prostitucionit me anë të metodës së anketimit.

### **Metodologjia e hulumtimit**

Përgjatë hulumtimit mbi fenomenin e prostitucionit kam përdorur disa metoda shkencore hulumtuese. Metodën e analizës dhe sintezës e kam shfrytëzuar për të hulumtuar fenomenin social patologjik të prostitucionit konkretisht, faktorët të cilët kanë ndikuar në krijimin e tij, zhvillimi historik, faktorët bashkëkohor të zhvillimit të prostitucionit, efektet dhe pasojat negative të tij në shoqërinë bashkëkohore, poashtu përmes analizës janë studiuar edhe normat juridike kombëtare dhe ndërkombëtare që sanksionojnë prostitucionin.

Një pjesë të madhe të hulumtimit e përfshin metoda kuantitative e anketimit përmes së cilës janë mledhur të dhëna mbi disa dimensione të prostitucionit me anë të së cilave kam qëllim të plotësoj njohuritë mbi fenomenin e prostitucionit. Me anë të këtyre të dhënave kuptohet qëndrimi i opinionit publik mbi këtë fenomen dhe duke e krahasuar me gjendjen aktuale mund të përcaktohen nevojat për ndryshim ose intervenim shtetëror për të kontrolluar këtë fenomen.



Metoda statistikore është shfrytëzuar për të grumbulluar të dhënat mbi rastet praktike të prostitucionit në RMV, konkretisht gjykimet që janë realizuar për veprën penale Ndërmjetësim në kryerjen e prostitucionit, për periudhën ndërmjet viteve 2016-2021.

### **Qëllimi i hulumtimit**

Ky hulumtim shkencor ka për qëllim që të vendos para lexuesit konceptin e qartë dhe të gjithëanshëm të prostitucionit së bashku me faktorët që ndikojnë në zhvillimin dhe parandalimin e këtij fenomeni. Në plan të parë është analizimi i prostitucionit në Republikën e Maqedonisë së Veriut për periudhën 2016-2021 po duke e krahasuar me rrethanat e ditëve të sotme. Gjatë hulumtimit të kësaj teme kam pasur qëllim që të nxjerr mangësitë e sistemit juridik dhe nevojat e angazhimit të shtetit dhe shoqërisë në parandalimin e zhvillimit të prostitucionit, në mënyrë që përmes sugjerimeve dhe rekomandimeve të jepet kontribut shkencor në trajtimin e fenomenit si dukuri negative e shoqërisë moderne.

## KAPITULLI I PARË

### TRAJTIMI SOCIOLOGJIK - KRIMINOLOGJIK I PROSTITUCIONIT

#### 1.1 Kuptimi i prostitucionit

Prostitucioni është një fenomen socio- patologjik i cili ka qënë i pranishëm në shoqërinë njerëzore për shumë kohë. Këtë e dëshmojnë edhe autorët të cilët theksojnë se prostitucioni ka qënë pjesë e shoqërisë që nga fillimet e saj. Një grup tjetër autorësh prostitucionin e konsiderojnë si mjeshtrinë më të lashtë të shoqërisë njerëzore. Është një pohim i vërtetë se prostitucioni e ka përcjellë shoqërinë njerëzore që nga fillimi deri në ditët e sotme, megjithatë duhet potencuar se kjo dukuri si për nga shkaqet e e krijimit po ashtu edhe për nga format e manifestimit prej fillimit deri në ditët e sotme ka kaluar nëpër transformime të mëdha, të cilat kanë ndodhur si pasojë e ndryshimeve të mëdha që kanë ndodhur në zhvillimin e shoqërisë njerëzore.

Prostitucioni paraqet një sjellje negative-devijante të shoqërisë e cila ndikon në çrregullimin e funksionimit normal të raporteve në mes të gjinive në shoqëri dhe si e tillë kjo dukuri konsiderohet e dëmshme dhe e papranueshme. Vetë prostitucioni ka të bëjë me dukurinë e marrëdhënieve seksuale të personi të gjinisë femërore me një numër të pacaktuar të personave të gjinisë mashkullore në këmbim të interesit financiar.

Përkufizimi i mësipërm i prostitucionit është një përkufizim i cili bazohet në faktin se vetëm femrat paraqiten si ushtruese të këtij fenomeni të cilat për qëllime fitimi ushtrojnë marrëdhënie seksuale me persona të gjinisë së kundërt. Megjithatë sot është e njohur që me prostitucion merren edhe personat e gjinisë mashkullore, sidomos në periudhën bashkëkohore, të cilët e ushtrojnë këtë veprimtari me gjininë e kundërt ose të njëjtë, me qëllim përfitimin financiar.<sup>1</sup>

Në ditët e sotme prostitucioni nuk është më një profesion ekskluziv i gjinisë femërore. Meshkujt janë të përfshirë në prostitucion jo vetëm si klientë prostitutash por edhe si ushtruesh të kësaj veprimtarie, dmth si ofrues të seksit në këmbim të parave. Në SHBA raporti meshkuj-

---

<sup>1</sup>Halili, Ragip, Kriminologjia, botimi i shtatë, Prishtinë, 2011, fq. 288-289

femra në ushtrimin e këtij profesioni ka ardhur duke ndryshuar. Studiuesit theksojnë se në qytetet e mëdha rreth 20% e atyre që ushtrojnë prostitucion janë meshkuj.<sup>2</sup>

Meqënëse prostitucioni i femrave ka qënë më masovik dhe më i shpeshtë, kur flitet për prostitucion, nënkuptohet prostitucioni femëror. Këtu duhet të bëhet dallimi i prostitucionit klasik nga homoseksualizmi ose siç mund të shprehet si formë e pederastisë, si formë e marrëdhënieve seksuale mes dy meshkujve dhe lezbianizmi si formë e marrëdhënieve seksuale mes femrave e cila njihet ndryshe si safo-dashuria. Është e rëndësishme të përmendet se personat të cilët merren me ushtrimin e kësaj veprimtarie, zakonisht janë persona me problematikë psikike, persona të cilët kanë probleme me jetëne tyre shpirtërore dhe seksuale. Personat të cilët merren me homoseksualizëm janë zakonisht indiferentë ndaj personave të gjinisë së kundërt dhe atë në mënyrë patologjike i tërheq kontakti me personat e gjinisë së njëjtë. Pra, siç konsiderohet ato kanë tërheqje në mes njëri tjetrit. Në përgjithësi theksohet se kjo formë e çrregullimit burimin e vet e ka tek çrregullimet psikologjike por edhe fizike-organike tek personat që merren me këtë formë të prostitucionit.<sup>3</sup>

## **1.2 Llojet e prostitucionit**

Kur bëhet fjalë për dukurinë e prostitucionit si faktor psiko-patologjik, zakonisht kuptohet forma e tij më e shpeshtë, dmth për prostitucionin profesional. Karakteristikë thelbësore e kësaj forme të prostitucionit është kryerja e marrëdhënieve seksuale në formë të zanatit, mjeshtërisë dhe punës së përhershme me qëllim të përfitimit, me qëllim të sigurimit të të ardhurave dhe ekzistimit të personit që ushtron këtë punë. Megjithatë, prostitucioni si veprimtari socio-patologjike është një veprimtari që duke u nisur që nga kohët e hershme dhe deri në ditët e sotme është ushtruar në forma dhe mënyra të ndryshme.

Në teorinë kriminologjike dhe studimet që janë realizuar mbi fenomenin e prostitucionit theksohen disa forma ose lloje të prostitucionit, ndër të cilat bëjnë pjesë: prostituicioni ritual, fetar, substitucional, pompensacional dhe ai profesional.

---

<sup>2</sup>Malaj, Nora & Sokoli, Lekë, “Probleme sociale bashkëkohore”, Tiranë, 2012, fq.221

<sup>3</sup>Halili, Ragip, Kriminologjia, botimi i shtatë, Prishtinë, 2011, fq. 289

### ***1.2.1 Prostitucioni ritual***

Sipas të dhënave teorike, prostitucioni ritual llogaritet si forma më e thjeshtë dhe më e lashtë e prostitucionit. Konkretisht, këtu nënkuptojmë fillesat e dukurisë së marrëdhënieve të para intime ndërmjet meshkujve dhe femrave, në momente dhe kohëra të caktuara. Sipas botëkuptimit të ambientit dhe sipas traditave dhe zakoneve të shoqërive të ndryshme, ka qënë rregull që kohë pas kohe, në momente të caktuara gjatë vitit apo periudhave më të shkurtëra kohore, në formë masovike femrat kanë qënë në kontakt seksual me meshkujt në mënyrë të pakufizuar dhe të pa penguar. Ky manifestim është shprehur në formë të ritualit apo një lloji aktiviteti ritual sipas të cilit femrat në një kohë të caktuar dhe në një vend të caktuar sipas traditave dhe zakonisht kanë pasur mundësi të kryejnë marrëdhënie me meshkujt të vendit ose të huaj. Në teori përmenden fenomene dhe dukuri të tilla ritual në vendet e Azisë si Kina, Tibeti, Mongolia, poashtu në Greqinë e Vjetër dhe në vendet afrikane. Në këtë mënyrë, historiani Herodoti, duke folur për disa dukuri në Babiloninë e lashtë dhe për Tempullin e Melitës, e cila ka qënë mbretëresha e dashurisë për babilonasit e lashtë, konstaton se në atë vend çdo vajzë dhe femër e re, e cila nuk ka qënë e martuar, një herë gjatë jetës së saj është dashur të shkojë në këtë tempull dhe aty të kryejë marrëdhënie seksuale me njerëz të panjohur.

Tempulli i Melitës ishte përkushtuar përëndisë së dashurisë në Babiloni. Ky rit, i kontaktit seksual të femrës me njerëz të panjohur, konsiderohej si veprim i dobishëm për femra të reja ngase kjo vërtetonte vlerën e tyre dhe aftësinë për të qënë të frytshme në jetën e martesës. Por sipas burimeve të vjetra, prostitucioni ritual konsiderohej si kryerje e një obligimi që çdo vajzë e pamartuar duhej ta përmbushte para martesës. Në realitet, mënyra më e "mirë" e kryerjes së zakonit të "deflorimit", ka qënë vajtja e femrave të reja në tempuj dhe kryerja e marrëdhënieve të para seksuale dhe kjo është konsideruar si plotësim i një obligimi ritual që ka dominuar në ato vende.

Zakonisht, vajzat e femrat e reja, pas këtij akti ritual janë konsideruar të afta të martohen dhe të krijojnë familje. Femrat dhe vajzat e reja, të cilat kanë vajtur nëpër tempuj, zakonisht kanë marrë dhuratë nga meshkujt me të cilët kanë pasur marrëdhënie seksuale. Kjo rrethanë i ka shtyrë disa autorë të konstatojnë se kontakti parë i femrave me të huaj nëpër tempuj, ka qënë një formë e fitimit të të mirave të caktuara me qëllim të përgatitjes së pajës se tyre për martesë. Prostitucioni ritual te disa popuj të lashtë është konsideruar edhe si një lloj flijimi i virgjinitetit të

femrave për nder të perëndive të ndryshme. Në Finiki, në Egjiptin e vjetër, në Kinë, në Tibet dhe në disa vende tjera, ka qenë zakon që sunduesit, aristokratët dhe njerëzit tjerë, t'i dërgojnë vajzat e tyre për një kohë të caktuar nëpër tempuj dhe pagoda, apo vende tjera të kultit, që të shërbejnë dhe t'u ofrojnë edhe marrëdhënie seksuale të huajve dhe kalimtarëve.

Marko Polo, një udhëpërshkrues nga Venediku i cili ka vizituar vendet e Lindjes së largët si Kinën, Mongolinë, Tibetin etj., thekson se në Tibet ishte zakon që asnjë mashkull të mos martohej me një femër të virgjër ngase ato nuk ishin verifikuar se janë të afta për dashuri. Femrat me përvojë seksuale kanë pasë vlerë dhe janë trajtuar si më të dobishme. Edhe Marko Pollo mendon se ky prostitucion ka pasur edhe qëllim të fitimit ngase kalimtarët dhe të huajt që kanë shfrytëzuar shërbimet seksuale të vajzave dhe femrave të reja nëpër tempuj e pagoda, është dashur t' u falin dhurata të ndryshme. Poashtu theksohet edhe konstatimi i Pollos se në këto vende ka qenë zakon që udhëtarëve dhe kalimtarëve, në shenjë respekti dhe mirëseardhjeje t'u ofrohen kontakte intime me femra të vendit. Këto kontakte nuk kanë pasur kurrfarë pasojash negative për personat të gjinisë femërore dhe mashkullore. Femrat e tilla, më vonë janë martuar dhe kane krijuar familje pa kurrfarë pengesash. Reliktet e një dukurie të tillë janë vërejtur deri vonë edhe në kohërat e reja, te fiset dhe grupet etnike të ndryshme, të cilat jetojnë në kushte të organizimit të njëjtë më ato të kohërave të lashta.<sup>4</sup>

### ***1.2.2 Prostitucioni religjioz***

Prostitucioni religjioz është i ngjashëm me prostitucionin ritual. Ai është festuar në marrëdhënie intime të femrave, të cilat kanë shërbyer nëpër tempuj dhe pagoda religjioze. Këto femra, përveç detyrave dhe shërbimeve të ndryshme, kanë ofruar edhe kontakte seksuale. Në burime të ndryshme të literaturës kriminologjike mbi prostitucionin religjioz, flitet se në disa vende të Lindjes së Mesme dhe të Largët, si dhe në Greqinë e vjetër, ka qenë praktikë që disa femra të betohen dhe t'i përkushtohën shërbimit si prostitutë në tempuj të ndryshëm religjiozë.

Kështu, në literature përmenden përmendoret dhe tempujt e famshëm të cilët u janë kushtuar femrave të njohura që kanë shërbyer si prostituta, p.sh.: tempulli i Artemidës në Efes, tempulli i Afërditës në Korint, tempulli i Dionisit në Spartë etj. Disa autorë, fillet e prostitucionit sakral ose religjioz i shohin nga kjo kohë. Për këto shërbime, femrat e tilla nuk kanë marrë

---

<sup>4</sup> Po aty, fq. 290

kurrfarë shpërblimi, ato kanë qenë të bindura se kryejnë veprime sakrale dhe janë në shërbim të perëndisë apo kultit të caktuar.

Në fillim, edhe kjo formë e prostitucionit ka qenë e hapur, publike dhe masovike. Më vonë, ky lloj i prostitucionit kufizohet dhe në masë të konsiderueshme, kryhet në fshehtësi brenda mureve të tempujve të tillë religjiozë dhe për kategori të caktuar të personave të gjinisë së kundërt. Ky zakon i prostitucionit religjioz në mesjetë dhe në kohën e feudalizmit, është keqpërdorur dhe është i njohur shpeshherë me emrin “e drejtë e natës së parë” të feudalit apo aristokratit me gruan ose me femrat e bujkrobërve apo të nënshtruarëve të tjerë të tij. Në këtë drejtim, sot flitet edhe për dukurinë e këtij prostitucioni në aktivitetin dhe jetën e disa sekteve fetare, të cilat shpeshherë punën dhe aktivitetin e vet e kushtëzojnë me kontakte të tilla intime etj.<sup>5</sup>

### ***1.2.3 Prostitucioni kompensacional dhe substitucional***

Prostitucioni kompensacional, gjithashtu është njëra nga format e kësaj dukurie negative. Manifestohet si marrëdhënie seksuale e femrave të martuara me meshkuj të tjerë për arsye: të jetës dhe marrëdhënieve të çrregulluara seksuale në martesë, për shkak të impotencës dhe frigjeditetit në bashkëshortësi ose për shkak të keqtrajtimeve dhe vrazhdësisë seksuale në martesë. Po ashtu, kjo formë e prostitucionit, sipas të dhënave në literaturë, kryhet edhe për shkak të mungesës së giatë të bashkëshortit apo partnerit, p.sh. për shkak të punësimit jashtë vendit, për shkak të qëndrimit në burg dhe në raste të tjera. Në të gjitha këto raste, marrëdhëniet intime paraqiten si një lloj kompensimi për shkak të mungesës së kontakteve normale mes bashkëshortëve dhe partnerëve seksualë.

Prostitucioni substitucional, sipas mendimeve në literaturë qëndron në marrëdhëniet intime të personave me partnerë tjerë si një lloj zëvendësimi i bashkëshortit apo bashkëshortes. Kjo dukuri ka të bëjë me situatat kur njëri nga bashkëshortët gjendet për një kohë të gjatë jashtë vendit apo me shërbim në armatë ose në mbajtjen e dënimit me burg. Kontakti intim seksual këtu zëvendëson partnerin substitucional, zakonisht nuk kanë për motiv interesin material, por në të dy këto forma të prostitucionit pra, si prostitucioni kompensacional ashtu edhe ai substitucional.

---

<sup>5</sup> Po aty, fq. 292

Kjo formë e prostitucionit ka qenë njohur që kohën e vjetër. Mirëpo, kjo nuk do të thotë se në rastet e caktuara, ky veprim nuk kryhet dhe për arsye materiale.<sup>6</sup>

#### ***1.2.4 Prostitucioni profesional***

Prostitucioni profesional është tipi dhe forma më e shpeshtë dhe më e përhapur e prostitucionit në shoqërinë bashkëkohore. Në të vërtetë, kur flitet për prostitucionin, zakonisht mendohet për këtë lloj të prostitucionit, pra për prostitucionin profesional. Prostitucioni si profesion, si mjeshtri, ka qenë i përhapur edhe më herët. Kësisoj, flitet për ekzistimin e kësaj dukurie në shtetet e vjetra antike. Kështu përmendet ekzistimi i shtëpive publike në Greqinë e vjetër, në kohën e Solonit. Këto shtëpi publike janë quajtur me emrin "Diktiron" dhe kanë qenë nën kujdesin e shtetit. Në shtëpitë e tilla publike, femrat si prostituta u kanë ofruar shërbime seksuale të interesuarëve.

Në fillim, me prostitucion të këtillë janë marrë skllavet ose femrat e zëna rob në luftërat pushtuese e më vonë edhe vetë qytetarët grekë. Mirëpo, më vonë prostitutat sikurse edhe klientët e tyre, kanë qenë të shtresave të ndryshme, prej atyre më të ulta deri ato më të larta. Në Greqinë e vjetër, prostitutat që kanë rrjedhë prej shtresave të ulta quheshin **perepatetiket**, ndërsa ato që rridhnin prej shtresave të mesme, më tepër trajtoheshin si këngëtare dhe si zbavitëse të meshkujve. Ato quheshin: **auletride** ose këngëtare dhe zakonisht ishin të huaja. Përveç këtyre janë të njohura edhe prostitutat që quheshin **kojklidijna**, të cilat ishin skllave dhe shërbenin për nevoja intime të personave të pasur nëpër shtëpia. Ndërsa prostitutat më të shtrenjta dhe më me renome ishin ato që quheshin **hetere**. Ato shoqëroheshin me njerëz në pushtet, me filozofë dhe shkrimtarë dhe atyre ju ofronin shërbime seksuale dhe shërbime tjera dhe për këtë arsye konsideroheshin edhe si metresa. Në këtë drejtim, theksohet hetere prostituta të klasës më të lartë dhe me ato janë zbavitur filozofët dhe burrështetasit e njohur grekë si Platoni, Aristoteli etj.

Në Romën e vjetër, gjithashtu ka patur shtëpi publike të cilat janë quajtur me emrin **Lupanorium** ku kanë shërbyer femra të ndryshme si prostituta. Edhe këtu ka ekzistuar prostitucioni profesional. Normat e para që rregullojnë ushtrimin e kësaj dukurie hasen në kohën e sundimit të perandorit Augustian. Femra e cila në atë kohë ka pasur dëshirë ta ushtrojë prostitucionin, është dashur të marrë leje të veçantë e cila është quajtur **Licentia stupri**, ndërsa

---

<sup>6</sup>Po aty, fq. 293

nëpunësi shtetëror që ka ushtruar kontroll mbi këtë veprimtari është quajtur **Edil**. Ky ka mbikëqyrur vendet apo shtëpitë publike ku ushtrohej kjo mjeshtri. Femrat romane të cilat merreshin me prostitucion, ndaheshin në të regjistruara ose "**meretrices**" dhe në ato të paregjistruara ose "**prosatibula**". Prostitutat e paregjistruara ndiqeshin nga Edili dhe atyre u ndalohej ushtrimi i kësaj veprimtarie nëpër shtëpi publike. Për këtë arsye, ato këtë e bënin nëpër shtëpi private, lokale të mbyllura, në rrugë dhe vende tjera. Prostibulet ose prostitutat e paregjistruara ndaheshin në prostituta "delikate" dhe në ato "famose". Që të dy këto kategori rekrutoheshin nga shtresat më të larta dhe zakonisht ato u ofronin shërbime personave në poste të larta ose filozofëve, artistëve dhe njerëzve publikë. Për këtë arsye, këto krahasohen me "heteret" greke. Mirëpo prostitutat e paregjistruara në Romën e vjetër degëzoheshin në shumë kategori dhe emërtoheshin varësisht, nga shtresa nga e cila vinin, mënyra e ushtrimit dhe nga vendi ku e ushtronin prostitucionin.

Në vijim do të përmenden disa nga këto. Prostitutat që reklamoheshin lakuriq, quheshin "**doris**", ndërsa ato që bredhnin nëpër lulishte, kopshte, fusha e vende të tjera në natyrë quheshin "**lupea**" ulkonja, të cilat i grishnin klientent me ulurima të ngjajshme me ato të ulkonjës. Prostitutat që bridhnin dhe silleshin rreth varrezave dhe aty ofronin shërbime seksuale quheshin "**basturije**", ndërsa ato që bridhnin rrugëve quheshin "**scarta erotica**" ose rrugaçe, ato që rrinin nëpër kafiteri e bujtina quheshin "**blitidae**", ato që plaçkitnin dhe i vidhnin klientët e tyre quheshin „**galina**" dhe në fund, ekzistonte kategoria më ulët në hierarkinë e prostitutave, e cila quhej "**quadrantariae**", e cila ofronte shërbime më të lira. Dukuria e prostitucionit në Romën e vjetër ka qenë shumë e përhapur, jo vetëm ndër shtresa të ulëta por edhe ndër qarqe të larta. Në literaturë përmenden shumë mbretër, perandorë, senatorë dhe personalitete të larta që kanë bërë jetë të shfrenuar ku edhe shumë prej tyre kanë jetuar me prostituta por edhe gratë e tyre gjithashtu janë marrë me prostitucion dhe jetë të lirë.

Në mesjetë, problemi i prostitucionit dhe shtëpive publike ka patur një trajtim tjetër. Sidomos pas inaugurimit të sistemit kishtar dhe religjioz, shtëpitë publike dhe prostitucionit nuk toleroheshin, ndërsa femrat të cilat merreshin me këtë veprimtari, u nënshtroheshin ndjekjeve e persekutimeve dhe trajtoheshin si delikuentë. Në mesjetë, e veçmas gjatë dominimit të pushtetit religjioz, dukuria e prostitucionit, publikisht është gjykuar dhe shpallur si veprimtari e dëmshme, mirëpo faktikisht, ajo ka ekzistuar dhe është toleruar. Në fazën e hershme të krishterizmit, kodet



religjioze, formalisht ndalojnë ushtrimin e prostitucionit në menyrë publike. Posaçërisht janë ndaluar priftërinjtë dhe murgjët që të kenë kontakte me prostituta që kanë shërbyer nëpër manastire dhe objekte të tjera fetare. Mirëpo, sipas të dhënave nga literatura kriminologjike mbi historinë e prostitucionit, del se edhe priftërinjtë dhe murgjët e ndryshëm në regjione të caktuara kanë shfrytëzuar shërbimet e prostitutave dhe se shumë prej tyre kanë jetuar edhe në marëdhënie të konkubinatit me prostituta. Në këtë kohë, paraqitet edhe lëvizja e njohur me emrin "Nikolinet", e cila angazhohej për lirinë seksuale të priftërinjve dhe të drejtën e tyre që të martohen ose të kenë kontakte me femra, qofshin edhe prostituta. Për këtë arsye, filozofi i njohur kishtar Shën Augustini, mendon se prostitucioni duhet të lejohet për disa kategori të besimtarëve, duke gjykuar tradhtinë në martesë, sidomos atë të gruas. Ndërsa Jeronimi i shenjtë, e pranon praninë e prostitucionit në kohën e tij dhe shpreh gatishmëri prostituteve tua fal mëkatet nëse ato pendohen. Në këtë drejtim, përmendet rasti prostitutës njohur Maria Magdalena, së ciles iu falen mekatet për shkak të marrjes me prostitucion.

Në kohën e krishterizmit të hershëm bizantin, prostitucioni ishte profesion i pranuar. Autori Efiënriques, përmend shembullin e perandorit Justinijan, ligjdhënësit rënë të shquar të asaj kohe, i cili ishte i martuar me Teodorën, e cila rënë parë kishte qenë prostitutë notore. Gjatë shekullit XV dhe XVI në disa shtete të Evropës, nga disa priftërinj dhe qarqe kishtarë kritikohej dhe shkruhej për dukurinë e prostitucionit nëpër manastire të femrave dhe të meshkujve. Në literaturë përmenden raste të letrave që u janë dërguar autoriteteve më të larta të kishës për dukuritë e pranisë së prostitucionit dhe shfrenimeve të ndryshme nëpër manastire dhe tempuj të tjerë religjiozë. Kështu, citohet rasti i letrave që një prift bashkëkohës i Martin Luterit me emrin Johan Giler, i cili me rastin e një celebrimi fetar ka deklaruar se "më me dëshirë do ta dërgonte motrën e vet të shërbejë në shtëpi publike se sa ta dërgonte në ndonjë manastir të shërbente si murgeshë prostitute."

Më vonë, në formacionet tjera shoqërore ekonomike, prostitucioni, si dukuri socio-patologjike vjen dhe përhapet gjithnjë e më tepër, ashtu që kjo dukuri negative haset gati në të gjitha sistemet shoqërore me të gjitha pasojat që sjell me vete. Në literaturën kriminologjike, theksohet se prostitucioni si dukuri negative, është një sëmundje sociale që është e përhapur në përmasa të mëdha. Ajo manifestohet në mënyra të ndryshme e posaçërisht në mënyrën e organizuar dhe e cila zakonisht është e lidhur edhe me kriminalitet. Sipas të dhënave në

literaturë, prostitucioni, si dukuri socio-patologjike përfshin një numër të madh të të rinjve dhe të rejave të cilat si burim themelor të ekzistencës e kanë marrjen me prostitucion.

Prostitucioni, në botën bashkëkohore, zakonisht organizohet nëpër shtëpi publike ose, si shpeshherë i quajnë, "shtëpi të dashurisë" ose "klube të natës". Prostitucioni, është duke u manifestuar dhe zhvilluar në botën bashkëkohore jo vetëm nëpër shtëpi publike por edhe nëpër klube të natës, kafe restorane, motele, lokale gjysmë të hapura dhe vende të tjera. Në këto lokale, mysafirëve dhe klientëve, përveç shërbimeve të rregullta u ofrohen edhe shërbime intime dhe seksuale. Nëpër këto lokale dhe klube, shpeshherë femrat të cilat shërbejnë si prostituta janë të kyçura si kameriere, si zonja të dhomave, si persona që ofrojnë shërbime të shoqërimit, masazhit, terapia biofizike apo psikofizike. Këto femra, në shikim të parë, nuk lënë përshtypje se janë prostituta, mirëpo ato merren me një prostitucion të veçantë. Organizatorët e klubeve të natës, kafe restoraneve, moteleve dhe lokaleve tjera që ofrojnë këtë mënyrë të zbavitjes, kanë fitime të mëdha, sepse në këto lokale dhe klube zakonisht kthejnë dhe qëndrojnë njerëzit afaristë, biznesmenë dhe persona të tjerë pasur, të cilët harxhojnë shuma të mëdha të hollash. Këto të holla, zakonisht i marrin në pjesën më të madhe pronarët e lokaleve të tilla ndërsa femrat prostituta marrin një përqindje të vogël.

Format e paorganizuara të prostitucionit, zakonisht kanë të bëjnë me prostitucionin i cili zhvillohet në lokalet private nëpër shtëpi dhe në mënyrë të fshehur dhe ilegale. I ngjashëm me këtë prostitucion është edhe i ashtuqujti prostitucion rrugë. Në këtë drejtim, disa qendra dhe qytete të mëdha botërore, sidomos metropolet, porte detare, ku gravitojnë dhe qarkullojnë një numër i madh i njerëzve nga shtetet e huaja nëpër rrugë paraqiten femra të cilat ofrojnë shërbime seksuale me çmime shumë më të ulëta se sa në lokalet dhe shtëpitë publike. Në literaturën kriminologjike, lidhur me këtë problem flitet edhe për disa forma dhe lloje tjera të prostitucionit profesional dhe veçmas përmenden të ashtuquajturat prostitute të rangut të lartë, që zakonisht janë femra me bukuri të rrallë, me aftësi të veçantame të cilat për shërbimet të veta kërkojnë çmime të larta. Ato janë të pajisura me banesa dhe lokale të veçanta ose me apartamente të rregulluara në vendverime apo pushimore të njohura. Këto prostituta janë të shtrenjta dhe me to zbaviten zakonisht personat të cilët cilësohen si magnat dhe njerëz me kapital të madh.

Në literaturën kriminologjike, disa autorë, prostitutat bashkëkohore i ndajnë në disa grupe. Autori B. Retmann i ndan: prostituta të mitura, amatore, profesionale, rrugaçe, të harbuara

shpenzuara, të bulevardit, të martuara, të ndara ose të shkurorëzuara dhe kolgerla(callgirl). Ndërsa, autori tjetër W.Reckles, i ndan prostitutat në katër grupe: prostitutat e shtëpive publike, prostitutat sipas thirrjes, prostitutat e rrugës dhe prostitutat profesionale. Pa marrë parasysh këto dhe të dhënat tjera, është një e metë e madhe se në botën bashkëkohore, format dhe llojet e marrjes me prostitucion janë shumëfishuar dhe gjithnjë e më e vështirë është të flitet për ndonjë formë klasike të prostitucionit. Kjo për arsye se, tani aktivitetet lidhur me prostitucionin janë modernizuar. Ato kamuflohen nën firmën e një pune apo biznesi të cilin, gjoja, e kryejnë femrat e caktuara e në realitet fjala është për një lloj të veçantë të prostitucionit, të organizuar në mënyrën më perfide.<sup>7</sup>

### **1.3 Shkaqet e prostitucionit**

Lidhur me dukurinë e prostitucionit, shtrohet pyetja se cilat rrethana shoqërore dhe individuale e shkaktojnë atë. Nga rezultatet e kërkimeve empirike kriminologjike në botën bashkëkohore dhe nga të dhënat e statistikave policore dhe gjyqësore, del se faktorët të cilët e kushtëzojnë prostitucionin janë të shumtë dhe, deri diku, të ngjashëm me faktorët që kushtëzojnë edhe kriminalitetin në një vend. Në këtë drejtim, në rend të parë, si faktor theksohet gjendja e vështirë ekonomike dhe materiale, skamja, papunësia si dhe krizat ekonomike. Veçmas përmendet faktori i migrimit dhe lëvizies së madhe të popullësisë, në relacionet fshat-qytet si dhe vise të pazhvilluara për nga aspekti industrial. Edhe pse shoqëria realisht i urren femrat që merren me prostitucion, ajo në mënyrë indirekte mund të thuhet se edhe vet i prodhon ato. Prostitutat janë zakonisht femra të cilat në të shumtën e rasteve nuk kanë alternative tjetër për të ushqyer veten dhe familjen. Kryesisht papunësia dhe lufta për ekzistencë i shtyn këto femra të merren me këtë „profesion,,.

Disa autorë, duke trajtuar shkaqet e paraqitjes së dukurisë së prostitucionit, vërejnë se prostitutat, rëndomë rrjedhin nga shtresat e ulta shoqërore dhe nga regjionet rurale. Në pjesën më të madhe, sipas tyre, personat e gjinisë femërore të cilat merren me prostitucion, rrjedhin nga familjet e ardhacakëve. Në këtë drejtim, posaçërisht theksohet problem i papunësisë, mosadaptimit në mjedisin e ri, suksesi i dobët në shkollë, konfliktet në familje, ikja nga familja, rënia morale e familjes, nxitja dhe shtytja e femrave të mitura dhe të reja nga ana e prindërve ose

---

<sup>7</sup>Po aty, fq. 295

personave të tjerë të rritur. Kjo veçmas ka të bëjë me të ashtuqujturin prostitucion të femrave të mitura dhe të reja.

Disa autorë mendojnë se në paraqitjen e prostitucionit ndikojnë edhe vetitë individuale të personave, të cilët merren me prostitucion. Në kërkimet dhe hulumtimet të cilat janë bërë, theksohet se ndër personat që merren me prostitucion, vërehet prania e sëmundjeve të ndryshme psikike, si p.sh. prania e psikozave dhe çrregullimeve të tjera mentale. Zakonisht, theksohet, se këta persona janë inferiorë, ndërsa arsimimi dhe inteligjenca e tyre është në nivel të ulët ose nën mesatare. Ndërsa, në disa studime tjera theksohet se në raste të rralla, në mesin e prostitutave ka edhe femra që kanë inteligjencë të lartë dhe ngritje arsimore në një shkallë të konsideruar. Zakonisht, këto prostituta rrjedhin prej shtresave më të pasura në shoqëri.

Marrja me prostitucion, në shumë vende të botës, është e inkriminuar si sjellje e ndaluar, në disa vende, kjo veprimtari cilësohet si vepër penale, e në disa të tjera si kundërvajtje etj. Mirëpo, edhe në këtë drejtim, ekzistojnë dallime të konsiderueshme. Në pjesën më të madhe të vendeve kur trajtohet dhe rregullohet çështja e prostitucionit, vetë marrëdhëniet seksuale dhe intime të personave të gjinisë femërore me persona të gjinisë tjetër, nuk cilësohen si vepër penale ose si kundërvajtje. Në disa vende tjera, si kundërvajtje dhe veprim kriminal cilësohet vetëm kontakti dhe marrëdhëniet intime të femrave të cilat gjenden në martesë, ndërsa femrat tjera të lira nuk bëjnë sjellje kriminale. Po ashtu, në disa vende kontaktet dhe marrëdhëniet intime seksuale të personave të gjinive të ndryshme, mund të cilësohen si cenim i moralit, si shkelje e besnikërisë bashkëshortore, si një lloj ataku në familje, e jo si veprim delikuent dhe kriminal. Ndërsa, si sjellje delikuede kriminale, zakonisht cilësohet aktiviteti i cili manifestohet në marrjen me prostitucion në formë të profesionit, në formë të mjeshtrisë dhe zanatit. Si veprim kriminal, në këtë drejtim, posaçërisht konsiderohet organizimi i prostitucionit dhe krijimi vendeve, klubeve a lokaleve të veçanta me qëllim të fitimit dhe interesit material. Në disa vende, si formë e veçantë e aktivitetit kriminal lidhur me prostitucionin, konsiderohet edhe ndërmjetësimi ose nxitja a shtytja e personave të gjinisë femërore në prostitucion. Kjo, posaçërisht ka të bëjë me shtytjen dhe joshjen e personave të mitur për t'u marrë me këtë dukuri socio-patologjike.<sup>8</sup>

---

<sup>8</sup> Po aty, fq. 298

## 1.4 Zhvillimi historik i prostitucionit

Përkundër klisheve të vjetra, prostitucioni pothuajse nuk është aspak profesioni më i vjetër në botë. Kjo ndoshta do të ishte gjuetia dhe mbledhja, e ndjekur ndoshta nga bujqësia për ekzistencë. Prostitucioni ka ekzistuar në pothuajse çdo civilizim në tokë, megjithatë, duke u shtrirë mbrapsht në tërë historinë njerëzore të regjistruar, ai është trajtuar në mënyra të ndryshme ose ndaj tij ka pasur qasje të ndryshme, dmth nuk është trajtuar si prostitucioni i formës së sotme ose nuk është konsideruar si sjellje devijante ose vepër penale. Kurdoherë që ka pasur para, mallra ose shërbime të vlefshme për shkëmbim, dikush ka më shumë gjasa t'i shkelë ato për seks.

### 1.4.1 Kodi i Hamurabit i referohet prostitucionit

Kodi i Hamurabit u përpilua në fillim të mbretërimit të mbretit babilonas Hammurabi nga viti 1792 deri në vitin 1750 para Krishtit. Ai përfshin dispozita për të mbrojtur të drejtat e trashëgimisë së prostitutave. Përveç vejusha, kjo ishte e vetmja kategori e grave që nuk kishin ofruesit meshkuj. Kodi lexon pjesërisht:

*“Nëse një "grua e devotshme" ose një prostitutë ndaj të cilës babai i saj i ka dhënë një priqë dhe një vepër ... atëherë babai i saj vdes, atëherë vëllezërit e saj do të mbajnë fushën dhe kopshtin e saj dhe do të japin misër, vaj dhe qumësht sipas pjesa e saj ...*

*Nëse një "motër e një zot" ose një prostitutë merr një dhuratë nga i ati i saj dhe një vepër në të cilën është shprehur qartë se ajo mund ta disponojë atë ashtu siç dëshiron ... atëherë ajo mund ta lërë pronën e saj te kushdo që i pëlqen.”*

Në masën që kemi të dhëna për botën e lashtë, prostitucioni duket se ka qenë pak a shumë i kudondodhur.<sup>9</sup>

### 1.4.2 Prostitucioni në Greqinë e Lashtë

Në Greqinë e lashtë, si gratë ashtu edhe burrat merreshin me prostitucion. Fjala greke për prostitutë është porne (Gr: πόρνη), rrjedh nga folja pernemi (të shesësh). Fjala angleze pornografi, dhe rezultatet e saj në gjuhë të tjera, janë direkt derivate e fjalës greke pornē. Prostitutat femra mund të jenë gra të pavarura dhe ndonjëherë me ndikim. Atyre u kërkohet të

---

<sup>9</sup>“The history of prostitution”, artikull online, <https://www.thoughtco.com/history-of-prostitution-721311>

vishnin fustane të veçantë dhe duhej të paguanin taksa. Disa prostituta në Greqinë e lashtë, të tilla si Laisa ishin aq të famshme për shoqërinë e tyre sa edhe vet bukuria e tyre, dhe disa nga këto gra kërkonin shuma të jashtëzakonshme për shërbimet e tyre.

Soloni themeloi shtëpinë e parë të bordellove, gjegjësisht organizoi rrjetin e parë të njohur të shtëpive publike të Athinës në shekullin e gjashtë para Krishtit, në të cilat prostituonin vetëm skllave dhe jo edhe qytetaret e lira dhe me fitimet e këtij biznesi, ai ndërtoi një tempull kushtuar Afërditës Pandemos, perëndeshës së kënaqësisë seksuale. Shërbimet të cilat i ofronin këto prostituta ishin me shpenzime të shtetit. Në Qipro (Paphus) dhe në Korint, praktikohesh një lloj prostitucioni fetar, ku tempulli numëronte më shumë se një mijë prostituta.

Secila kategori e prostitutave kishte emrin e saj, kështu që kishte **prostituta bamirëse**, që punonin në natyrë (shtrirë), **perepatetiket** që takonin klientët e tyre ndërsa ecnin (dhe më pas punonin në shtëpitë e tyre) dhe **gefiridet**, të cilat punonin pranë urave. Në shekullin e pestë, Ateneo thotë se çmimi për këtë shërbim ishte 1 obole, e gjashta e dhrahmisë dhe ekuivalente me pagën ditore të një punëtori të zakonshëm. Fotografitë e rralla përshkruajnë se seksi kryhej në shtretër me mbulesa dhe jastëk.

Prostitucioni mashkullor ishte gjithashtu i zakonshëm në Greqi. Djemtë adoleshentë zakonisht e praktikonin atë, një reflektim i zakonit pederastik të kohës. Djemtë skllavë punonin në shtëpitë publike në Athinë, ndërsa djemtë e lirë që shisnin favoret e tyre rrezikonin të humbnin të drejtat e tyre politike si të rritur.<sup>10</sup>

#### ***1.4.3 Prostitucionin sipas krishterizmit***

Në studimin mbi prostitucionin, mund të jetë pikënisje për trajtimin e raportit midis tij dhe besimit fetar, një raport sa informues aq edhe konfuz e problematik. Në Bibël ka histori të jashtëzakonshme mbi prostitucionin, siç është ajo e Rahab, një prostitutë që shpëtoi Izraelin nga shkatërrimi; historia e Ozeas, profetit të urdhëruar për t'u martuar me një prostitutë"; historia e një prostitute që ulet në tavolinë me Jezusin (temë shumë e debatuar); deri te pohimi se prostitutat mund zënë vend në Mbretërinë e Zotit edhe përpara liderëve fetarë hipokritë.

Profecia e Ozesë, është libri sipas të cilit Ozea u martua me Gomerën, një lavire (prostitutë) dhe lindi një djalë me të, të cilin e quajtën Jezrahel, domethënë fryt i martesës dhe jo

---

<sup>10</sup>“The history of prostitution”, artikull online, [https://en.wikipedia.org/wiki/History\\_of\\_prostitution](https://en.wikipedia.org/wiki/History_of_prostitution)

i kurorëshkeljes. Por Gomera e braktisi Ozean, u bë përsëri prostitutë e më pas, edhe skllave. Ajo, tanimë nga lavirësia lindi edhe dy fëmijë të tjerë. Ozea mori vesh se ish-gruaja e tij, Gomera, ishte në shitje në një ankand skllevërish. Ai shkoi atje dhe e bleu gruan e tij dhe e çoi në shtëpi. Jo për ta pasur si skllave, por si grua, si të zonjën e shtëpisë. Kaq e madhe, e pabesueshme, ishte dashuria për të, madje ai ndryshoi edhe emrat e fëmijëve të gruas, pjellë e lavirësisë së saj. Vështirimi simbolik i kësaj historie biblike lidhet me atë që Ozea, pas kësaj historie, iu thotë njerëzve: Sa herë që ju (sikurse edhe unë), rendim në mënyrë të shfrenuar pas parasë (lakmia e pasurisë), pushtetit apo edhe kënaqësive të tepruara, ne prostituojmë kundër Zotit ose, thënë ndryshe, mëkatojmë e biem në krahët e djallit. Por Zoti na "blen" sërish jo me 15 para, por me Dashurinë e Tij, dhe na kthen në rrugën e mbarë për të jetuar jo si skllevër, por si bijtë e tij të denjë.

Simbolika e kësaj historie lidhet me Izraelin, me "prishjen fetare e politike të tij", njësoj si lavirësimi i Gomerës dhe kthimi i Gomerës te vetë Ozea. Edhe në trajtimin e prostitucionit (prishjes së gjithëmbarshtme), Bibla jep mësimin apo rrugëzgjdhjen: "Dashuria do të ngadhenjë".

Edhe pse mëkati i prostituimit dënohej, siç u tha më sipër, me "djegie së gjalli të prostitutës", Juda një ndër dymbëdhjetë "bijtë e Izraelit", fëmija i katërt i Jakobit, është pjesë e një "mësimi" personal mjaft të çuditshëm, që lidhet me prostitucionin. Juda shkoi në shtrat me një femër, të cilën e dinte prostitutë. Por, në fakt, ai kishte fjetur me të renë (nusen e djalit), Tamarën, e cila ishte maskuar si prostitutë. Tamara mbeti shtatzënë dhe kur Juda e mori vesh këtë, urdhëroi ta digjnin të gjallë. Kur vendimi po ekzekutohej, ajo i çoi fjalet të vjehrrit se kishte diçka për dhënë. Kjo "diçka", ishin pikërisht ato që i kishte dhënë "prostitutës" kur kishte shkuar me të. Kështu Tamara, pikërisht e reja e tij, i lindi dy fëmijë: Faresin dhe Zarën. Kaq i rëndë ishte mëkati i Juda-s! Një tjetër histori biblike thotë se një prostitutë me emrin Rahab, në gojën e së cilës janë fjalët-mesazh drejtuar dy klientëve të saj: "Zoti na do ju dhe mua, o mëkatarë. Dhe ai do që të pastrojë të gjitha mëkatet tona me gjakun e Krishtit". Prostitucioni mbijetoi e vazhdon të mbijetojë edhe në mijëvjeçarin e tretë pas Krishtit. Si shprehje e papërsosshmërisë së njeriut dhe e mëkateve të tij apo si një bashkudhëtar natyreshëm? Apo të dyja bashkë? Kjo mbetet për t'u verifikuar.

Kisha e sotme e vlerëson prostitucionin si një biznes që nuk mund të zhvillohet vetiu. Ajo ngul këmbë që shoqëria duhet të punojë, që në moshë të vogël me femrat veçanërisht, për edukimin dhe aftësimin profesional të tyre, që ato të mos e shohin prostitucionin si një zgjedhje të domosdoshme për mbijetesë. Ajo këmbëngul gjithashtu në edukimin e meshkujve, që në vegjëli, me idenë se njerëzit nuk janë pronë dhe se "blerja" e trupit të një femre është e papranueshme. Prostitucioni, sipas kishës, përçan jetën njerëzore dhe shëndetin e komuniteteve. Ndaj ne nuk mund të qëndrojmë pa denoncuar fuqinë dhe parimet që mbajnë gjallë prostitucionin, ndikimin e tij mbi jetën, familjen, komunitetin. Ne duhet t'i themi "jo" sistemit të shtypjes që zbatohet brenda tregut të seksit dhe si rrjedhojë e tij. Sikurse duhet të ofrojmë kujdes, ndihmë dhe deri mëshirë ndaj atyre që vuajnë pasojat e këtij rrjeti shtypës.<sup>11</sup>

Ndërsa Kurani është dërguar "për të udhëhequr njeriun në të gjithë lëmenjtë e jetës shpirtërore, trupore, personale dhe shoqërore". Nga gruaja kërkohet një ekuilibër harmonik mes nevojave shpirtërore e trupore. Por, në fushën e moralit, pranohet se "islami është më rigoroz dhe më puritan" se sistemet e tjera fetare.

#### ***1.4.4 Prostitucioni në Romën e Lashtë***

Prostitucioni në Romën e lashtë ishte i ligjshëm, publik dhe i përhapur. Por edhe pse i ligjshëm, prostitucioni në Romën e lashtë ushtrohej jashtë mureve rrethuese të qytetit. Edhe burrat romakë me statusin më të lartë shoqëror ishin të lirë të merreshin me prostituta të secilës gjini pa pasur mosmiratim moral, për sa kohë që demonstرونin vetëkontroll dhe moderim në frekuencën dhe kënaqësinë e seksit. Literatura latine shpesh u referohet prostitutave. Praktikrat e botës reale dokumentohen nga dispozitat e ligjit romak që rregullojnë prostitucionin. Mbishkrimet, veçanërisht mbishkrimet nga Pompei, zbulojnë praktikën e prostitucionit në Romën e Lashtë. Disa shtëpi publike të mëdha në shekullin e katërt, kur Roma po krishterizohej, duket se janë llogaritur si atraksione turistike dhe të cilat ndoshta ishin në pronësi të shtetit. Prostitutat luanin rol në disa kremtime fetare Romake, kryesisht në muajin Prill, në të cilin kryesonte perëndesha e dashurisë dhe pjellorisë, Venusi. Meqënëse prostitucioni ishte kaq i pranuar, prostitutat shpesh konsideroheshin si turp. Shumica ishin skllave ose ish-skllave. Prostitucioni pasqyron qëndrimet ambivalente të Romakëve ndaj kënaqësisë dhe seksualitetit.

---

<sup>11</sup>Malaj, Nora & Sokoli, Lekë, "Probleme sociale bashkëkohore", Tiranë, 2012, fq.216-218



Një prostitutë e regjistruar quhej **meretrix** ndërsa ajo e paregjistruar binte në kategorinë e gjerë të **prostibulave**. Kishte disa ngjashmëri midis sistemit antik romak dhe grek, por ndërsa Perandoria rritej, prostitutat shpesh ishin skllave të huaja, kapeshin, bliheshin ose rriteshin me qëllim prostitucioni. Kjo ndonjëherë bëhej nga "fermerë prostitucioni" në masë të madhe, ku rriteshin fëmijë të braktisur, dhe pothuajse gjithmonë rriteshin për t'u bërë prostituta. Skllavërimi në prostitucion ndonjëherë përdorej si një ndëshkim ligjor ndaj grave të lira kriminale. Blerësit u lejuan të blenin burra dhe gra për prostituim privat dhe nuk kishte asnjë sanksion moral të lidhur me blerjen e meshkujve nga një aristokrat mashkull.<sup>12</sup>

#### ***1.4.5 Prostitucioni në Islam***

Në shekullin e shtatë, profeti Muhamed deklaroi se prostitucioni është i ndaluar. Në Islam, prostitucioni konsiderohet mëkat dhe Abu Mas'ud Al-Ansari i atribuohet duke thënë: "I Dërguari i Allahut ndaloi marrjen e çmimit të një qeni, paratë e fituara nga prostitucioni dhe fitimet e një fallxhori". Sidoqoftë, skllavëria seksuale nuk konsiderohej prostitucion dhe ishte shumë e zakonshme gjatë tregtisë së skllavëve arabë gjatë Mesjetës dhe periudhës së hershme moderne. Gratë dhe vajzat nga Kaukazi, Afrika, Azia Qendrore dhe Evropa u kapën dhe shërbyen si konkubina në haremët e Botës Arabe. Ibn Battuta tha disa herë se atij iu dha dhe bleu skllave.

Sipas myslimanëve shiitë, profeti Muhamed sanksionoi martesën me afat të caktuar, të quajtur muta'a në Irak dhe sigheh në Iran, e cila sipas disa shkrimtarëve perëndimorë, thuhet se është përdorur si një mbulesë legjitimuese për punonjësit e seksit, në një kulturë ku prostitucioni është e ndaluar. Myslimanët sunitë, të cilët përbëjnë shumicën e myslimanëve në të gjithë botën, besojnë se praktika e nikah mut'ah u revokua dhe në fund të fundit u ndalua nga halifi i dytë suni, Umar. Shiitët i konsiderojnë të gjitha marrëdhëniet seksuale jashtë martesës (e vetmja nikah ose nikah mutah) si haram. Ashtu si Shiitët, Sunitët e konsiderojnë prostitucionin si mëkat dhe të ndaluar.<sup>13</sup>

---

<sup>12</sup>“The history of prostitution”, artikull online, [https://en.wikipedia.org/wiki/History\\_of\\_prostitution](https://en.wikipedia.org/wiki/History_of_prostitution)

<sup>13</sup> Po aty.

#### ***1.4.6 Prostitucioni në mesjetë***

Prostitucioni në Mesjetë ishte, ashtu si sot, kryesisht një institucion urban. Sidomos në Itali, qeveritë komunale bënë përpjekje për të dëbuar prostituta nga qytetet, por pa rezultat. Kërkesa ishte thjesht shumë e madhe, pasi jo vetëm burra të rinj të pamartuar, por burra me gra dhe madje anëtarë të klerit e konsideronin veten në nevojë. Shumë qytete u përpoqën të zgjidhnin problemin duke dëbuar prostituta në zona të caktuara të qytetit. Shpesh, këto lagje u kthyen në "botë të krimi" të lidhur me të varfërit dhe të padëshiruarit e qytetit, më të famshmet ekzistonin në Bolonjë. Vern Bullough jep një të dhënë interesante: rrugët me fjalën "trëndafil" në to, thekson ai, ishin me shumë gjasa të ishin caktuar për prostitucion gjatë mesjetës, pasi fraza "të këputësh një trëndafil" ishte një metaforë e zakonshme për aktin e punësimit të një prostitute.

Një tjetër kufizim pothuajse universal i vendosur për prostitutat i përkiste veshjeve që ata lejoheshin të vishnin. Në mënyrë që t'i veçonte ato nga gratë "e mira" dhe për të shmangur konfuzionin, kisha kërkoi që prostitutat të përvetësonin një lloj veshjeje të veçantë, të cilën secila qeveri e veçantë e qytetit lejohej të zgjidhte. Për shembull, në Milano veshja e zgjedhur ishte një mantel i zi, ndërsa në Firence prostitutat vishnin doreza dhe zile në kapele.<sup>14</sup>

#### **1.5 Prostitucioni si fenomen bashkëkohor**

Prostitucioni është një çështje e cila duhet trajtuar me kujdes dhe të mësuarit e saj nga studentët por edhe nga nxënësit duhet të bëhet në formën e drejtë. Njerëzit duhet të marrin informacion sa më të plotë mbi këtë fenomen në studime dhe në jetën e përditshme. Por, nëse e marrim prostitucionin si pikënisje, me të mund të ngrejme një godinë të tërë shoqërore.

Përmes trajtimit të fenomenit të prostitucionit, në një pikëpamje apo në një tjetër, janë përmendur disa çështje filozofike-sociologjike mbi personalitetin, moralin (të mirën, të keqen, moralin, turpin), etikën, estetikën etj. Nga ana tjetër prostitucioni nuk është një çështje e izoluar, ndaj në këtë studim theksohen disa nga problemet e mprehta të kohës, duke filluar nga liria dhe standardet e saj, cilësia dhe kompleksiteti i marrëdhënieve njerëzore, interesat, komercializimi i marrëdhënieve sociale, dhuna-antiteza e lirisë, familja dhe martesë, marrëdhëniet gjinore,

---

<sup>14</sup>"Prostitucioni në mesjetë", artikull online,  
[https://www.brown.edu/Departments/Italian\\_Studies/dweb/society/sex/prostitution.php](https://www.brown.edu/Departments/Italian_Studies/dweb/society/sex/prostitution.php)

seksualiteti dhe “rrymat” brenda tij ( nga kënaqësia te grykësia seksuale, homoseksualiteti, lesbizmi e shformimet seksuale), legjislacioni, shteti dhe religjioni.

Konkretisht, prostitucioni është një dëshmi e vunllnetit të shoqërisë dhe qytetërimit. Në të vërtetë duke shkruar për prostitucionin e kohëve dhe kulturave të ndryshme në relaitet kemi shkruar për qytetërimet e tyre. Sipas, Stefan Cvajg: “Do të ishte tërheqëse të shkruaje mbi historinë e fshehtë të disa prej shtëpive publike, kjo do të ishte një dokument thelbësor për qytetërimin e asaj periudhe, sepse ato përmbajnë të fshehta dhe mistere të çuditshme...”<sup>15</sup>

Profesioni më i vjetër në botë, prostitucioni, përfaqëson përveç tjerash edhe problemin më të vjetër social të shoqërisë njerëzore. Përgjatë historisë, asnjë shoqëri nuk i ka shpëtuar ballafaqimit me të. Por në ditët e sotme, prostitucioni, si dukuri e problem social, ka marrë përmasa të panjohura më parë. Sidomos trafikimi për në tregun e prostitucionit vazhdon të jetë një ndër plagët më të mëdha të shoqërisë së sotme. Por pse trafikohen femrat për prostitucion? Thjesht sepse prostitutat vullnetare nuk mjaftojnë. Ato plotësojnë diçka më pak se gjysmën e kërkesave të tregut. Pra, kërkesa për seks - ky është çelësi i problemit.

Pas viteve 90, prostitucioni ka qenë një ndër temat më të "nxehhta" dhe më të trajtuara. Për prostitucionin flitet e shkruhet pafundësisht. Shtypi e mediat punojnë me kapacitet të plotë, studiuesit, madje edhe shkrimtarët, bëjnë të tyren. Dy studiuese italiane, për shembull, Moroli dhe Sibona, në librin e tyre "Skllavet e Perëndimit", kanë dhënë plot histori të jetuara, dëshmi rrëqethëse të viktimave të prostitucionit, dëshmi të një bote barbare, pa dinjitet njerëzor e pa të drejta qytetare, dëshmi të një jete nga e cila, nganjëherë, siç thotë botuesi i këtij libri, vdekja përbën të vetmen rrugëdalje. Prostitucioni është, pra, një ndër dukuritë sociale më tragjike të tranzicionit paskomunist. Por ndërkaq, ai është më shumë i përfolur sesa i studiuar. Studimet empirike për prostitucionin mungojnë ose janë të dobëta e të pasakta.

Për më tepër, prostitucioni është parë njëanshmërisht. Ai është identifikuar me dhunën dhe, nga ky këndvështrim, duket sikur shkak i parë dhe i fundit i tij janë rrëmbyesit, trafikantët, dhunuesit deri vrasësit e femrave, të cilat gjithnjë janë vënë në rolin e viktimës. Dhuna, ana më e prekshme dhe, eventualisht, më e dënueshme e problemit, ka eklipsuar dhe errësuar anën tjetër të prostitucionit si profesion. Kjo njëanshmëri që konstatohet në konceptimin e problemit,

---

<sup>15</sup>Malaj, Nora & Sokoli, Lekë, “Probleme sociale bashkëkohore”, Tiranë, 2012, fq.212

reflektohet edhe në trajtimin e tij. Nëse prostitucioni do të identifikohet me dhunën, atëherë ai do të trajtohet jo si një problem social, por thjesht si një problem i rendit publik, me rivendosjen e të cilit prostitucioni normalisht duhet të zhduket. Përkundrazi, prostitucioni si profesion lulëzon më shumë atje dhe atëherë ku ka rend publik, siç është për shembull rasti i SHBA-së, Holandës e përgjithësisht i vendeve perëndimore.

Dhuna është njëra anë e medaljes me emrin prostitucion. Madje ajo ka të bëjë vetëm me rekrutimin e prostitutave. Por ky studim trajton shumë anën tjetër medaljes, aspekte të tjera të prostitucionit profesional dhe si i tillë prostitucioni është gjerësisht i panjohur, jo vetëm botën për shkencore, por edhe për publikun e gjerë.

Një numër i madh autorësh e kanë klasifikuar prostitucionin si profesionin më të vjetër të botës. Por, prostitucioni përgjatë historisë ka qënë objekt qëndrimesh të ndryshme. Madje edhe Krishti është kritikuar për tolerancë ndaj prostitucionit. Më vonë edhe kisha do të pranonte pashrnangshmërinë e mëkatit dhe prostitucionit, por këtë e pranon vetëm si mëkat. Më vonë reforma protestante do të parashikonte dënim "pa kushte" të prostitucionit.

Studiuesit socialë kanë argumentuar se, me gjithë mosmiratimin e religjionit, sidomos atij mysliman e të krishterë, prostitucioni ka lulëzuar thuajse në të gjitha kulturat. Prostitucioni ka zënë vend në shkencat sociale. Është folur e shkruhar për seksologjinë e prostitucionit, sikurse sociologjinë e psikologjinë e tij, etikën e moralin, filozofinë, madje edhe filozofinë politike e deri për teologjinë e prostitucionit.

Tregues i interesit shkencor për dukurinë e prostitucionit është jo vetëm vëllimi i madh informacionit për të, por edhe larmia e diversiteti i studimeve rreth tij. Një numër i madh autorësh kanë studijuar përhapjen që kishte prostitucioni në Athinë e në Greqinë antike, në Perandorinë Romake, në qytetërimin antik mesdhetar, në Perandorinë Bizantine, në Mesopotaminë e vjetër e kështu me radhë. Studiuesit socialë kanë analizuar gjithashtu prostitucionin në rajone, vende e kultura të veçanta. Në disa raste deri rolin e tij në vetë historinë e këtyre vendeve.

Me pak fjalë, prostitucioni është një dukuri e shtrirë në kohë e hapësirë. Ai ka ekzistuar përgjatë gjithë historisë, sikurse në të katër anët e globit. Por me gjithë literaturën e pafundme për këtë dukuri, të cilësuar si profesioni më i vjetër në botë, pak studime janë bërë për të

shpjeguar arsyet e vërteta se pse disa femra kryejnë pikërisht këtë profesion edhe jo një tjetër, sikurse janë bërë pak investigime direkte.

Sigurisht, hulumtimet për këtë dukuri nuk janë lehta. Vetë prostitutat, si rregull, nuk pranojnë të anketohen e të japin intervista. Skenat nuk zhvillohen sheshit, si në teatër. Më shumë mbizotëron prapaskena. Pra, nuk është e lehtë të bëhet një vëzhgim i drejtpërdrejtë sociologjik me qëllim studimi. Aq më shumë me një prostitucion të painstitucionalizuar. Megjithatë, çdo gjë është e mundur. Studimi në fjalë është pikërisht një investigim i drejtpërdrejtë.

Termi "prostitucion" vjen nga latinishtja dhe fjalorët që e zbërthejnë këtë fjalë kanë dhënë kuptimin e ofertës për të kënaqur dikë me interes, për të shitur diçka që nuk është destinuar për t'u shitur. Pra, të prostituosh do të thotë "t'ua ofrosh dëshirave të të tjerëve, me pagesë, atë që duhet ta mbrosh e ta ruash me xhelozë", ose t'iu japësh të tjerëve për të holla apo për çdo interes material, atë që, sipas primeve morale të një shoqërie, nuk mund të përbëjë objekt të fitimit.

Fjala "prostitutë" fitoi përdorim të zakonshëm nga fundi i shekullit XIX. Në botën antike, shumica e ofrueseve të seksit kanë qenë kurtizane, konkubina (dashnore që mbaheshin rregullisht), ose skllave, ndërsa për prostitutat e një lloji të veçantë përdoret termi "mantenuta" që, si rregull, janë vajza shumë të bukura nga paraqitja ose gejsja (përdorur sidomos nga japonezët).

Sipas një përkufizimi fare të thjeshtë, prostitucioni është shndërrimi i aktit seksual në një akt të zakonshëm shitblerjeje. Vetë prostitutat përfaqësojnë kështu një bashkësi femrash, që dalin në tregun e mallrave për të shitur apo për të dhënë me qira një mall specifik: aftësinë për seks. Në këtë treg vendosin të njëjtat rregulla, madje përdoret i njëjti fjalor si në një treg të zakonshëm mallrash. Flitet për çmim (ulje çnimi), për sasi ("kohë pune", frekuencë, herë) e cilësi (moshë, paraqitje, profesionalizëm), për klientë rasti e abonentë, për ndarje territori, për konkurrencë të lirë e jo të lirë, për treg të ligjshëm (atje ku ushtrimi i tij lejohet) dhe treg informal etj. Edhe këtu, si "rregullator" është ligji bazë i çdo tregu: oferta dhe kërkesa. Pra, prostitucioni ushtrohet nga një çift, si rregull bipolar, i bindet një "kontrate" nëpërmjet shkëmbilnit para-seks.

Studiuesit i kanë klasifikuar llojet e prostitucionit nga pikëpamja e angazhimit në punë dhe e rrethanave të punës. Angazhimi në punë lidhet me shpeshësinë e përfshirjes së një gruaje në prostitucion. Shumë femra janë përfshirë në prostitucion vetëm përkohësisht, pra pak herë

para se ta braktisnin atë, për një kohë të gjatë e përgjithnjë. Prostitutat "part-time" janë ato që, në mënyrë të parregullt, pranojnë para për seks duke plotësuar të ardhurat nga burime të tjera. Prostitutat e tjera merren vazhdimisht me këtë zanat duke nxjerrë prej tij pjesën më të madhe apo të gjitha të ardhurat.

"Rrethanat e punës" nënkuptojnë rrethanat e mjedisit të punës. Një prostitutë rruge e kërkon biznesin në rrugë. Një vajzë me telefon (call girl) kërkon klientët përmes telefonit dhe burrat shkojnë tek ajo ose vizitohen prej saj. Një prostitutë shtëpie punon një klub privat ose shtëpi publike.<sup>16</sup>

### **1.6 Me se lidhet lindja e prostitucionit?**

Studiuesit socialë kanë argumentuar se lindja e prostitucionit lidhet, së pari, me përmbysjen e raporteve midis burrave e grave, pikërisht me kalimin nga e drejta amtare (matriarkati) në të drejtën atërore (patriarkati). Në thelb të këtij shndërrimi të madh, që shënoi disfatën e madhe historike të gjinisë femërore, lindi edhe prostitucioni si institucion. Gruaja humbi pozitën e vet të respektuar, u kthye në shërbëtores, në skllave të epsheve të burrit. Kjo pozitë e poshtëruar e gruas shfaqet lakuriq sidomos te grekët, por edhe te romakët.

Procesi i kalimit nga pushteti amtar në atë atëror ishte, njëherësh, procesi i krijimit të familjes monogame, e cila nuk kishte që në fillim pamjen që mori më vonë. Ajo nuk ishte aspak fryt i dashurisë seksuale midis burrit dhe gruas, siç nuk ishte as fryt i një marrëveshjeje me detyrime ndërsjella midis bashkëshortëve të lidhur në martesë.

Monogamia u shfaq si shprehje e kontradiktës midis gjinive, pra si skllavërim i një gjinie nga një gjini tjetër, dukuri këto të panjohura në historinë e mëparshme. Familja (ende jo e shenjtë), ishte një, kombinim i sentimentalizmit dhe grindjeve shtëpiake. Ajo u shpik pikërisht për të karakterizuar një organizim të ri shoqëror, kryetari i të cilit ishte zot i gruas, i fëmijëve dhe i skllavëve.

Për të siguruar besnikërinë e gruas dhe, si rrjedhim, për të pasur atësi e trashëgimi të garantuar, burri vendosi mbi gruan pushtetin e vet të pakufizuar. Me familjen monogame, gjithsesi, thellësisht patriarkale, ne hyjmë në fushën e historisë së shkruar mbi familjen dhe,

---

<sup>16</sup>Malaj, Nora & Sokoli, Lekë, "Probleme sociale bashkëkohore", Tiranë, 2012, fq.220

bashkë me të, edhe në fushën e historisë së shkruar rrebi prostitucionin. Sidoqoftë, kemi të bëjmë me fakte që vlerësojnë praninë e prostitucionit 3-4 mijë vjet më parë. Nga ana tjetër, ky është një prostitucion elitar, që vjen prej luksit. Për shembull, në Jerusalemin e asaj kohe pranohej të kishte pasuri përrallore aq sa "ari dhe argjendi ishin si gurët e rrugës". Le të vijojmë më tej, në kërkim të origjinës së prostitucionit profesionist. Nga parashtrimi i mësipërm historik del se prostitucioni është zhvilluar në përpjesëtim të drejtë me shkallën e skllavërisë, sidomos të skllavërimit të gruas. Me qartësi të veçantë kjo është shfaqur te grekët, nga veçojmë Homerin, tek veprat e të cilit, gratë e reja që kapeshin në luftë, bëheshin viktime të epsheve të fitimtarëve. Krerët ushtarakë i zgjidhnin më të bukurat me radhë, pra sipas rangut të tyre. Gjithë Iliada është thurur mbi një grindje midis Akilit dhe Agamemnonit për një skllave të tillë. Bashkë me çdo hero, pak a shumë të shënuar të Homerit, përmendet edhe robinja e luftës me të cilën ai rron në tendën e vet dhe që, pas luftës, mund ta çonte në shtëpinë bashkëshortore, siç bëri Agamemnoni me Kasandrën (tek Eskili).<sup>17</sup>

### **1.7 Konsumatorët e prostitucionit si subjekt i kësaj veprimtarie**

Siç dihet, në tregun e mallrave, çdo shitje është njëkohësisht edhe blerje. Nga ky rregull nuk bën përjashtim as tregu i prostitucionit. Por për prostitucionin ekziston një standard i dyfishtë: një për ofruesit e seksit të shitur (prostitutat), një për kërkuesit e blerësit e tij, konsumatorët ose klientët. Por ndonëse vëzhgimet e të dhënave lidhur me profilin e klientëve të prostitutave thuhet se mungojnë, pranohet ndërkah se klientët e tyre janë shumë të ndryshëm për nga mosha, raca, klasa apo statusi social etj. Kështu, në një studim të kryer në Londër, vihet në dukje fakti se 50 për qind e klientëve ishin të martuar ose të lidhur në bashkëjetesë.

Mund të thuhet, gjithashtu, se edhe bota e prostitucionit është një botë në ndryshim. Ka ndryshuar dinamika e prostitucionit, (para)gjykimet e vlerësimit, morali i lidhur me të, qëndrimi zyrtar ndaj tij, sikurse format e shfaqjes, të realizimit (sjellja seksuale), të komunikimit, menaxhimit etj. Ka mbetur e pandryshuar vetëm nevoja mashkullore për seksin e paguar, ose ajo ka ndryshuar vetëm duke u rritur. Kjo është tema deri sot tabu (madje deri pak vite më parë edhe në botë), që do të përpiqemi ta zbërthejmë, sado që hulumtimi rreth klientëve të prostitutave

---

<sup>17</sup>Po aty, fq.230

është konsideruar mjaft i vështirë. Të hysh në jetën e tjetrit është gjithnjë një çështje jo e lehtë. Zakonisht edhe intervistat me klientët e prostitutave janë, në të shumtën e rasteve, plot tensione.

Pse me Prostitutat? Përgjigjja e kësaj pyetjeje ka të bëjë me sjelljen seksuale të njeriut, sidomos të meshkujve. Pra, duhet të njohim më mirë ideologjinë e nevojave seksuale të meshkujve, si dhe organizimin social të dëshirave të tyre. Prostitucioni nuk mund të kuptohet pa eksploruar "maskilizmin" në marrëdhënie me seksin e shitur dhe shërbimin seksual të prostitutave. Një shkak konsiderohet varësia nga seksi dhe seksomania. Bëhet fjalë për njerëz që detyrimisht të erotizojnë të gjitha reagimet e tyre. Një lloj shtypjeje që mposht kënaqësinë dhe replikon në infinit një seks anonim, në të cilin partneri është vetëm një instrument. Ajo që nxit seksomaninë është sidomos pornografia, e cila ka marrë një përhapje të shfrenuar, sidomos vitet e fundit, ku veç kujdesit që duhet të bëjnë familjet (kjo është e para), kërkohet edhe ndërhyrje e organeve të specializuara dhe institucioneve të tjera të shoqërisë. Klientët e prostitutave janë të të gjitha moshave, profesioneve, kategorive sociale, "all sorts of men". Për më tepër, të martuar e të pamartuar, në shumicën dërmuese meshkuj, por edhe gra.<sup>18</sup>

Jemi mësuar të konsiderojmë si subjekt të përfshirë në veprimtarinë e prostitucionit vetëm femrat që ofrojnë këtë shërbim (në të shumtën e rasteve janë viktimat dhe si të tilla konsiderohen edhe nga shkenca krimnologjisë) dhe personat të cilët marrin pjesë në organizimin e kësaj veprimtarie. Kjo ndodh edhe nga shkak se shumica e legjislacioneve vetëm ndaj këtyre dy kategorive i orientojnë sanksionet juridike. Por, një rol të rëndësishëm në këtë problematikë shoqërore luajnë edhe ato subjekte që blejnë këtë shërbim.

Shfrytëzuesit e këtyre shërbimeve duhet analizuar gjithashtu, duke ju dhënë një rëndësi të veçantë pozitës së tyre në zhvillimin e këtij fenomeni për shkakun se nga kërkesa e tyre bëhet i mundur realizimi i prostitucionit. Pozita e tyre duhet të analizohet edhe nga aspekti penal-juridik edhe nga aspekti krimnologjik.

Nga aspekti juridik penal, blerësit e shërbimeve seksuale paraqesin atë subjekt i cili përfshihet në mënyrë të drejtpërdrejtë në zhvillimin e kësaj dukurie dhe duke qënë subjekt aktiv, përgjegjësisë së tij mund t'i mvishet elementi i fajit dhe në këtë mënyrë ndaj tij mund të kërkohet

---

<sup>18</sup>Malaj, Nora & Sokoli, Lekë, "Probleme sociale bashkëkohore", Tiranë, 2012, fq.220



përgjegjësi penale. Në këtë formë e ka rregulluar Suedia prostitucionin, pra duke i mveshur përgjegjësi penale edhe personit i cili blen shërbimet e prostitucionit.

Nga aspekti kriminologjik veprimtaria e blerësve të shërbimeve seksuale është komponent i cili përfshihet në faktorët që nxisin rritjen e fenomenit të prostitucionit. Duke qënë se një ndër ndikimet që mund të bëjë shteti për uljen e kriminalitetit, sipas teorive kriminologjike, është të ul ose eliminojë faktorët që ndikojnë në rritjen e kriminalitetit. Nisur nga kjo, për uljen e këtij fenomeni dhe bashkë me të mënjanimin e efekteve negative që sjell ky fenomen, shteti duhet të sanksionoj edhe blerjen e shërbimeve që ofron prostitucioni.

### **1.8 Raporti i prostitucioni me kriminalitetin**

Prostitucioni, si dukuri socio-patologjike, përveç se vetvetiu është i dëmshëm dhe i rrezikshëm, ka edhe një varg ndikimesh dhe lidhjesh të drejtpërdrejta në disa sjellje kriminale. Me prostitucion janë të lidhura një mori sjelljesh kriminale, si vrasjet, mashtrimet, vjedhjet, plaçkitjet, dhunimet, nxitjet dhe joshjet në veprime amorale dhe perversione tjera të të rinjve dhe të miturve. Në botën bashkëkohore theksohet se me dukurinë e prostitucionit është e lidhur ngushtë edhe marrja me shpërndarjen dhe shitblerjen e drogave dehëse, tregtia me robër të bardhë, shantazhet, kontrabanda, spiunazhi dhe veprime të tjera të ndaluara dhe kriminale. Në hulumtimet kriminologjike lidhur me lidhjen e prostitucionit me kriminalitetin, theksohet se të ashtuqujturat kuarte me "llampa të kuqe" dhe "shtëpitë e dashurisë,,, zakonisht paraqesin vendtubimet dhe tregjet më të njohura të grumbullimit të kriminelëve të njohur, bandave dhe grupeve të cilat organizohen dhe kryejnë një varg transaksionesh kriminale. Makrot dhe mbrojtësit e prostitutave apo të shtëpive publike, zakonisht rekrutohen nga kriminelët e njohur. Ata janë kapadainj dhe persona me një karrierë të pasur kriminale. Në pjesën më të madhe, ata i takojnë së ashtuquajturës nëntokë kriminale. Zakonisht, prostitucionin e mbikqyrin dhe organizojnë sindikatat e veçanta, individët dhe grupet e kriminelëve të njohur, të cilët nëpërmes prostitucionit mirren me shitblerjen e drogave, tregtinë me femra dhe robër të bardhë, me tregtinë me të mitura dhe të reja si dhe me kryerjen e aktiviteteve tjera kriminale. Posaçërisht merren me organizimin e vrasjeve, kidnapimeve, terrorizmit dhe formave tjera të kriminalitetit të rrezikshëm. Nga gjithë kjo që u tha, deri më tani, mund të konkludohet se prostitucioni si dukuri socio-patologjike, është i dëmshëm dhe i rrezikshëm. Ai rrënon moralin shoqëror, nxit ndjenja

dhe veprime të ulta njerëzore, ndikon në shkatërrimin e marrëdhënieve familjare, në paraqitjen e shkurorëzimeve dhe sjelljeve të tjera të dëmshme lidhur me martesën dhe familjen. Po ashtu, prositucioni paraqitet si faktor i fuqishëm në nxitjen e sjelljeve paradelikuate dhe kriminale në shoqëri.<sup>19</sup>

---

<sup>19</sup>Halili, Ragip, Kriminologjia, botimi i shtatë, Prishtinë, 2011, fq. 293

## KAPITULLI I DYTË

### KORNIZA JURIDIKE-NORMATIVE

#### 2.1 Korniza juridike kombëtare që rregullon prostitucionin

Prostitucioni është rregulluar me normat e Kodit penal të RMV-së, konkretisht në Kapitullin “Veprat penale kundër lirisë dhe moralit gjinor”, neni 191 nën titullin Ndërmjetësimi në ushtrimin e prostitucionit, në të cilin shprehimisht thuhet:

*“(1) Ai i cili kobitë, shtinë, nxit apo mashtron person në prostitucion ose ai i cili në çfarëdo mënyre merr pjesë në dorëzimin e ndonjë personi tjetërkujt për të kryer prostitucion, do të dënohet me burgim nga pesë deri në dhjetë vjet burgim.*

*(2) Ai i cili për shkak të fitimit i mundëson tjetërkujt shfrytëzimin e shërbimeve seksuale do të dënohet me burgim prej 3 deri në pesë vjet.*

*(3) Ai i cili organizon kryerje të veprave penale nga paragrafët (1) dhe (2) apo veprat do t’i kryejë gjatë kryerjes së dhunës familjare, do të dënohet më së paku dhjetë vjet burgim.*

*(4) Nëse veprën nga ky nen e kryen personi juridik, do të dënohet me dënim me gjobë.*

*(5) Paluajtshmëritë të shfrytëzuara dhe sendet e përdorura për kryerjen e veprës penale, merren.”<sup>20</sup>*

Formë tjetër e kryerjes së prostitucionit, e mbrojtur me Kodin Penal të RMV-së, konkretisht neni 191-a është Prostitucioni i fëmijëve, në të cilin shprehimisht thuhet:

*“(1) Personi që rekruton, shtyn, nxit ose mashtron një fëmijë, që ka mbushur moshën 14 vjeç, për prostitucion ose ndërmjetëson, mëson ose merr pjesë në mësimdhënien e një tjetri me qëllim të prostitucionit, ose i lejon një tjetri*

---

<sup>20</sup> Neni 191, Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë së Veriut, Gazeta Zyrtare nr80/99, 4/2002 година, 43/2003; 19/2004; 81/2005; 60/06; 73/06; 7/08; 139/08; 114/09; 51/11; 135/11; 185/11; 142/12; 166/12; 55/13; 82/13; 14/14; 27/14; 28/14; 115/14 и 132/14

*të përdorë shërbimet e tij seksuale, ose ndryshe e përdor atë për veprimtari seksuale me qëllim të fitimit të pasurisë ose përfitimit tjetër, dënohet me burgim së paku katër vjet.*

*(2) Nëse vepra penale nga paragrafi (1) i këtij neni kryhet me përdorimin e forcës ose kërcënimit serioz për të sulmuar jetën ose trupin e fëmijës ose një personi të afërt me të, kryerësi dënohet me burgim së paku tetë vjet.*

*(3) Nëse vepra penale nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni kryhet ndaj fëmijës nën moshën 14 vjeç, kryerësi dënohet me burgim së paku dhjetë vjet.*

*(4) Një person që organizon kryerjen e akteve nga paragrafët (1), (2) dhe (3) të këtij neni, ose i cili i kryen veprimet gjatë kryerjes së dhunës në familje, dënohet me burgim së paku dhjetë vjet.”<sup>21</sup>*

Prostitucioni është pjesë e dukurive socio-patologjike nga e cila shoqëria njerëzore nuk mund të lirohet.

Në degën e së drejtës penale, prostitucioni është aktivitet i ndaluar edhe kjo ndodh për shumë arsye, ndër të cilat rradhiten:

- marrja me prostituim është në kundërshtim me rregullat morale dhe sociale të cilat janë të lidhura me dinjitetin njerëzor,
- ndër pasojat e prostitucionit janë bartja e sëmundjeve infektive,
- kur ndërpresin punën e tyre subjektet që merren me prostitucion bëhen barrë për shoqërinë, duke u bërë kështu raste sociale,
- prostitucioni ka influencë në zhvillimin e drejtë të shoqërisë.

Të gjitha këto bëjnë pjesë në arsyet pse shoqëria merr masa parandaluese dhe represive në pengimin e zhvillimit të kësaj dukurie negative. Në shumë nga shtetet e botës kjo dukuri nuk është legale megjithatë, vërehet një tolerance nga disa shtete.

Propaganda, shtytja dhe mashtrimi janë variantet e ndryshme të veprimit të njëjtë të prostitucionit. Pjesëmarrja në shtyrjen e personave të ndryshëm në prostitucion është një formë e

---

<sup>21</sup>Neni 191-a, po aty.

tregtisë me qëniet njerëzore, që realizohet duke kaluar femrat në shtete tjera për të zhvilluar aktivitetin e prostitucionit, pra duke i dërguar në ato vende ku ata do të kryejnë punën e tyre.

Kryes i kësaj vepre penale mund të jetë çdo person.

Nga aspekti objektiv prostitucioni realizohet përmes ushtrimit të prostitucionit si profesion, pra si një burim ekzistence.

Nga ana subjektive kjo vepër bëhet me paramendimin se kryerësi me vetëdije promovon ose nxit personin për të kryer veprimtari prostitucioni.<sup>22</sup>

Një formë e kualifikuar e prostitucionit si vepër penale është sanksionuar me nenin 403-a të KP nën titullin krime kundër njerëzimit. Norma konkrete sanksionon çdo person i cili, me qëllim shkatërrimin sistematik të popullatës civile, urdhëron vrasjen, dëmtimin e rëndë trupor, shfarosjen fizike, skllavërimin, dëbimin ose zhvendosjen me forcë të popullatës, burgosjen ose privimin e lirisë në kundërshtim me ligjin ndërkombëtar, tortura, përdhunimi, shfrytëzimi seksual ose skllavëria, prostitucioni i detyruar, shtatzënia e detyruar, sterilizimi i detyruar ose ndonjë formë tjetër e dhunës serioze seksuale, përndjekja e cilitdo grup ose komunitet për arsye politike, racore, kombëtare, etnike, kulturore, fetare ose gjinore, rrëmbimi i detyruar dhe zhdukja e diskriminimi dhe ndarja në baza racore, kombëtare, etnike, politike, kulturore ose arsye të tjera dhe veprime të tjera çnjerëzore që shkaktojnë qëllimisht vuajtje fizike ose mendore, ose kushdo që kryen me dashje ndonjë nga veprimet e mësipërme, do të dënohet me burgim të paktën dhjetë vjet ose burgim të përjetshëm.<sup>23</sup> Pra, nga neni i mësipërm, prostitucioni i dhunshëm si formë e kualifikuar rradhitet në kategorinë e krimeve kundër njerëzimit e cila nëse realizohet me dashje mund të sanksionohet me masën më të ashpër të legjislacionit tonë që është dënimi me burgim të përjetshëm.

Gjithashtu prostitucioni sanksionohet si formë e keqbërjes në kohë lufte kundër popullsisë civile. Kushdo që, gjatë një lufte, konflikti të armatosur ose okupimi, duke shkelur rregullat e së drejtës ndërkombëtare, urdhëron kryerjen e prostitucionit të detyruar ose përdhunimit kundër popullatës civile, do të dënohet me burgim të paktën dhjetë vjet ose me

---

<sup>22</sup>Zejneli, Ismail, “E drejta penale, Pjesa e posaçme (cikël leksionesh)”, Tetovë, 2007, fq. 85

<sup>23</sup>Neni 403-a, Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë së Veriut, Gazeta Zyrtare nr80/99, 4/2002 година, 43/2003; 19/2004; 81/2005; 60/06; 73/06; 7/08; 139/08; 114/09; 51/11; 135/11; 185/11; 142/12; 166/12; 55/13; 82/13; 14/14; 27/14; 28/14; 115/14 и 132/14

burgim të përjetshëm.<sup>24</sup> Kjo është një formë tjetër e kualifikuar e veprës penale të prostitucionit e cila është e lidhur me rrethana të jashtëzakonshme, siç është gjendja e luftës dhe si formë më e rëndë e veprës penale po ashtu parashikon sanksionin me të lartë penal, dënimin me burgim të përjetshëm.

Prostitucioni si veprimtari është i lidhur ngushtë me veprën penale të trafikimit me qenie njerëzore. Kryerja e veprës penale të trafikimit me qenie njerëzore me qëllim shfrytëzimi për prostitucion është sanksionuar poashtu nga Kodi Penal. Neni 418-a thotë: „Ai i cili me forcë, kërcënim serioz çon në lajthim apo forma të tjera të shtrëngimit, grabitjes, mashtrimit, me keqpërdorim të pozitës së vet apo gjendjes së shtatëzanisë, dobësisë apo paaftësisë fizike apo mentale të tjetrit, ose me dhënie apo marrje të parave apo dobi tjetër për shkak të marrjes së pëlqimit të personit që ka kontroll ndaj personit tjetër apo në mënyrë tjetër të rekrutojë, transportojë, bartë, blejë, shesë, strehojë apo pranojë persona për t'i eksploatuar përmes prostitucionit ose formave të tjera të eksploatimit seksual, do të dënohet së paku 4 vjet burgim.”<sup>25</sup>

Ky reagim i shoqërisë përmes normës juridike sanksionon prostitucionin në mënyrë indirekte. Duke goditur një nga fenomenet që është i lidhur me prostitucionin dhe që e mundëson zhvillimin e tij, ndikohet në zvogëlimin ose parandalimin e prostitucionit. Pra ky nen kontribuon në sanksionimin e njërit nga faktorët që favorizojnë prostitucionin.

## **2.2 Prostitucioni në kuadër të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut**

Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut e themeluar nga OKB-ja paraqet të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, por e cila shprehimisht nuk sanksionon prostitucionin si fenomen në veçanti. Megjithatë, siç kemi përmendur edhe më lart në këtë punim, prostitucioni është një fenomen i cili është i lidhur dhe shkakton pasoja të shumë anëshme në shoqërinë kur zhvillohet, prandaj në këtë mënyrë prostitucioni shkel mbi shumë nga liritë dhe të drejtat e njeriut. Analiza e mëposhtme e DUDNj – së në raport me fenomenin e prostitucionit është bërë për arsye se prostitucioni përveç që cënon disa të drejta të mbrojtura me ligjet kombëtare ai cënon në themel edhe liritë dhe të drejtat elementare të njeriut të cilat janë të rregulluara pikë së pari me

---

<sup>24</sup>Neni 404, paragrafi 1, po aty.

<sup>25</sup>Shih Neni 418-a, po aty.

Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut. Prandaj, në një formë indirekte ky akt mbron dhe ul mundësinë e zhvillimit të prostitucionit duke mbrojtur liritë dhe të drejtat themelore të njeriut.

## ***2.2. Cënimi i të drejtave universale të njeriut në ushtrimin e prostitucionit***

- Gjithkush ka të drejtë të jetojë, të jetë i lirë dhe të ketë sigurimin vetjak.<sup>26</sup> Në rastet e prostitucionit nuk mund të realizohen këto të drejta sepse viktimat e prostitucionit në masë të madhe janë të pasigurtë, të pambrojtur dhe në disa raste edhe jeta e tyre është e kërcënuar.
- Asnjëri nuk duhet të mbahet si skllav ose në robëri; skllavëria dhe tregtia e skllavëve janë të ndaluara në të gjitha format.<sup>27</sup> Prostitucioni në shumicën e rasteve, sidomos në prostitucionin jolegal, paraqet formë të skllavërisë, ku prostitutat trajtohen si pronë e tutorëve.
- Asnjëri nuk duhet t'i nënshtrohet torturës, veprimit ose dënimit mizor, çnjerëzor ose poshtërues.<sup>28</sup> Një nga aspektet më negative të prostitucionit është dhuna. Siç përshkruhet edhe në literaturën kriminologjike, viktimat e prostitucionit janë objekt dhune, torture dhe keqpërdorimi.
- Gjithkush ka të drejtë që t'i njihet kudo personaliteti juridik.<sup>29</sup> Gjatë ushtrimit të prostitucionit, sidomos atij jolegal, viktimat e prostitucionit nuk trajtohen si subjekt juridik dhe pozicionin e tyre e shohim jashtë respektimit të të drejtave dhe lirive të tyre kushtetuese- ligjore.
- Gjithkush ka të drejtë për mjete juridike të frytshme para gjykatave kompetente kombëtare për veprimet me të cilat shkelen të drejtat themelore të garantuara nga kushtetuta ose ligjet.<sup>30</sup> Trajtimi i viktimave të prostitucionit shpesh herë është inferior në proceset gjyqësore edhe për vetë faktin se ato janë të paragjykuar dhe të nënvlrësuar nga shoqëria në përgjithësi.

---

<sup>26</sup> Neni 3, Universal Declaration of Human Rights, United Nations General Assembly of its 183rd meeting, held in Paris on 10 December 1948

<sup>27</sup> Neni 4. Po aty.

<sup>28</sup> Neni 5. Po aty.

<sup>29</sup> Neni 6. Po aty.

<sup>30</sup> Neni 8. Po aty.

- Asnjëri nuk duhet t'i nënshtrohet arbitrarisht arrestimit, ndalimit ose dëbimit.<sup>31</sup> Në trajtimin juridik të viktimave të prostitucionit ekziston arbitrariteti në rast të arrestimit, ndalimit apo dëbimit.
- Asnjëri nuk duhet t'i nënshtrohet ndërhyrjes arbitrare në jetën, familjen, banesën ose korrespondencën vetjake, si dhe sulmeve kundër nderit dhe prestigjit personal. Gjithkush ka të drejtën të mbrohet nga ligji kundër ndërhyrjeve ose sulmeve të tilla.<sup>32</sup> Duke qënë se prostitutat nuk trajtohen si qenie me të drejta të plota gjatë ushtrimit të kësaj veprimtarie, një ndër të drejtat që ju mohohet atyre është edhe jeta private. Për sa kohë ato do jenë pjesë e kësaj veprimtarie nuk do të gëzojnë jetën private.
- Gjithkush ka të drejtën e lirisë së qarkullimit dhe banimit brenda kufijve të çdo shteti dhe gjithkush ka të drejtë të largohet nga cilido vend qoftë, përfshirë këtu edhe të vetin, si dhe të kthehet në vendin e vet.<sup>33</sup> Viktimat e prostitucionit janë të lidhura me këtë veprimtari si pasojë e faktorëve të ndryshëm, nevoja për para, kërcënimi, mbajta me dhunë etj., dhe në këtë mënyrë ato janë të lidhura për vendit ku ushtrojnë vprimatrinë, kanë kufizim të lëvizjes së tyre.
- Burrat dhe gratë në moshë madhore kanë të drejtë të lidhin martesë dhe formojnë familje, pa kurrfarë kufizimi për sa i përket racës, shtetësisë ose besimit. Ata kanë të drejta të barabarta si në rastin e lidhjes së martesës, gjatë martesës si dhe në rast shkurorëzimi. Martesa duhet të lidhet vetëm me pëlqimin plotësisht të lirë të personave që do të martohen. Familja është bërthama e natyrshme dhe themelore e shoqërisë dhe ka të drejtën e mbrojtjes nga shoqëria dhe shteti.<sup>34</sup> Duke qënë se e drejta e familjes dhe e martesës konkretisht, kërkon respektimin e disa parimeve siç është monogamia, besnikëria, jeta e përbashkët, etj., këto paraqesin kundërthënie me veprimtarinë e prostitucionit dhe të njëjtat nuk mund të realizohen njëtrajtësisht.

---

<sup>31</sup>Neni 9. Po aty.

<sup>32</sup>Neni 12. Po aty.

<sup>33</sup>Neni 13. Po aty.

<sup>34</sup>Neni 16. Po aty.



### **2.3 Analizë komparative e rregullave të posaçme që shtetet e Europës zbatojnë mbi prostitucionin, në kuadër të relizimit të të drejtave të njeriut**

Në Austri, ofrimi i shërbimeve seksuale nga të rriturit është legal, dhe nga pikëpamja ligjore punonjëset e seksit llogariten si të vetëpunësuarë që nga viti 1986. Një nga rregullat relevante në Austri i detyron ato të kryejnë ekzaminime mjekësore për sëmundje të transmetuara seksualisht çdo gjashtë javë.<sup>35</sup> Kjo promovon imazhin e punonjësve të seksit si 'të papastër' dhe shkel parimin e mosdiskriminimit.

Ata duhet të jenë të regjistruar, të jenë mbi 19 vjeç dhe duhet të paguajnë taksat.

Vetëm 5% e prostitutave në Austri janë vendase, ndërsa nga numri i përgjithshëm i prostitutave të huaja janë rreth 1-2% prostituta të cilat kërkojnë azil atje. Në vitin 2011 Akti I Prostitucionit të Vienës ndaloi prostitucionin në zonat e banuara dhe e zhvendosi atë në periferi të qytetit, (Einzingerasse ne Floridsdorf (1210), dhe Brunner Strasse ne Liesing (1120)).<sup>36</sup>

Në Finlandë, prostitucioni nuk është akt kriminal, por shtija ose blejra e shërbimeve seksuale në publik është i kriminalizuar në ligjin publik. (612/2003) Blerja e shërbimeve seksuale nga të miturit pra nga personat nën 18 vjeç ose nga viktimat të trafikimit është gjithashtu e kriminalizuar dhe dënohet me gjobë ose një vit heqje lirie. Edhe tentativa me personat e lartpërmendur është e dënueshme.

Punëtorët e seksit në Finlandë mund të përballen me akuza të 'joshjes', shkeljen e të drejtave të tyre për tubim dhe shoqërim paqësor dhe për kushte të përshtatshme pune nëqoftë se punojnë së bashku për mbrojtjen e tyre.<sup>37</sup>

---

<sup>35</sup> Kancelaria Federale e Republikës së Austrisë, <https://www.bundeskanzleramt.gv.at/en/agenda/women-and-equality/prostitution.html>

<sup>36</sup> <https://www.vindobona.org/article/prostitution-in-austria-permitted-again-here-are-the-new-covid-19-rules>

<sup>37</sup> EUCPN (European Crime Prevention Network), [https://eucpn.org/sites/default/files/document/files/po\\_fi\\_pt.pdf](https://eucpn.org/sites/default/files/document/files/po_fi_pt.pdf)

Në Francë, një punëtore seksi fëmijë mund, pasi të ketë mbushur moshën madhore, të dënohet për të jetuar me të ardhurat e një punëtore seksi, duke shkelur të drejtën e punonjësve të seksit për të respektuar dhe mbrojtur jetën e tyre private dhe familjare dhe lirinë nga ndërhyrjet arbitrare në të. Franca që nga viti 2016 aplikon modelin Nordik për rregullimin e prostitucionit, që në fakt legalizon shitjen por jo edhe blerjen e shërbimeve seksuale. E gjithë kjo për arsye të zvogëlimit të numrit të punonjësve të seksit. Rreth 80% e prostitutave të rrugës janë emigrante. Një studim që është bërë nga Medecins du Monde në vitin 2018 për efektin e ligjit që aplikohet në Francë që nga viti 2016, ka zbuluar se 63% e punonjësve të seksit janë ankuar se cilësia e jetës së tyre është përkeqësuar, që në fakt është tregues se ligji ka dhënë rezultat dhe numri i prostitutave është në rënie.

Në Greqi, ku puna seksuale është e ligjshme dhe punëtorët e seksit janë të regjistruar, punonjësit e seksit nuk lejohen të martohen. Nëse kjo ndodh, atyre nuk u lejohet të vazhdojnë të ushtrojnë ligjërisht të njëjtin profesion dhe të humbin licencën e tyre. Prandaj, ata janë të detyruar të zgjedhin midis të drejtës për t'u martuar dhe për të krijuar një familje dhe të drejtës për të punuar dhe për të siguruar jetesën edhe pse askush nuk duhet të detyrohet të zgjedhë midis kësaj. Veprimtarinë e tyre prostitutat mund ta ushtrojnë vetëm në bordello të regjistruara, të cilat sipas ligjit grek duhet të jenë së paku 200m larg shkollave, spitaleve, kishave, shesheve publike dhe çerdheve.

Në Itali, prostitucioni i ushtruar individualisht është legal ndërsa ushtrimi i të njëjtit në shtëpi publike dhe promovimi i të njëjtit është ilegal. Në Itali, ligji e klasifikon shfrytëzimin seksual të fëmijëve si skllavëri dhe vendos një dënim me 12 vite burg. Ky ligj penalizon gjithashtu shfrytëzimin seksual të personave nën 18 vjeç përfshirë këtu edhe rastet kur vepra të tilla ndodhin jashtë shtetit. Kjo sa i përket gjendjes juridike në Itali. Gjendja faktike tregon se prostitucioni është i shpërndarrë në rrugë dhe pjesa më e madhe e prostitutave janë nga Europa Lindore dhe Afrika perëndimore. Ekzistojnë bordello me një ose dy prostituta të punësuar.

Në Holandë, prostitucioni është dekriminalizuar që nga tetori i vitit 2000, për sa kohë që personat e përfshirë nuk janë minorenë apo emigrantë. Por edhe pse legal, prostitucioni nuk mund të ushtrohet nën moshën 18 vjeç e në shumicën e qyteteve edhe nën moshën 21 vjeç. Mos lejimi i marrjes të lejes ligjore për punëtorët migrantë të seksit, shkel të drejtën e tyre për mos-

diskriminim, sepse për të gjitha llojet e tjera të profesioneve migrantët mund të marrin një leje ligjore të punës nëse plotësohen kushtet e parashikuara nga Ligji për Punëtorët Migrantë. Megjithatë ligji dekriminalizoi prostitucionin, ligje për mbrojtjen e viktimës janë të përfshira dhe klientët e prostitutave më të vogla se 16 vjeç janë të përndjekur penalisht. (Neni 248b CC: aktet e paligjshme seksuale me prostitutë të mitur; Neni 248a ndalon joshjen e të miturve). Neni 237f I te drejtës penale CC ndalon:

- Çdo përfshirje, rekrutim ose shfrytëzim të të miturve (<18 vjeç) në industrinë e seksit pavarësisht nga kushtet e detyrimit, mashtrimit ose abuzimit të autoritetit;
- Çdo përdorim të forces (kërcënimit) të dhunës, mashtrimit ose shpërdorimit të autoritetit në lidhje me persona të rritur, si në lidhje me kushtet e rekrutimit ashtu edhe në kushtet e punës; dhe/ose përfitimi nga prostitucioni I ndonjë personi tjetër sipas kushteve të lartëpërmendura;
- Rekrutimin për prostitucion përtej kufijve, pavarësisht nga përdorimi I forcës, (kërcënimit) të dhunës, mashtrimi ose abuzim autoriteti.

Para vitit 2000, Kodi Penal përmbante ndalim të tërësishëm të shtëpive publike dhe tutorëve dhe çdo përfshirje e palëve të treta ishte e kriminalizuar, pavarësisht nga kushtet e detyrimit ose pëlqimit. Megjithatë vetë prostitutat, kërkimi apo shitja e seksit kurrë nuk ka qenë e kriminalizuar në Holandë. Nocioni "prostitute e zakonshme" nuk ka ekzistuar në ligjin holandez.

Qëllimet e heqjes së ndalesës së shtëpive publike:

- Kontrollimi dhe sistemimi i organizimit të prostitucionit nga të rriturit, ndër të tjera me futjen e një sistemi licencimi për bizneset e seksit.
- për të përmirësuar luftimin e operacionit tregtar (shfrytëzimit) të prostitucionit të pavullnetshëm
- Mbrojtja e minoreneve nga abuzimet seksuale<sup>38</sup>

---

<sup>38</sup>Prostitution policies in the Netherlands,  
[https://documentation.lastradainternational.org/Isidocs/Wijers\\_M\\_Pros\\_policies\\_NL\\_2008\[1\]\[1\].pdf](https://documentation.lastradainternational.org/Isidocs/Wijers_M_Pros_policies_NL_2008[1][1].pdf)

Portugalia çështjen e prostitucionit e ka të rregulluar kryesisht si itali, dmth prostituimi individual është legal ndërsa shtëpitë publike janë të ndaluara. Gjithashtu është ilegale që nga prostitucioni të përfitojnë personat e tretë. Në Portugali (dhe shumë vende të tjera) punonjësit e seksit humbin kujdestarinë e fëmijëve të tyre përmes qendrave sociale ose gjykatave familjare vetëm për shkak të profesionit të tyre dhe jo në bazë të provave specifike të dëmtimit ose paaftësisë për një prind, duke shkelur të drejtën e tyre - liria nga ndërhyrjet arbitrare (të pabazuara) në jetën e tyre familjare dhe mosdiskriminimi.

Në Rumani, prostitucioni ishte i ndaluar deri në vitin 2014. Që atëherë konsiderohet si kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë. Në shkurt të vitit 2015 janë propozuar ndryshime në ligjin penal në lidhje me prostitucionin e të miturve. Amandamenti parashikon që abuzimi me fëmijë dhe tentativa të konsiderohen vepër penale dhe të dënohen klientët të cilët me vetëdije përdorin shërbimet e një prostitute të mitur. I njëjti ka hyrë në fuqi në vitin 2016.<sup>39</sup> Rumania konsiderohet si shtet burim për punonjëset e seksit të cilat ushtrojnë veprimtarinë e tyre kryesisht në shtete me ekonomi më të zhvilluar.

Në Sllovaki punëtorët shëndetësorë në mënyrë të pambrojtur refuzojnë kujdesin mjekësor për punonjësit e seksit dhe diskriminojnë punëtorët seksualë shtatzënë duke sfiduar të drejtën e tyre për fëmijë, duke shkelur kështu të drejtën e tyre për mbrojtjen shtetërore të një standardi jetese për shëndetin fizik dhe mendor dhe edukimin familjar.

Në Spanjë, punonjësve të seksit në bordello u kërkohet të paraqiten dhe të paguajnë tarifa të tepruara për kontrollet e shëndetit seksual nga pronarët e tyre. Rezultatet e testeve të tyre nuk trajtohen në mënyrë konfidenciale, shteti nuk arrin të sigurojë mbrojtje efektive për të drejtën e tyre për privatësi, shëndet dhe shkeljen e kodeve mjekësore të punës.

Në Suedi, ofrimi i prostitucionit nuk është i kriminalizuar por blerja po. Kjo ka bërë që niveli i prostitucionit në shtet të bie dhe shteti ka funksionuar në këtë mënyrë që nga vit 1999. Ky model është i adaptuar edhe nga shtete të tjera si Islanda, Norvegjia, apo Irlanda Veriore.<sup>40</sup> Në Suedi, politikanët dhe politikëbërësit kanë kërcënuar të tërhiqen nga debatet publike nëse punonjësit e

---

<sup>39</sup> <https://beobachtungsstelle-gesellschaftspolitik.de/f/958037694b.pdf>

<sup>40</sup> <https://www.vanguardngr.com/2020/09/prostitution-legal-in-sweden-but-illegal-to-be-a-prostitutes-customer/>

seksit marrin pjesë gjithashtu në debat, duke përjashtuar kështu sistematikisht punonjësit e seksit nga dëgjimet publike, duke shkelur të drejtën e tyre për lirinë e shprehjes dhe mendimit.

Në Mbretërinë e Bashkuar, ku punëtorët e seksit në rrugë po kriminalizohen, e ashtuquajtura Urdhrat kundër sjelljes antisociale për të kufizuar lirinë e tyre të lëvizjes, dhe në disa qytete madje emra me fotografi të punonjësve të seksit shtypen dhe shpërndahen në komunitet, duke shkelur të drejtën e tyre për privatësi dhe pjesëmarrje në jetën publike dhe seksuale, punëtorët janë të ekspozuar ndaj diskriminimit dhe dhunës.<sup>41</sup>

Në Shqipëri prostitucioni ka qenë legal vetëm në kohën e mbretit Zog kur ai sapo ishte zgjedhur si ministër i brendshëm në qeverinë Ypi në vitin 1922.<sup>42</sup> Rregullorja që u miratua ishte e huazuar nga austro-hungarezët në Sarajevë dhe u citua si rregullore e grave publike. Kjo rregullore përmbante pika si:<sup>43</sup>

- Prostitutë quhet çdo femër e cila e pohon profesionin dhe që merr pagesë kundrejt shërbimeve;
- Çdo personi që regjistrohet si prostitutë dhe që miratohet nga mjeku, i jepet një certifikatë shëndetësie dhe detyrohet të zbatojë rregulloren në fjalë;
- Shpenzimet shëndetësore i paguajnë vetë punonjëset e seksit;
- Ato femra që më parë kanë kryer punë të ndershme, duhet të paralajmërohen për pasojat e këtij zanati, ndërsa për vajzat e reja që jetojnë akoma në shtëpinë e prindërve dhe janë minorene, familjarët duhet të njoftohen për vendimin e vajzës.
- Të gjitha prostitutat duhet të jetojnë në të njëjtin vend (te ashtuquajtura sot shtëpi publike).<sup>44</sup>

---

<sup>41</sup> “Од нас за нас”, Списание направено од сексуални работници за сексуални работници, [https://www.swannet.org/files/swannet/File/Documents/STAR\\_odnaszanas\\_september\\_2009.pdf](https://www.swannet.org/files/swannet/File/Documents/STAR_odnaszanas_september_2009.pdf)

<sup>42</sup> Baxhaku, Fatos, Kapo, Klodiana, Gra të përgjithshme, Tiranë, 2014, fq.19

<sup>43</sup> Baxhaku, Fatos, Kapo, Klodiana, Gra të përgjithshme, Tiranë, 2014, fq.83

<sup>44</sup> Baxhaku, Fatos, Kapo, Klodiana, Gra të përgjithshme, Tiranë, 2014, fq.84

- Çdo prostitutë është e detyruar të paraqitet në polici dhe të regjistrohet në regjistrin e posaçëm për to ku do të mbahet evidencë për çdo ndryshim në jetën e tyre, përfshirë dëshmitë e dhëna nga vetë ato, sëmundje, shtrimet në spital, çdo dënim të marrë për mosrespektimin e rregullores si dhe evidencë nëse prostituta heq dorë nga ky profesion.
- Çdo prostitutë duhet të kryejë ekzaminime mjekësore dy herë në javë të caktuara nga mjeku.<sup>45</sup>

Megjithatë, hera e parë që prostitutat janë përmendur në dokument zyrtar në trojet tona, ka qenë në shekullin XIV në kreun 87 të Statutit të Shkodrës. Kreu 87 ndalonte prostitutat të shoqëroheshin m dikë, të jetonin apo thjesht të rrinin në zonat ku banonjin zonja fisnike, dhe nëse ky rregull shkilej dënimet ishin gjobë, syrgjynosje dhe më pas dhunë fizike në publik.<sup>46</sup>

Të parët klientë të prostitucionit në Shqipëri kanë qenë ushtarët dhe vetëm pas largimit të tyre u shpërnda si shenjë e civilizimit perëndimor.<sup>47</sup>

Prostitucioni në RMV-së është legal megjithatë ka ligje dhe rregulla të cilave duhet tu përmbahen. Mendohet se në Maqedoni ka rreth 3000-4000 persona të përfshirë në prostitucion, pa përjashtur viktimat e trafikimit. Ky aktivitet është i përhapur në klubet e natës, në apartamente private dhe bare.<sup>48</sup>

Punonjëset e seksit në RMVë-së janë viktimat e trafikimit me njerëz dhe vijnë nga shtete të ndryshme. Një pjesë si fëmijët e komunitetit romë, trafikohen nëpërmjet martesave të sforcuara. Fondet e dedikuara për antitrafikimin në RMV-së kanë rënë nga 32.45 milionë denarë në vitin 2014 në 4.1 milionë denarë në vitin 20115. Megjithatë qeveria ka dënuar më shumë trafikantë në

---

<sup>45</sup> Baxhaku, Fatos, Kapo, Klodiana, Gra të përgjithshme, Tiranë, 2014, fq.85-86

<sup>46</sup> Baxhaku, Fatos, Kapo, Klodiana, Gra të përgjithshme, Tiranë, 2014, fq.37

<sup>47</sup> Baxhaku, Fatos, Kapo, Klodiana, Gra të përgjithshme, Tiranë, 2014, fq.57

<sup>48</sup> <http://coalition.org.mk/archives/81?lang=en>

2015 nga 2014 por vetëm 4 nga viktimat janë identifikuar, numri më i vogël i regjistruar ndonjëherë. Edhe pse qeveria vazhdoi ti ketë nën vëzhgim fëmijët që jetonin rrugëve, ajo ndaloi bashkëpunimin me organizatat joqeveritare që mbikqyrnin dhe mundoheshin të identifikojnë të gjithë llojet e trafikimit në Maqedoni. Viktimat nuk janë kompensuar dhe sidomos viktimat meshkuj nuk kanë marrë shërbimet e nevojshme, si dhe në dallim nga vitet tjera nuk ka pasur kampanja për rritjen e AWARENESS tek qytetarët.<sup>49</sup>

## KAPITULLI I TRETË

### MBROJTJA JURIDIKE DHE E KOMPENSIMIT TË VIKTIMAVE TË PROSTITUCIONIT

Trafikimi i femrave zakonisht është i lidhur me detyrimin e tyre për prostitucion dhe veprime të tjera në dëm të tyre me anë të mashtrimit, kërcënimit, rrëmbimit, dhunimit, keqtrajtimit, kufizimit të lirisë së lëvizjes me qëllim të shfrytëzimit. Trafikimi i femrave është biznes shumë i përhapur, i cili organizohet nga grupe dhe rrjete kriminale, që veprojnë në rajone dhe hapësira mjaft të gjera në tërë botën. Sipas rezultateve të kërkimeve, të bëra në nivel botëror apo rajonal në vitet e fundit, për çdo vit në botë trafikohen, domethënë barten e transportohen prej një shteti në tjetrin, prej një rajoni në tjetrin ose prej një kontinenti në tjetrin, prej 700 mijë deri në 2 milionë femra dhe fëmijë. Sipas organizatës së mirënjohur për mbrojtjen e fëmijëve në botë — UNICEF, gjatë një viti, me qëllim të shfrytëzimit, në botë trafikohen rreth 1.200.000 fëmijë. Këto konstatime janë shumë brengosëse, ngase bëhet fjalë për fëmijë dhe mosha të reja, të cilët për tërë jetën ngelin me trauma e strese.<sup>50</sup>

---

49

<https://www.refworld.org/cgi-bin/texis/vtx/rwmain?page=search&docid=577f95dee&skip=0&query=prostitution&coi=MKD>

<sup>50</sup>Halili, Ragip, Viktimologjia, Prishtinë, 2011, fq.103

### **3.1 Të drejtat e viktimës**

#### ***3.1.1 E drejta për kompensim***

Viktima si person, ndonjë e drejtë personale ose private e të cilit është cenuar ose rrezikuar me veprën penale, me paraqitjen e propozimit për realizimin e kërkesës pronësore-juridike d.m.th. kompensim të dëmit, në procedurën penale merr pozitën e subjektit procesor. Domethënë, viktimë e cila paraqitet si person i dëmtuar në procedurë, edhe pse nuk është bartëse e asnjërës nga funksionet themelore në procedurën penale, ka rol mjaft aktiv dhe mundësi të ndikojë në rrjedhën e gjykimit.

Me vetë faktin se në të njëjtën kohë personi i dëmtuar paraqitet edhe si dëshmitar gjatë procedurës, me këtë nuk ndryshon dukshëm pozita proceduese e viktimës. Përfundimisht paraqet rasti, në pajtim me të cilin, e drejta e të dëmtuarit për të shikuar lëndët dhe shkrimet, të cilat shërbejnë se si mund të kufizohet deri në momentin kur ai do të merret në pyetje si dëshmitar. Mirëpo, kur viktimë është vetëm dëshmitar në procedurë, por jo edhe person i dëmtuar, situata pak ndryshon. Gjegjësisht, si dëshmitar thirret personi për të cilin dihet se do të mund të jep njoftim për veprën penale, për kryerësin ose për rrethana tjera të rëndësishme. Personi është i detyruar t'i përgjigjet ftesës së gjykatës dhe të shprehet personalisht. Domethënë, derisa pjesëmarrja e të dëmtuarit në procedurë zhvillohet vullnetarisht dhe varet vetëm nga dëshira e tij të kyçet në proces, pjesëmarrja e dëshmitarit është e domosdoshme dhe varet nga vlerësimi i lirë i gjykatës për nevojën për të dëgjuar atë.

#### ***3.1.2 E drejta për person të autorizuar***

Viktima si person i dëmtuar në procedurë mund të realizojë të drejtën e tij përmes personit të autorizuar. Personi i autorizuar është ai që ka pëlqimin të ndërmerr veprime procedimi gjatë veprimeve procedimi të procedurës penale në emër dhe në interes të viktimës. Në të gjitha lëndët e vëzhguara në lidhje me "Ndërmjetësim gjatë kryerjes së prostitucionit" në të cilat viktime paraqitet si person i dëmtuar gjatë procedurës, atë e përfaqëson personi i autorizuar.

#### ***3.1.3 E drejta e viktimës që të jetë e pranishme***

Viktima, që paraqitet si e dëmtuar gjatë procedurës, thirret në shqyrtimin kryesor. Sipas Ligjit për procedurë penale, viktimë e një krimi ka të drejtën të marrë pjesë në procedimin penal



si palë e dëmtuar duke u përfshirë në ndjekje penale ose për realizimin e një kërkesë pronësore-juridike për dëmshpërblim.<sup>51</sup>

### ***3.1.4 Të informuarit në lidhje me të drejtat e saj***

Përderisa viktimat nuk ka vënë propozim për realizimin e kërkesës pronësore-juridike deri në ngritjen e aktakuzë procedurës penale, gjykata e informon se atë propozim mund ta vejë deri në kryerjen e shqyrtimit kryesor.

Viktima e cila thirret si dëshmitar në procedurën, para se të jep qëndrimin e saj, medoemos ti tërhiqet vëmendja se është e obliguar të flet të vërtetën dhe nuk guxon të hesht për asgjë, e njëherësh t'i tërhiqet vëmendja se dhënia e dëshmisë së rrejshme paraqet vepër penale. Gjatë procedurës në gjykatat tona, viktimës-dëshmitar asnjëherë nuk i tërhiqet vëmendja. Viktima-dëshmitar, po ashtu, medoemos të informohet se nuk është e detyruar ti përgjigjet pyetjeve të veçanta, nëse është e dukshme se me atë do të mbrojë, do të shkaktojë dëm të konsiderueshëm material ose do të shkaktojë ndjekje penale për atë apo ndonjë të afërmin e saj.

### ***3.1.5 E drejta për të propozuar dëshmi të reja***

Viktima ka të drejtë deri në përfundimin e shqyrtimit kryesor të propozojë të nxjerrin fakte të reja dhe të gjenden dëshmi të reja.

### ***3.1.6 E drejta për tu parashtruar pyetje dëshmitarëve, ekspertëve dhe të akuzuarve***

Viktima/e dëmtuar gjatë procedurës, me leje nga kryetari i këshillit mundet në mënyrë të drejtpërdrejtë t'u parashtrojë pyetje dëshmitarëve dhe ekspertëve. Kjo e drejtë është përdorur në 1/3 e rasteve të vëzhguara.

### ***3.1.7 E drejta për të arsyetuar kërkesën pronësore-juridike***

E dëmtuara ka të drejtë, pas përfundimit të procedurës së dëshmive, jo vetëm të arsyetojë kërkesën pronësore-juridike, por edhe të ndërmerr qëndrim dhe ti analizojë dëshmitë e nxjerra

---

<sup>51</sup>Neni 53, paragrafi 1, pika 1, Ligji për procedurë penale, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nr. 150/2010

nga të cilat jo vetëm që varet përgjegjësia penale e të akuzuarit por edhe fati i kërkesës pronëso- juridike.

### ***3.1.8 E drejta e përkthimit***

I pandehuri, pala e dëmtuar, paditësi privat, dëshmitarët dhe pjesëmarrësit e tjerë në procedurë që flasin gjuhë zyrtare tjetër nga maqedonishtja kanë të drejtë të përdorin gjuhën dhe shkrimin e tyre në procedurë. Palët, dëshmitarët dhe pjesëmarrësit në procedurën para gjykatës kanë të drejtën e ndihmës falas të një përkthyesi, përkatësisht përkthyesit, nëse nuk e kuptojnë ose nuk flasin gjuhën në të cilën zhvillohet procedura. Organi që zhvillon procedurën do të sigurojë një përkthim gojor të asaj që personi dhe të tjerët po paraqesin, si dhe dokumentet dhe provat e tjera të shkruara. Po ashtu, organi që zhvillon procedurën do të sigurojë që materiali i shkruar në lidhje me procedurën ose mbrojtjen e të pandehurit të përkthehet me shkrim.<sup>52</sup>

Viktima qoftë të paraqitet si dëshmitar ose si i dëmtuar në procedurë ka të drejtë në përkthyes pa pagesë, nëse nuk e kupton ose nuk e flet gjuhën e procedurës. Edhe pse problemi me përkthimin adekuat në gjuhën e viktimës e cila më së shpeshti është e huaj, përmendet si ndër problemet më të mëdha me të cilat përballet gjyqësia posaçërisht në sferën e tregtisë me njerëz, megjithatë, sipas analizës sonë mund të vërehet se përkthimi gjatë marrjes në pyetje të viktimës, ka qenë në nivel të kënaqshëm. Vetëm në një rast përkthimi i siguar për shkak të marrjes në pyetje të viktimës si dëshmitar, ka qenë me cilësi të dobët. Në të dy lëndët viktima, shtetas i huaj, ka deklaruar se e kupton gjuhën maqedonase dhe me këtë gjuhë është shërbyer në shqyrtimin kryesor.

### ***3.1.9 E drejta e mbrojtjes***

Dëshmitarit i mundësohet ta shkurtojë paraqitjen e të dhënave personale (emrin dhe mbiemrin, emrin e babait, profesionin, vendqëndrimin, moshën dhe raportin me të akuzuarin) nëse supozohet se me dhënien e dëshmisë ose përgjigjes në pyetje të caktuar, do ta vinte në rrezik serioz të jetës, shëndetit ose integritetit fizik, veten ose ndonjë person të afërt.<sup>53</sup>

---

<sup>52</sup> Neni 9, paragrafët 1,2 dhe 3, Ligji për procedurë penale, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nr. 150/2010

<sup>53</sup> Shih, Neni 219, paragrafi 3, Neni 9, paragrafët 1,2 dhe 3, Ligji për procedurë penale, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nr. 150/2010

Njëherësh dëshmitarit i cili e ka shkurtuar paraqitjen e të dhënave të lartpërmendura, nëse konfirmohet se ka bazë ekzistimi i rrezikut, në afat prej 24 orësh i sigurohet mbrojtje përmes përfshirjes në programin e mbrojtjes së dëshmitarëve. Përveç përfshirjes në programin për mbrojtjen e dëshmitarëve në përputhje me legjislacionin tonë, mund të ndërmerren edhe veprime që kanë të bëjnë me mënyrën e posaçme të marrjes në pyetje të dëshmitarit. Veprimet kanë të bëjnë me marrjen në pyetje të dëshmitarit vetëm në prani të prokurorit publik dhe gjyqtarit hetues, përkatësisht kryetarit të këshillit, në vend që të sigurojë mbrojtjen e identitetit të tij, përveç nëse me pëlqimin e dëshmitarit këshilli nuk vendos ndryshe që marrja në pyetje të bëhet përmes gjykatës ose me shfrytëzimin e mjeteve të tjera teknike adekuate të komunikimit.<sup>54</sup>

### ***3.1.10 E drejta e gjykimit në të cilin është përjashtuar publiku***

Duke marrë parasysh ndjeshmërinë e lëndëve lidhur me tregtinë me njerëz, e duke u nisur para së gjithash nga nevoja për t'i ikur viktimizimit sekondar të viktimës, çështja e përjashtimit të publikut gjatë tërë shqyrtimit ose vetëm gjatë dhënies së dëshmisë nga e njëjta, meriton vëmendje të veçantë. LPP parasheh mundësinë e përjashtimit të publikut, ndër të tjera edhe për shkak të mbrojtjes së moralit dhe të personalitetit të dëshmitarit ose të dëmtuarit, si dhe për shkak të mbrojtjes së interesave të të miturit.<sup>55</sup>

Në pajtim me të dhënat nga vëzhgimi i lëndëve vetëm në tre lëndë është marrë vendim për përjashtimin e publikut. Në rastin e parë është fjala për mbrojtjen e interesave të viktimës së mitur, në rastin e dytë me propozimin e palëve, përkatësisht të mbrojtësve të të akuzuarve publiku është mënjeluar nga gjykata gjatë kohës së dhënies së dëshmisë së viktimës së dëmtuar në procedurë, ndërsa në rastin e tretë është përjashtuar publiku gjatë tërë shqyrtimit për shkak të mbrojtjes së moralit dhe jetës personale të dëshmitarit të dëmtuar.

Meritojnë vëmendje edhe të dy situatat kur mbrojtësit e të akuzuarve në procedurë kanë kërkuar mënjanimin e personave të sigurimit të cilët kanë shoqëruar viktimën me arsyetim se të njëjtët mund të ndikojnë në dhënien e dëshmisë së të dëmtuarës-dëshmitare. Në rastin e dytë kryetari i Këshillit gjyqësor duke u shprehur negativisht lidhur me çështjen e përjashtimit të publikut ( shqyrtimi është publik) i ka lutur personat e sigurimit që të tërhiqen një rresht prapa

---

<sup>54</sup> Shih, Neni 226, Ligji për procedurë penale, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nr. 150/2010

<sup>55</sup> Shih, neni 55, neni 354, Ligji për procedurë penale, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nr. 150/2010

ulëses së viktimës. Në rastin e dytë vendimi për përjashtimin e publikut nuk është marrë, kurse përfaqësuesit e sigurimit të viktimës janë lutur të tërhiqen nga gjykatorja.

Largimi i personave nga gjykatorja, në praninë e të cilëve viktimë është ndier më e sigurt dhe të cilët gëzojnë besimin e saj, është në kundërshtim me praktikën e mirë për mbrojtjen e dëshmitarëve gjatë procedurës.

### ***3.1.11 Trajtimi i viktimës me respekt***

Mënyra e marrjes në pyetje të viktimës – dëshmitar në shqyrtimin kryesor mund të ketë rëndësi esenciale për zhvillimin e procedurës dhe të njëjtën kohë për përcaktimin e ekzistimit, kualifikimit të veprës penale, si dhe për përcaktimin e përgjegjësinë së kryerësit. Marrja në pyetje e dëshmitarit gjatë procedurës përbën një materie mjaft të ndjeshme, veçanërisht nëse dëshmitari i takon ndonjërit nga grupet e dëshmitarëve të lëndueshëm. Duke u nisur nga karakteristikat e veçanta psikofizike të dëshmitarit grua, agresioni dhe dhuna të cilave u është nënshtruar gjatë eksploatimit, intimidimit me të cilin është ndjekur kryerja e veprës si dhe për shkak të karakteristikave individuale, arsimimit dhe nivelit intelektual të viktimës, është e domosdoshme që të gjitha subjektet gjatë procedurës të sillen në mënyrë adekuate. Në të vërtetë, jo vetëm që trajtimi i viktimës me respekt paraqet një imperativ të domosdoshëm për shoqërinë e cila si parësore e ka respektimin e të drejtave themelore të njeriut, mënyra e këtillë ndonjë herë paraqet parakusht për rehabilitimin e viktimës dhe rianimimin e aftësisë së saj për kthim në jetën normale, e në të njëjtën kohë reflektohet në formimin e vullnetit të saj që të ndihmojë në procedurën gjyqësore.<sup>56</sup>

LPP u jep rëndësi të veçantë viktimave të krimeve kundër lirisë seksuale dhe moralit seksual, ndaj të cilëve ka përcaktuar disa të drejta të veçanta, si më poshtë:

- të flasë me një këshilltar falas ose një përfaqësues para provimit, nëse ai / ajo merr pjesë në procedurë si palë e dëmtuar;
- të ekzaminohet nga një person i të njëjtit seks në polici dhe prokurori publike;
- të mos u përgjigjet pyetjeve që i referohen jetës personale të viktimës dhe që nuk kanë të bëjnë me krimin;

---

<sup>56</sup> Velkoska, Violeta, Pengimi i tregtisë me njerëz gjatë praktikës së gjykatave të vendit, Shkup, 2005, fq. 23-30

- të kërkojë ekzaminim me ndihmën e mjeteve vizuale-audio në një mënyrë të përcaktuar dhe
- të kërkojë përjashtimin e publikut nga seanca kryesore.
- gjykata, prokuroria publike dhe policia janë të detyruara ta udhëzojnë viktimën për të drejtat e saj, më së voni para shqyrtimit të saj të parë, për të cilën ata përpilojnë një shënim zyrtar ose procesverbal.<sup>57</sup>

### 3.2 Kompensimi i viktimave

Reforma e legjislacionit ndëshkimor në drejtim të mbrojtjes së interesit të viktimës, para së gjithash qasjes së viktimës kah sistemi i drejtësisë ndëshkimore dhe zbatimit të saj efikas, restituimi, kompensimi, ndihma sociale dhe mbrojtja nga viktimizimi sekondar, u iniciua nga një numër i madh instrumentesh ndër kombëtare.

Në vendet e Unionit Evropian detyrimi për kompensim të dëmit të shkaktuar me kryerjen e veprës penale i takon, para së gjithash, të akuzuarit. Viktima në procedurë civile me padi private është e autorizuar të paraqesë kërkesë për kompensimin e dëmit të pësuar material dhe jo material. Me këtë rast, për shkak të shpejtit dhe lehtësisë të procesit për mundësimin e kompensimit, një pjesë e vendeve anëtare parashikojnë dispozita në bazë të të cilave viktimat e dëmtuara mund të paraqesin kërkesë për kompensim të dëmit në procedurë penale. Rëndom realizimi i kërkesës është i lidhur me përmbushjen e kushteve të caktuara.

Shpesh ndodh që viktima të mos jetë në gjendje ta realizojë të drejtën e vet për kompensim për dëmin e pësuar, qoftë të punohet për kryerës të panjohur të veprës penale, për mungesë të dëshmive për ngritjen e aktakuzës kundër tij ose është në pyetje paaftësia e kryerësit që ta paguaj kompensimin. Për këtë arsye disa prej vendeve anëtare, në situata të tilla e parashikojnë mundësinë që shteti ta kompensojë viktimën.

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut, kompensimi i viktimës së tregtisë me njerëz mundësohet përmes shfrytëzimit të institutit konfiskim prone ose letërsi pronësore nga kryerësi i veprës penale dhe kthimi i leverdisë të dëmtuarit përkatësisht viktimës në procedurën penale. Përkundër qëndrimit të përcaktuar qartë të bashkësisë ndërkombëtare dhe legjislacionit së vendit për detyrimin e shtetit për kompensimin e viktimës, nëse kryerësi i veprës nuk mund ta bëjë këtë,

<sup>57</sup>Neni 55, Ligji për procedurë penale, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nr. 150/2010

në Maqedoni nuk ekziston fond shtetëror për dëmshpërblimin e viktimës e as dispozita për detyrimin e gjykatës që të caktojë dëmshpërblimin nga e njëjta.

Në të vërtetë, gjykata me vendim me të cilin është konfirmuar kryerja e veprës penale do të urdhërojë konfiskimin e leverdisë pronësore të përfutur me të. Me këtë rast leverdia pronësore mund të jetë në të holla, sende të tundshme dhe të patundshme me vlerë si dhe çdo pronësi tjetër, pronë ose aktivë, të drejta materiale dhe jo materiale. Në rast se nuk mund të bëhet konfiskimi i tyre, kryerësit do t'i konfiskohet ndonjë pronë tjetër që i përgjigjet leverdisë së përfutur pronësore. Ajo që është konfiskuar i kthehet të dëmtuarit e nëse nuk ka të dëmtuar, bëhet pronë e shtetit. Nuk mund e të mos vërehet statusi i privilegjuar i (të drejtat dhe detyrimet) shtetit. Në të vërtetë, në situatat kur kryerësi nuk mund ta kompensojë viktimën, shteti nuk e korrigjon mosbalancimin e parimit të drejtësisë, kurse në situata kur i dëmtuari është i panjohur, mjetet hyjnë në buxhetin e RM.

Meqë viktima e tregtisë me njerëz për shkak të mosekzistimit të fondeve shtetërore për zhdëmtim nuk mund të kompensohet në mënyrë tjetër përveç se nga prona e kryerësit, është më se e qartë nevoja e shfrytëzimit më të shpeshtë të dispozitave të KP për konfiskimin e pronës dhe të dobisë pronësore të fituar me vepër penale si dhe e dispozitave për sigurimin e përkohshëm të pronës ose të mjeteve që janë në lidhje me atë vepër. Konfiskimi i fitimeve kriminele njëherësh mund të ketë edhe veprim më të fuqishëm frikësues se sa dënimi me burg i cili në Maqedoni për shkak të politikës së butë të gjykatave me rastin e matjes së dënimit, më së shpeshti lëviz nën minimumin e veçantë ligjor.

Respektimi i dispozitave nga Ligji për procedurë penale që i dedikohen kërkesës pronësore juridike, paraqet imperativ të domosdoshëm për sigurimin e mbrojtjes së interesit të viktimës përkatësisht të forcimit të pozitës së saj në procedurën para gjykatës. Shfrytëzimi i mendimit (ekspertizës) të personave profesionistë që janë të obliguar për dhënien e përkrahjes psikologjike viktimave, menjëherë pas pranimit të tyre në Qendrën transitore, si mjet dëshmues në procedurë, veçanërisht në kushtet kur nuk është kryer ekspertizë tjetër e gjendjes psikologjike të viktimës para se e njëjta të kthehet në vendin amë, paraqet një zgjidhje të dëshiruar për shkak të caktimit të bazës dhe shumës së kompensimit të drejtë viktimave në tregtinë me njerëz.<sup>58</sup>

---

<sup>58</sup> Velkoska, Violeta, Pengimi i tregtisë me njerëz gjatë praktikës së gjykatave të vendit, Shkup, 2005, fq. 47-55

## **KAPITULLI I KATËRT**

### **ANALIZË PRAKTIKE E PROSTITUCIONIT**

#### **4.1 Prostitucioni në Republikën e Maqedonisë së Veriut – Gjendja nga viti 2016 deri në vitin 2021**

Gjendjen e fenomenit të prostitucionit në vitet 2016 e gjejmë të pasqyruar nëpër artikujt të ndryshëm gazetaresk dhe kronikat televizive të kohës. Në këto artikuj sqarohet se rrjetet e prostitucionit të organizuar kanë vepruar aktivisht në Maqedoni që prej të paktën një dhjetëvjeçari. Numri i prostitutave që punojnë në këtë vend mendohet të jetë rreth 1,500 deri 2,000. Kjo tregti mendohet se krijon fitime prej rreth 325 deri 430 milion euro në vit për organizatorët e saj. Një pronar i një bari apo klubi nate me pesë prostituta mund të fitojë lehtësisht rreth 40,000 deri 50,000 euro në muaj. Potenciali i këtij biznesi kaq të fuqishëm për të korruptuar punonjësit e administratës shtetërore, policinë apo edhe të ndihmojë në zgjedhjen e deputetëve për në parlamentin e vendit është real.

Fitimet ekonomike nga prostitucioni i organizuar janë tepër të mëdha dhe kjo gjë ka bërë që një numër gjithnjë e më i madh njerëzish të përfshihen në këtë biznes. Rrjetet ilegale që mundësojnë trafikimin e vajzave janë ngritur në të gjithë vendin. Ato verpojnë në bazë të kërkesë- ofertës dhe kontrollojnë edhe shpërndarjen e prostitutave në vende të tjera, përfshirë Europën perëndimore dhe vetë Maqedoninë.

Shumë prostituta të sjella në Maqedoni vijnë nga vendet e Europës lindore, veçanërisht Bullgaria, Ukraina, Rumania, Moldavia dhe Rusia. Por Serbia po bëhet gjithashtu një burim në rritje i këtyre prostitutave. Këto vajza shpesh mashtrohen duke kujtuar se po shkojnë në perëndim për të punuar si kërcimtare, kamariere, apo edhe artiste striptize. Por edhe ato që e

kuptojnë që do të punojnë si prostituta nuk arrijnë të kuptojnë kushtet skllavëruese që i duhet të durojnë.

Për të shmangur zbulimin nga ana e autoriteteve vajzat shpesh hyjnë në vend si turiste në grupe të vogla me nga pesë ose më pak njerëz. Të ardhurat shoqërohen nga 'agjentët' e tyre, të cilët pranojnë 'kërkesa' nga bordellot ilegale. Këta 'agjentë' ua dorëzojnë vajzat 'pronarëve' të rinj për një çmim prej rreth 3,000 eurosh për person. Më vonë, ose me dëshirë ose me dhunë, këto vajza detyrohen të prostitutojnë. Hapi i parë në këtë proces është që pronari i barit apo i klubit të natës të konfiskojë pasaportat me pretekstin se do të plotësojë dokumentacionin e kërkuar prej stacioneve të policisë. Vajzat më pas gjenden të burgosura në vend pa dokumenta zyrtare. Për më tepër, disa zyrtarë të policisë duket se bashkëpunojnë me pronarët e këtyre rrjeteve dhe marrin rryshfete në shkëmbim për mosluftimin e këtij aktiviteti të paligjshëm.

Duke lënë mënjanë korrupsionin, policia po përpiqet të merret me këtë problem duke i fokusuar hetimet te organizatorët dhe ndërmjetësit e rrjeteve të prostitucionit.

Problemi rëndohet edhe më shumë po të kihet parasysh rritja e kërkesës për prostituta, kryesisht për shkak të pranisë në Maqedoni të trupave të NATO-s dhe organizmave të tjera joqeveritare gjatë dhe pas krizës në Kosovë. Por duhet të theksohet se vetëm kjo nuk mund të shërbejë si shkak për shtimin e trafikut. Prostitucioni ka lulëzuar në Maqedoni edhe përpara mbërritjes së këtij komuniteti të madh ndërkombëtar.

Shumë bordelle janë të vendosura në hotele, bare dhe klube nate në zonat jashtë qyteteve për të shmangur kështu praninë në rritje të forcave policore në qytete. Megjithatë, nuk ekzistojnë shifra zyrtare për numrin e këtyre bordellove, shifra mendohet të jetë e lartë, veçanërisht nëse kihet parasysh se Maqedonia është një vend relativisht i vogël.

Në Tetovë, një qytet i banuar kryesisht nga shqiptarë në Maqedoninë veriperëndimore, mendohet se ekzistojnë disa vende ku ushtrohet prostitucion. Gjendja është e ngjashme edhe në zonat me popullsi kryesisht maqedonase. Qyteti turistik i Ohrit duket se ka një rrjet të gjerë prostitucioni, i cili ushqehet edhe nga industria e turizmit.

Kërkesa në rritje, fitimet e mëdha dhe përmirësimi i organizimit të rrjeteve të prostitucionit janë shenja se ky biznes do të vazhdojë të lulëzojë në Maqedoni. Vështirësitë e



mëdha të policisë, përfshirë edhe korrupsionin e saj, janë një përfitim për protektorët dhe trafikantët.

Prostitucioni në Republikën e Maqedonisë së Veriut ka qënë prezent në masë më të madhe pas vitit 1991. Kjo ka ardhur si pasojë e hyrjes në procesin e tranzicionit politik i cili ka ardhur si pasojë e ndryshimit të sistemit politik. Ky ndryshim erdhi bashkë me problematika të caktuara siç është rritja e disa fenomeneve kriminale të cilat erdhën bashkë me lirinë e zgjeruar me ardhjen e sistemit politik demokratik.

Një ndër veprimtaritë që lulëzoi në atë kohë ishte prostitucioni. Gjatë viteve 90-ta pati një zhvillim të këtij fenomeni, i cili vjen duke u rritur për të arritur kulminacioni gjatë viteve 2000. Vitin 1999 Ministria e brendshme e Maqedonisë ka paraqitur 19 raste të lidhura me prostitucionin. Njëmbëdhjetë prostituta janë arrestuar gjatë aksioneve të policisë nëpër bordelle. Krahasuar me vitin e mëparshëm (1998), kjo përbën një përmirësim. Në vitin 1998 policia ka arrestuar 21 persona me akuzën për përfshirje në prostitucion. Megjithatë këto shifra zyrtare tregojnë edhe rritjen e madhe të prostitucionit në Maqedoni gjatë dhjetëvjeçarit të fundit. Metodat dhe veprimet e policisë duket se janë të pafuqishme për të luftuar këtë problem në rritje. Mungesa e profesionalizmit nga ana e disa oficerëve dhe përfshirja e vetë policisë në biznesin e prostitucionit janë dy nga shkaqet kryesore për këtë dështim.<sup>59</sup>

#### **4.2 Analizë e të dhënave të përfituara përmes metodës së anketimit**


Në kuadër të këtij hulumtimi shkencor kam shfrytëzuar një nga metodat sasiore të cilën e kam shfrytëzuar për hulumtim të fenomenit të prostitucionit. Anketimi përbën një nga metodat themelore kuantitative me anë të së cilës kam grumbulluar të dhëna me anë të së cilave kam qëllim të plotësoj njohuritë mbi fenomenin e prostitucionit. Me anë të këtyre të dhënave kuptohet qëndrimi i opinionit publik mbi këtë fenomen dhe duke e krahasuar me gjendjen aktuale mund të përcaktohen nevojat për ndryshim ose intervenim shtetëror për të kontrolluar këtë fenomen.

---

<sup>59</sup> Latifi, Veton, “Prostitucioni i Organizuar në Maqedoni”, artikull, <https://iwpr.net/sq/global-voices/prostitucioni-i-organizuar-n%C3%AB-maqedoni>


Anketa është drejtuar personave mbi moshën 18 vjeç dhe te të anketuarit përfshihen persona të grup-moshave të ndryshme, personave me edukim të ndryshëm, personave të gjinisë femërore dhe mashkullore përafërsisht në masë të njëjtë, personave me etnitete të ndryshme, me besim fetar të ndryshëm në atë mënyrë që edhe rezultati i anketës të jetë sa më objektiv, gjithpërfshirës dhe të pasqyrojë realitetin objektiv.

Në pyetësin e anketës përfshihen tre pyetje për cilësitë personale të të anketuarve dhe 9 pyetje të cilat janë të lidhura me aspektet të ndryshme të fenomenit të prostitucionit. Të anketuarit janë pyetur për gjininë me anë të së cilës kam qëllimin të përcaktoj qëndrimin e të dy gjinive lidhur me objektin e studimit të këtij punimi. Të njëjtët janë pyetur edhe për moshën dhe nivelin e shkollimit të tyre, e cila po ashtu si e para ka për qëllim të kategorizojë qëndrimet sipas kategorisë sociale përkatëse.



**Grafikoni nr.2** – Të dhënat mbi gjininë e të anketuarve


Në grafikonin nr.2 janë paraqitur të dhënat mbi gjininë e të anketuarve e shprehur në



përqindje. Qëllimi anketës në raport me gjininë e anketuarve ka qënë që reporti mes dy gjinive të jetë i barabartë dhe në të dhënat përfundimtare rezulton që të anketuarit meshkuj të jenë 46% ndërsa të anketuarit femra të jenë 54%. Ky raport më së miri përfshin qëndrimin objektiv, duke u nisur nga fakti që nga ky fenomen është më e dëmtuar gjinia femërore si gjini që e ushtron këtë profesion (në shumicën e rasteve edhe të detyruara me dhunë) dhe nga ana tjetër meshkujt në këtë veprimtari shfaqen si blerës të shërbimeve të prostitucionit. Përveç rasteve të, ku meshkujt mund të paraqiten si ofrues të këtyre shërbimeve dhe në të njëjtën kohë meshkujt të blejnë po ato shërbime. Në raste të rralla, po ashtu femrat mund të jenë blerës të këtyre shërbimeve nga meshkujt.


### **Grafikoni nr.3 – Të dhënat mbi moshën e të anketuarve**

Në grafikonin nr.3 janë shprehur të dhënat mbi moshën e të anketuarve. Mosha minimale e të anketuarve është përcatuar 18 vjeç në atë mënyrë që edhe rezultati i ankimit të jetë i lidhur me pjekurinë e personave të pyetur dhe të reflektojë qëndrim më serioz. Të anketuarit janë ndarë në 4 grupmosha: Grupi i parë përfshin të anketuarit nga mosha 18 deri në moshën 25 vjeç, të cilët përbëjnë 50% të të anketuarve; Grupi i dytë përfshin të anketuarit nga mosha 26 deri në moshën 35 vjeç, të cilët përbëjnë 14% të të anketuarve; Grupi i tretë përfshin të anketuarit nga mosha 36 deri në moshën 45 vjeç, të cilët përbëjnë 20% të të anketuarve; Grupi i katërt përfshin të anketuarit nga mosha 46 e sipër, të cilët përbëjnë 16% të të anketuarve.



**Grafikoni nr.4** – Të dhënat mbi nivelin e edukimit e të anketuarve

Të dhënat e pasqyruara në grafikun nr.4 janë të lidhura me edukimin e të anketuarve. Duke qënë se arsimimi paraqet nivelin intelektual dhe pjekurinë e mendimit dhe shqyrtimit të fenomeneve shoqërore, përgjigjet e dhëna nga të anketurit me nivel të ndryshëm arsimi do të analizohen veç e veç në raport me fenomenin e prostitucionit. 10% të të anketuarve kanë qënë me Arsim të mesëm; përqindja më e madhe e të anketuarve kanë qënë me nivel arsimit të lartë (bachelor) 66% ndër të cilët janë përfshirë edhe persona që kanë përfunduar arsimin e lartë 4 vjeçar; 20% e të anketuarve janë me nivel arsimim magjistër të diplomuar (Master); me nivel arsimimi të ciklit të tretë universitar (doktorë shkence) të përfunduar paraqiten 2% të të anketuarve dhe po ashtu 2% nga të anketuarit nuk i janë përgjigjur pyetjes për nivelin e shkollimit të tyre.




**Grafikoni nr.5** – Të dhënat e përfituara nga përgjigjet e pyetjes: Sa ndikojnë faktorët ekonomik në zhvillimin e prostitucionit?

Grafiku nr. 5 paraqet të dhënat e mbledhura nga pyetja: Sa ndikojnë faktorët ekonomik në zhvillimin e prostitucionit? Kjo pyetje është e lidhur me faktorët të cilët ndikojnë në zhvillimin e fenomenit të prostitucionit, konkretisht me faktorët ekonomik. Faktorët ekonomik jo rrallë herë janë faktorë të cilët ndikojnë në zhvillimin e kriminalitetit në përgjithësi, dhe në zhvillimin e prostitucionit në veçanti si formë e kriminalitetit.

Nga ana tjetër faktorët që ndikojnë në zhvillimin e kriminalitetit, në rastin konkret prostitucionit, janë një tregues kriminologjik me anë të së cilave duhet të organizohet veprimi i shtetit për të zvogëluar ose penguar zhvillimin e prostitucionit. Në këtë rast shteti-shoqëria, mund të ndikojë në mënyrë direkte në uljen e kriminalitetit që buron nga prostitucioni duke aplikuar politika për rritje ekonomike dhe zhvillim ekonomik.

Duke u bazuar në të dhënat e grafikoni nr.5, rezulton se 72% e të anketuarve janë përgjigjur SHUMË, 26% e të anketuarve janë përgjigjur MESATARISHT dhe vetëm 2% janë përgjigjur me ASPAK. Pra, në opinionin publik mbizotëron mendimi se faktorët ekonomik ndikojnë në nivel të lartë në zhvillimin e prostitucionit, që nënkupton nga ana tjetër se gjendja ekonomike e femrave në shoqëri ndikon në nivel të lartë në vendimin e tyre për të ushtruar prostitucion si veprimatri për të relazuar të ardhura dhe për të siguruar ekzistencën.




**Grafikoni nr.6** – Të dhënat e përfituara nga përgjigjet e pyetjes: Sa ndikojnë faktorët psikologjik në zhvillimin e prostitucionit?

Grafiku nr. 6 paraqet të dhënat e mbledhura nga pyetja: Sa ndikojnë faktorët psikologjik në zhvillimin e prostitucionit? Gjithashtu, edhe kjo pyetje është e lidhur me faktorët të cilët ndikojnë në zhvillimin e fenomenit të prostitucionit, konkretisht me faktorët psikologjik. Këto faktorë janë të lidhura me tipologjinë psikologjike të personave që merren me prostitucion.

Duke u bazuar në të dhënat e grafikoni nr.6, rezulton se 18% e të anketuarve janë përgjigjur SHUMË, 64% e të anketuarve janë përgjigjur MESATARISHT dhe 18% janë përgjigjur me ASPAK. Siç vërehet nga rezultati i mësipërm, në raport me faktorët ekonomik, faktorët psikologjik ndikojnë më pak në zhvillimin e prostitucionit por nuk është përjashtuar mundësia që edhe si pasojë e tipareve psikologjike mund të zhvillohet prostitucioni.

Pra, angazhimi i shtetit duhet të orientohej edhe nga ky drejtim. Shteti duhet të praktikojë politika për rritjen e shëndetit mendor publik duke e promovuar shërbimet psikologjike, në mënyrë që të ndikojë në pasojat që vijnë nga gjendaj psikologjike e personave të caktuar në shoqëri.




**Grafikoni nr.7** – Të dhënat e përfituara nga përgjigjet e pyetjes: Sa ndikojnë faktorët socio-kulturor në zhvillimin e prostitucionit?

Grafiku nr. 7 paraqet të dhënat e mbledhura nga pyetja: Sa ndikojnë faktorët socio-kulturor në zhvillimin e prostitucionit? Këtu është synuar që të analizohen me faktorët të cilët ndikojnë në zhvillimin e fenomenit të prostitucionit, konkretisht faktorët socio-kulturor. Këto faktorë janë të lidhura me standardin jetësor, mosdiskriminimin, barazinë, zbatimin e lirive dhe të drejtave të qytetarëve etj.

Duke u bazuar në të dhënat e grafikoni nr.7, rezulton se 40% e të anketuarve janë përgjigjur SHUMË, 48% e të anketuarve janë përgjigjur MESATARISHT dhe 12% janë përgjigjur me ASPAK. Kjo nënkupton se faktorët socio-kulturor ndikojnë në një masë jo të vogël në zhvillimin e prostitucionit.

Kështu, shteti mund të ndikojë në uljen e kriminalitetit që buron nga prostitucioni duke aplikuar politika për rritjen e standardit jetësor, zvogëlimin e diskriminimit, rritjen e barazisë mes qytetarëve, garantimin e zbatimit të së drejtave të qytetarëve.



**Grafikoni nr.8** – Të dhënat e përfituara nga përgjigjet e pyetjes: Sa ndikon niveli i arsimit në zhvillimin e prostitucionit?

Grafiku nr. 8 paraqet të dhënat e mbledhura nga pyetja: Sa ndikon niveli i arsimit në zhvillimin e prostitucionit? Qëllimi i parashtrimit të kësaj pyetje është të përcaktohet nëse edukimi ndikon në zhvillimin e prostitucionit dhe nëse arsimimi arrin të mposhtë faktorët e tjerë të përmendur më sipër.

Duke u bazuar në të dhënat e grafikoni nr.8, rezulton se 36% e të anketuarve janë përgjigjur SHUMË, 38% e të anketuarve janë përgjigjur MESATARISHT dhe 26% janë përgjigjur me ASPAK. Duke vërejtur rezultatet, konkludoj se niveli i arsimit është një nga faktorët që ndikojnë në zhvillimin e prostitucionit, megjithatë nëse e krahasojmë me faktorët e tjerë, ky i fundit është faktori i cili ndikon më pak në zhvillimin e prostitucionit. Kështu, edhe pse arsimimi ndikon në uljen e veprimtarisë së prostitucionit, përsëri ky është një faktor i cili nuk mund të mposhtë faktorët e tjerë si ato ekonomik, psikologjik dhe socio-kulturor.

Gjithsesi, arsimi i shoqërisë do të ndikojë në pengimin e zhvillimit të prostitucionit pranadaj shteti duhet të promovojë në nivel më të lartë arsimimin e shoqërisë.

| # | Pyetja                 | Nuk dikon | Ndikon |
|---|------------------------|-----------|--------|
| 1 | Faktoret ekonomik      | 2.00%     | 98.00% |
| 2 | Faktoret psikologjik   | 18.00%    | 82.00% |
| 3 | Fakoret socio-kulturot | 12.00%    | 88.00% |
| 4 | Niveli i arsimit       | 26.00%    | 74.00% |


**Tabela nr. 1:** Të dhënat e përgjithshme mbi faktorët që ndikojnë në zhvillimin e prostitucionit

Në tabelën nr.1 janë paraqitur të dhënat e përgjithshme mbi faktorët që ndikojnë në rritjen e prostitucionit, por konkretisht në këndvështrimin e ndikimit ose mosndikimit. Nga të dhënat e paraqitura në tabelë konstatohet se faktori i cili më së shumti ndikon në zhvillimin e prostitucionit është ekonomia ku 98% e të anketuarve mendojnë kështu. Faktori i dytë që më



shumë ndikon në zhvillimin e prostitucionit është aspekti socio-kulturor, ku 88% e të anketuarve mendojnë kështu. 82% e të anketuarve mendojnë se faktorët psikologjik ndikojnë në zhvillimin e prostitucionit, ndërsa 72% e të anketuarve mendojnë që niveli i arsimit (arsimimi i ulët, analfabetizmi) është faktor për zhvillimin e prostitucionit.

Duke u nisur nga kjo pasqyrë e faktorëve që ndikojnë në zhvillimin e prostitucionit, mund të përcaktojmë angazhimin e shtetit dhe ndikimin e tij në faktorët konkret në mënyrë që të pengojmë zhvillimin e prostitucionit. Duke u nisur nga këto të dhëna, faktori kryesor që nxit zhvillimin e prostitucionit është ekonomia, prandaj rritja e standardit ekonomik do të ul zhvillimin e prostitucionit. Mirëpo, e patjetërsueshme është edhe nevoja për të intervenuar në ndalimin e diskriminimit, zbatimin e lirive dhe të drejtave të njeriut, forcimin e rolit të psikologut në shoqëri, angazhimi në zhvillimin e sistemit edukativo-arsimor etj.



**Grafikoni nr.9** – Të dhënat e përfituara nga përgjigjet e pyetjes: Sa është lidhur fenomeni i prostitucionit, me forma të tjera të kriminalitetit?

|                                      | <b>Është i lidhur</b> | <b>Nuk është i lidhur</b> |
|--------------------------------------|-----------------------|---------------------------|
| <b>Dhuna</b>                         | 100.00%               | 0.00%                     |
| <b>Perdorimi i lendeve narkotike</b> | 97.96%                | 2.04%                     |
| <b>Trafikimi i lendeve narkotike</b> | 93.88%                | 6.12%                     |
| <b>Trafikimi me qenie njerezore</b>  | 96%                   | 4%                        |
| <b>Vepra penale kunder pasurise</b>  | 64.00%                | 36.00%                    |

**Tabela nr 2:** Të dhënat e përgjithshme mbi realizimin e veprave tjera penale si pasojë e veprimtarisë së prostitucionit

Rezultatet në grafikun nr.9 dhe në tabelën nr.2 janë grumbulluar nga përgjigjet e marra mbi pyetjen *Sa është lidhur fenomeni i prostitucionit, me forma të tjera të kriminalitetit?* Ideja për të parashtruar këtë pyetje ka dale nga nevoja për të përcaktuar sa ndikon prostitucioni në kryerjen e veprave penale tjera. Në literaturën juridike kriminologjike theksohet se prostitucioni është faktor që ndikon në kryerjen e disa veprave tjera penale si: dhuna, përdorimi i mjeteve narkotike, trafikimi i mjeteve narkotike, vjedhja etj. Prandaj edhe pyetja e parashtruar është e lidhur me këto vepra penale.

Pyetjes, sa është i lidhur prostitucioni me dhunën? 0% e të anketuarve mendojnë se nuk është e lidhur dhuna me prostitucionin, ndërsa 100% e të anketuarve mendojnë se dhuna është e lidhur me prostitucionin. Kjo nënkupton se prostitucioni në nivel të lartë është i lidhur me ushtrimin e dhunës, përfshirë këtu dhunën fizike dhe psikologjike.


Pyetjes, sa është i lidhur prostitucioni me përdorimin e lëndëve narkotike? 2.04% e të anketuarve mendojnë se nuk është e lidhur përdorimi i lëndëve narkotike me prostitucionin, ndërsa 97.96% e të anketuarve mendojnë se përdorimi i lëndëve narkotike është i lidhur me prostitucionin. Konkluzioni këtyre të dhënave shpreh se përdorimi i lëndëve narkotike është fenomen dhe në të njëjtë kohë shkelje ligjore që është i lidhur me prostitucionin.

Pyetjes, sa është i lidhur prostitucioni me trafikimin e lëndëve narkotike? 6.12% e të anketuarve mendojnë se nuk është e lidhur trafikimi i lëndëve narkotike me prostitucionin, ndërsa 93.88% e të anketuarve mendojnë se trafikimi i lëndëve narkotike është i lidhur me prostitucionin. Duke u bazuar në këto të dhëna rezulton se krahas përdorimit edhe trafikimi i lëndëve narkotike është veprimtari kundërligjore e cila është e lidhur me prostitucionin.

Pyetjes, sa është i lidhur prostitucioni me trafikimin e qënieve njerëzore? 4% e të anketuarve mendojnë se nuk është e lidhur trafikimin i qënieve njerëzore me prostitucionin, ndërsa 96% e të anketuarve mendojnë se trafikimin i qënieve njerëzore është i lidhur me prostitucionin. Siç e konfirmon anketimi, trafikimi i qënieve njerëzore është veprimtari e kundërligjshme e cila është e lidhur me prostitucionin.

Pyetjes, sa është i lidhur prostitucioni me veprat penale kundër pasurisë? 36% e të anketuarve mendojnë se nuk janë të lidhura veprat penale kundër pasurisë me prostitucionin, ndërsa 64% e të anketuarve mendojnë se janë të lidhura veprat penale kundër pasurisë me prostitucionin. Si rezultat i këtyre të dhënave veprat penale kundër pasurisë janë të lidhura me prostitucionin në nivel më të ulët se sa veprat penale të sipër përmendura.

Siç është përmendur edhe më lartë në këtë punim, prostitucioni është një veprimtari e cila është e lidhur zinxhir me disa fenomene negative të tjera.




**Grafikoni nr.10** – Të dhënat e përfituara nga përgjigjet e pyetjes: Sa efekte negative krijon prostitucioni në shoqëri?

Duke u nisur nga fakti se rregullativa ligjore vendoset nga shoqëria përmes “kontratës shoqërore”, për të mbrojtur veten nga veprimet që çenojnë të mirat juridike ose vlerat shoqërore, është e domosdoshme që të kemi idenë e qartë se në çfarë niveli prostitucioni e rrezikon të mirën juridike ose vlerat e shoqërisë. Prandaj nga të anketuarit është kërkuar që të shprehen mbi efektet që krijon prostitucioni në shoqëri.

Të dhënat nga grafikoni nr.10 shprehin idenë e të anketuarve mbi nivelin e efekteve negative që shkakton prostitucioni në shoqëri. 6.12% e tyre mendojnë se prostitucioni nuk shkakton pasoja në shoqëri, ndërsa 93.87% e tyre mendojnë se prostitucioni shkakton efekte negative në shoqëri nga të cilët, 36.73% mendojnë se prostitucioni shkakton MESATARISHT efekte negative dhe 57% e tyre mendojnë se se prostitucioni shkakton SHUMË efekte negative në shoqëri.

Konkluzioni i rezultatit të përfituar çon në idenë se shteti duhet të ushtrojë kontroll më të lartë ndaj këtij fenomeni negativ i cili çënon më shumë të mira dhe vlera të shoqërisë të cilat janë të mbrojtura nga normat juridike.



**Grafikoni nr.11** – Të dhënat e përfituara nga përgjigjet e pyetjes: A duhet të legalizohet prostitucioni?

Duke hulumtuar mbi fenomenin e prostitucionit, vjen natyrshëm nevoja për të sqaruar idenë e legalizimit të prostitucionit. Nga ana tjetër, duke e ditur se shumë shoqëri e kontrollojnë prostitucionin duke e legalizuar atë dhe shumë të tjera nuk e lejojnë aspak zhvillimin e një veprimtarie të tillë, por përsëri çdo shoqëri përballlet me këtë fenomen. Pra, kur ne i përgjigjemi pyetjes „A duhet legalizuar prostitucioni?,,, ne realisht nënkuptojmë a dëshirojmë të

kontrollojmë prostitucionin duke e lejuar të zhvillohet nën kushtet që përcakton ligji apo dëshirojmë ta kontrollojmë prostitucionin duke e luftuar zhvillimin e tij.

Në këtë aspekt, të anketuarit janë pyetur: „A duhet të legalizohet prostitucioni?„ Rezultati i marrë nga anketimi tregon se në opinionin publik ekziston mendimi në masë më të madhe se nuk duhet të legalizohet prostitucioni edhe atë në një përqindje prej 66%. Nga ana tjetër 32% e tyre mendojnë se duhet të legalizohet prostitucioni dhe 2% e të anketuarve janë shprehur se nuk duan të japin përgjigje mbi këtë.

Megjithatë për të pasur një opinion më të qartë mbi legalizimin është bërë kombinimi i përgjigjeve të dhëna në raport me moshën e tyre dhe në raport me nivelin e arsimimit të tyre. Kjo është e pasqyruar në tabelën nr. 3 dhe tabelën nr. 4, si më poshtë.

|                                   |                               | Grup moshat e anketuara |         |         |         |       |
|-----------------------------------|-------------------------------|-------------------------|---------|---------|---------|-------|
|                                   |                               | Total                   | 18 - 25 | 26 - 35 | 36 - 45 | > 46  |
| A duhet legalizuar prostitucioni? | Po                            | 32.0%                   | 28.0%   | 42.9%   | 50.0%   | 12.5% |
|                                   | Jo                            | 66.0%                   | 68.0%   | 57.1%   | 50.0%   | 87.5% |
|                                   | Nuk preferoj te jap pergjigje | 2.0%                    | 4.0%    | 0.0%    | 0.0%    | 0.0%  |

**Tabela nr 3:** Të dhënat mbi grupmoshat e të anketuarve në raport me legalizimin e prostitucionit në RMV

Grupmosha më re nga 18 deri më 25 vjeç janë shprehur për mos legalizimin e prostitucionit edhe atë në raport 68%. Mosha nga 26 deri më 35 vjeç janë shprehur kundër legalizimit por në raport më të ulët në krahasim me grupmoshën paraprake edhe atë me 57%. Ky raport është ulur akoma me rritjen e moshës ku grupmosha 36-45 vjeç ka një raport prej 50%-50% në raport me legalizimin e prostitucionit. Nga ana tjetër grupmosha mbi 46 vjeç janë shprehur kundër legalizimit edhe atë në masën prej 87.5%.


Siç vërehet nga këto të dhëna grupmosha me e re dhe grupmosha më e vjetër kanë përqindjen më të lartë të kundërshtimit të legalizimit të prostitucionit. Sipas kësaj, konstatoj se mosha më e re ka arritur në këtë rezultat si pasojë e përvojës së ulët jetësore ndërsa grupmosha më e madhe si pasojë e përvojës më të lartë por edhe duke u ndikuar nga mentaliteti më i ngurtë dhe konservatizmi.

|                                   |                               | Niveli i edukimit të të anketuarve |                           |                     |                      |                            |
|-----------------------------------|-------------------------------|------------------------------------|---------------------------|---------------------|----------------------|----------------------------|
|                                   |                               | Arsim të mesëm                     | Arsim të lartë (Bachelor) | Magjistraturë (MSc) | Doktor shkence (PhD) | Preferoj të mos përgjigjem |
| A duhet legalizuar prostitucioni? | Total                         | 32.0%                              | 40.0%                     | 27.3%               | 50.0%                | 0.0%                       |
|                                   | Po                            | 32.0%                              | 40.0%                     | 27.3%               | 50.0%                | 0.0%                       |
|                                   | Jo                            | 66.0%                              | 60.0%                     | 69.7%               | 50.0%                | 100.0%                     |
|                                   | Nuk preferoj te jap pergjigje | 2.0%                               | 0.0%                      | 3.0%                | 0.0%                 | 0.0%                       |

**Tabela nr 4:** Të dhënat mbi nivelin e edukimit të të anketuarve në raport me legalizimin e prostitucionit në RMV

Nga ana tjetër nëse e analizojmë mendimin mbi legalizimin e prostitucionit në raport me nivelin e arsimit të të anketuarve do të vërejmë se rezultati tregon se niveli i arsimit sa më i ulët të jetë aq më shumë mbizotëron mendimi nuk duhet të legalizohet prostitucioni dhe sa më i lartë të jetë arsimit aq më tepër mbizotëron mendimi se duhet të legalizohet prostitucioni.

Kjo sjell në përfundimin se, nëse bazohemi në mendimin e personave me arsim të lartë ka më shumë gjasë që të legalizojmë prostitucionin sesa nëse bazohemi në kategorinë e personave me arsim më të ulët.




**Grafikoni nr.12** – Të dhënat e përfituara nga përgjigjet e pyetjes: Legalizimi i prostitucionit dhe kontrolli i shtetit do të ulë pasojat negative në shoqëri?

Duke u nisur nga fakti se qëllim i legalizimit të prostitucionit është të vendoset kontroll në këtë veprimtari dhe përmes këtij kontrolli të ulen edhe efektet negative që prostitucioni mund

t'i shkaktojë, kam kërkuar nga të anketuarit t'i përgjigjen pyetjes: „Legalizimi i prostitucionit dhe kontrolli i shtetit, a do të ulë pasojat negative në shoqëri?,,

50% e të anketuarve mendojnë se legalizimi i prostitucionit dhe kontrolli i shtetit nuk do të ulin efektet negative të prostitucionit në shoqëri, ndërsa 46% e të anketuarve janë shprehur se nëse legalizohet prostitucioni dhe me këtë vendoset kontroll i shtetit në këtë veprimtari, do të ulen efektet negative që sjell prostitucioni.

Për dallim nga shumë pyetje të tjera që janë parashtruar në përgjigjet e kësaj pyetje, konkretisht në rezultatet e saj, nuk vërehet një verdikt konkret, duke qënë se rezultatet janë të përafërta. Megjithatë, nga ky rezultat vërehet se kontrolli i shtetit në rastin e legalizimit të prostitucionit mund të ulë ndjeshëm dhunimin e prostitutave, trafikimin me qenie njerëzore, përdorimin e lëndëve narkotike, transmetimin e sëmundjeve seksualisht të transmetueshme etj.




**Grafikoni nr.13** – Të dhënat e përfituara nga përgjigjet e pyetjes: A duhet të sanksionohet me ligj edhe blerja e shërbimeve të prostitucionit?

A mund të ekzistojë prostitucioni nëse nuk ka kush e blen atë? Sigurisht, jo. Prandaj rol të madh në zhvillimin e prostitucionit ka kategoria e personave që e blejnë atë, pra konsumatorët e prostitucionit. Duke pasur këtë rëndësi, blerja e prostitucionit është sanksionuar në disa shtete si psh. në Suedi.

Të anketuarit janë pyetur mbi këtë dimension të prostitucionit dhe u është kërkuar të përgjigjen mbi këtë pyetje: A duhet të sanksionohet me ligj edhe blerja e shërbimeve të prostitucionit?

10% e të anketuarve nuk kanë dëshiruar të japin përgjigje, pra nuk kanë shprehur mendimin e tyre mbi këtë gjë. 20% e të anketuarve janë shprehur kundër sanksionimit me ligj të personave që blejnë këtë shërbim ndërsa pjesa më e madhe e të anketuarve në nivelin prej 70% janë shprehur se blerja e shërbimeve seksuale duhet të sanksionohet me ligj. Pra në opinionin publik mbizotëron ideja që duhet të sanksionohen personat të cilët blejnë shërbime seksuale. Ky është një vendim i drejtë nëse duam që të ulim zhvillimin e prostitucionit, sepse duke penguar konsumatorët e prostitucionit ulim edhe ofertën, që nënkupton, automatikisht ulim edhe zhvillimin e prostitucionit.




**Grafikoni nr.14** – Të dhënat e përfituara nga përgjigjet e pyetjes: Legalizimi i prostitucionit ndikon në zhvillimin ekonomik dhe rritjen e turizmit?

Në literature mund të gjejmë edhe efekte pozitive të cilat i sjell zhvillimi i prostitucionit. Një ndër efektet pozitive të prostitucionit konsiderohet të jetë rritja e turizmit dhe bashkë me të edhe rritja ekonomike.

Në anketë është parashtruar pyetja: „A ndikon legalizimi i prostitucionit në zhvillimin ekonomik dhe rritjen e turizmit?„ Për këtë pyetje kam marrë përgjigjen negative, në nivel prej 36.73%, ndërsa përgjigje pozitive kanë dhënë 63.26%. Ata që kanë dhënë përgjigje pozitive,




dmth që mendojnë se legalizimi i prostitucionit sjell zhvillim ekonomik janë të ndarë në dy kategori. Kategoria e parë e tyre ose 51.02% e të anketuarve mendojnë se legalizimi i prostitucionit MESATARISHT ndikon në zhvillim e turizmit dhe zhvillimin ekonomik, ndërsa kategoria dytë e të anketuarve të cilët përbëjnë 12.24%, mendojnë se legalizimi i prostitucionit ndikon në zhvillimin ekonomik dhe atë të turizmit.



**Grafikoni nr.15** – Të dhënat e përfituara nga përgjigjet e pyetjes: A mund ta eliminojë shoqëria tërësisht prostitucionin?

Prostitucioni është një veprimtari e lashtë, siç është theksuar edhe më sipër në këtë punim, e cila ka filluar të praktikohet që në hapat e parë të shoqërisë dhe po vazhdon të praktikohet edhe sot e kësaj dite. Duke qënë veprimtari gjithpërfshirëse e cila praktikohet në të gjitha shoqëritë, konsiderohet se prostitucioni është vështirë të çrrënjoset nga shoqëria. Megjithatë kjo është parashtruar si pyetje për të anketuarit në formën: A mund ta eliminojë shoqëria tërësisht prostitucionin?

Nga rezultatet e marra vërehet se ekziston një numër jo i vogël i personave që mendojnë se shoqëria mund të mposht prostitucionin dhe ashtu mendojnë 46% të të anketuarve. Nga ana tjetër, 52% e të anketuarve mendojnë se shoqëria nuk mund të eliminojë prostitucionin.



**Grafikoni nr.16** – Të dhënat e përfituara nga përgjigjet e pyetjes: Sa është i angazhuar shteti në luftimin e fenomenit të prostitucionit?

Që të eliminohet prostitucioni si veprimtari në shoqëri duhet që shteti të angazhohet në nivel maksimal për të arritur këtë. Por, sa është niveli i angazhimit të shtetit në luftimin e prostitucionit, është kërkuar të jepet mendim nga të anketuarit. Pyetjes, „Sa është i angazhuar shteti në luftimin e fenomenit të prostitucionit?“, të anketuarit janë përgjigjur në dy forma me pohim dhe mohim duke përcaktuar nivelin e angazhimit të shtetit. 32% e të anketuarve mendojnë se shteti nuk është i angazhuar ASPAK në luftimin e prostitucionit, 68% përqind e të anketuarve mendojnë se shteti MESATARISHT është angazhuar në luftimin e prostitucionit dhe asnjëri (0%) nga të anketuarit nuk mendon se shteti është SHUMË i angazhuar në luftimin e prostitucionit.

Duke u bazuar në këto të dhëna, arrihet në përfundim se shteti nuk ka dhënë përshtypjen në opinion se po lufton prostitucionin në masën e duhur dhe kjo përshtypje e krijuar vjen si pasojë e asaj që në media kohë pas kohe gjen informacion mbi zhvillimin e prostitucionit në zona të ndryshme të shtetit.

#### 4.3 Pengimi i prostitucionit

Në literaturën kriminologjike, me të drejtë shtrohet pyetja se çfarë duhet ndërmarrë lidhur me pengimin e kësaj dukurie negative. Qysh në kohërat më të hershme, është shtruar problemi se a duhet të legalizohet apo duhet të ndalohet prostitucioni në një vend. Në këtë drejtim, edhe në teori edhe në praktikë të shteteve të ndryshme, ka patur zgjidhje të llojllojshme.

Një numër i autorëve dhe mendimtarëve ka qenë për legalizimin e prostitucionit, ndërsa një numër tjetër e ka kundërshtuar këtë. Në shumë vende të botës, sot kjo veprimtari është e legalizuar. Në qendrat e mëdha botërore, janë të njohura vendet dhe shtëpitë publike ku prostitucioni kryhet në mënyrë legale. Në këtë drejtim, flitet për lagje, kuarte dhe rrugë të veçanta, ku janë të koncentruara të ashtuqujturat shtëpi publike. Këto kuarte dallohen për nga dukja e tyre, sepse janë të stolisura dhe natën shkëlqejnë me qëllim që të joshin sa më shumë mysafirë dhe klientë. Këto kuarte quhen edhe kuarte me "llampa të kuqe", "lagje të dashurisë", etj.

Autorët dhe mendimtarët të cilët janë për legalizimin e prostitucionit, parashtojnë disa përparësi. Në rend të parë, prostitucioni i legalizuar mund të kontrollohet nga shteti. Kushtet dhe niveli shëndetësor e higjenik i shtëpive publike dhe prostitutave, në këtë mënyrë mund të jetë përherë në kontroll të institucioneve shëndetësore. Prostitucioni i legalizuar pengon përhapjen e sëmundjeve të ndryshme venerike dhe epidemive të tjera. Nga ana tjetër shteti ka interes të veçantë nga kjo veprimtari, sepse mbledh tatime dhe taksa që mund të përdoren për qëllime dhe nevoja sociale dhe humane. Po ashtu, legalizimi i prostitucionit ngushton rrethin e kyçjes së organizatave dhe grupeve kriminale në organizimin e prostitucionit.

Nga ana tjetër, kundërshtarët e legalizimit të prostitucionit, theksojnë se lejimi i tij është amoral, se kryerja e prostitucionit në mënyrë publike e nxit rininë në mosrespektimin e rregullave dhe normave morale të kontaktit në mes të gjinive dhe ndikon në dobësimin e interesimit të të rinjve për lidhjen e bashkësive martesore në mënyrë të rregullt dhe normale. Po ashtu legalizimi i prostitucionit, sipas këtyre është në kundërshtim me rregullat dhe normat morale e fetare, ngase prostitucioni cenon nderin dhe dinjitetin e familjes. Lejimi i prostitucionit ndikon te të rinjtë që ata t'i preferojnë lidhjet dhe kontaktet seksuale në mënyrë të egër dhe të pakontrolluar, nga e cila mund të ketë pasoja të rënda familja edhe shoqëria. Mirëpo edhe prostitucioni ilegal, i fshehtë, i egër, me vete sjell shumë dukuri të rrezikshme dhe negative. Ky prostitucion i kontribuon edhe përhapjes së sëmundjeve venerike, kohëve të fundit edhe të AIDS-it (sidës) e cila është e pashërueshme dhe po shkakton viktima të mëdha. Këto dhe mendime të tjera, kanë qenë përherë të pranishme kur është shtruar problemi i legalizimit të prostitucionit.

Pa marrë parasysh këto ide të ndryshme mund të konstatohet se prostitucioni vazhdon të zhvillohet në botën bashkëkohore në përmasa të mëdha, edhe në ato vende ku është legalizuar,

po edhe në ato të tjerat ku është i ndaluar. Përveç pasojave të rënda për vetë personat të cilët merren me prostitucion e posaçërisht për ndikimin negativ në gjeneratën e re, prostitucioni, si dukuri socio-patologjike, ka lidhje dhe ndikim të caktuar edhe me sjelljet kriminale. Në këtë drejtim ai konsiderohet faktor i sjelljes kriminale në bashkësinë bashkëkohore. Disa autorë përmendin sisteme të ndryshme të qëndrimit të shoqërisë ndaj prostitucionit në botën bashkëkohore: Sistemi i tolerimit sipas të cilit shteti nuk e pengon këtë dukuri negative. Prostitucioni kryhet haptas dhe pa kurrfarë kontrolli nga organet shtetërore.

- **Sistemi i legalizimit.** Sipas këtij sistemi prostitucioni mbikqyret dhe rregullohet nga ana e shtetit, nënkupton që shteti lejon hapjen e shtëpive publike, i mbikëqyr dhe i kontrollon ato. Nga ana tjetër, prostitutet i nënshtrohen kontrollit mjekësor, ato zakonisht janë të regjistruara dhe shtetit i paguajnë taksë të veçantë.
- **Sistemi i abolicionit.** Sipas këtij sistemi, shteti vetëm formalisht e ndalon prostitucionin publik nëpër shtëpi publike, mirëpo nga ana tjetër, e toleron ekzistimin e të ashtuquajturit prostitucion faktik, i cili në forma të ndryshme është i pranishëm në shoqëri.
- **Sistemi i prohibicionit.** Sipas këtij sistemi, prostitucioni ndalohet plotësisht. Personat të cilët organizojnë prostitucionin dhe vetë prostitutat, sipas këtij sistemi ndiqen e ndëshkohen dhe ndaj tyre ndërmerren masa të ndryshme represive.<sup>60</sup>

---

<sup>60</sup>Halili, Ragip, Kriminologjia, botimi i shtatë, Prishtinë, 2011, fq.296-298

## PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Prostitucioni paraqet një sjellje negative-devijante të shoqërisë e cila ndikon në çrregullimin e funksionimit normal të raporteve në mes të sekseve në shoqëri dhe si e tillë kjo dukuri konsiderohet e dëmshme dhe e papranueshme. Vetë prostitucioni ka të bëjë me dukurinë e marrëdhënieve seksuale, kryesisht të personat e gjinisë femërore me një numër të pacaktuar të personave të gjinisë mashkullore në këmbim të interesit financiar.

Nga rezultatet e kërkimeve empirike kriminologjike në botën bashkëkohore dhe nga të dhënat e statistikave policore dhe gjyqësore, del se faktorët të cilët e kushtëzojnë prostitucionin janë të shumtë dhe të ngjashëm me faktorët që kushtëzojnë edhe kriminalitetin në një vend. Në rend të parë, si faktor theksohet gjendja e vështirë ekonomike dhe materiale, faktorët psikologjik, socio-kulturor, edukimi, etj. Hulumtimi i faktorëve që ndikojnë në zhvillimin e prostitucionit do të na mundësojmë të japim konkluzione mbi intervenimet që duhet të realizohen në mënyrë që të arrijmë të parandalojmë këtë veprimtari kriminale.

Duke qënë se prostitucioni si fenomen zhvillohet nga kërkesa e vazhdueshme që ekziston për blerjen e këtyre shërbimeve, shteti duhet të marrë iniciativë për të sanksionuar blerësit e shërbimeve seksuale nga prostitutat. Kështu një nga sugjerimet e këtij punimi është sanksionimi me norma juridike blerësve të shërbimeve të prostitucionit, e cila do të mundësojë që shteti të ndikoj në faktorin kryesor i cili nxit prostitucionin.

Prostitucioni, si dukuri socio-patologjike, përveç se vetvetiu është i dëmshëm dhe i rrezikshëm, ka edhe një varg ndikimesh dhe lidhjesh të drejtpërdrejta në disa sjellje kriminale. Me prostitucion janë të lidhura një mori sjelljes kriminale, si vrasjet, mashtrimet, vjedhjet, plaçkitjet, dhunimet, nxitjet dhe joshjet në veprime amorale dhe perversione tjera të rinjve dhe të miturve. Në botën bashkëkohore theksohet se me dukurinë e prostitucionit iëshhtë e lidhur ngushtë edhe marrja me shpërndarjen dhe shitblerjen e drogave dehëse, tregtia me robër të bardhë, shantazhet, kontrabanda, spiunazhi dhe veprime të tjera të ndaluara dhe kriminale. Ai rrënon moralin shoqëror, nxit ndjenja dhe veprime të ulta njerëzore, ndikon në shkatërrimin e marrëdhënieve familjare, në paragitjen e shkurorëzimeve dhe sjelljeve të tjera të clëm-shme lidhur me martesën dhe familjen. Po ashtu, prostitucioni paraqitet si faktor fuqishëm në nxitjen e sjelljeve paradelikuate dhe kriminale në shoqëri.

Në degën e së drejtës penale, prostitucioni është aktivitet i ndaluar edhe atë kjo ndodh për shumë arsye, ndër të cilat rradhiten: marrja në prostituim është në kundërshtim me rregullat morale dhe sociale të cilat janë të lidhura me dinjitetin njerëzor; ndër pasojat e prostitucionit janë bartja e sëmundjeve infektive; kur ndërprejnë punën e tyre subjektet që merren me prostitucion bëhen barrë për shoqërinë, duke u bërë kështu raste sociale; prostitucioni ka influencë në zhvillimin e drejtë të shoqërisë. Të gjitha këto bëjnë pjesë në arsyet pse shoqëria merr masa parandaluese dhe repressive në pengimin e zhvillimit të kësaj dukurie negative. Në shumë nga shtetet e botës kjo dukuri nuk është legale megjithatë, vërehet një tolerance nga shtetet përkatëse.

Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut paraqet të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, por e cila shprehimisht nuk sanksionon prostitucionin si fenomen në veçanti. Megjithatë, siç kemi përmendur edhe lart në këtë punim, prostitucioni është një fenomen i cili është i lidhur dhe shkakton pasoja të shumë anëshme në shoqërinë kur zhvillohet, prandaj në këtë mënyrë prostitucioni shkel mbi shumë nga liritë dhe të drejtat e njeriut. Prostitucioni përveç që cënon disa të drejta të mbrojtura me ligjet kombëtare ajo cënon në themel edhe liritë dhe të drejtat elementare të njeriut të cilat janë të rregulluara pikë së pari me Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut. Prandaj, në një formë indirekte ky akt mbron dhe ul mundësinë e zhvillimit të prostitucionit duke mbrojtur liritë dhe të drejtat themelore të njeriut.

Prostitucioni në Republikën e Maqedonisë së Veriut ka qënë prezent në masë më të madhe pas vitit 1991. Kjo ka ardhur si pasojë e hyrjes në procesin e tranzicionit politik i cili ka ardhur si pasojë e ndryshimit të sistemit politik. Ky ndryshim erdhi me bashkë me problematika të caktuara siç është rritja e disa fenomeneve kriminale të cilat erdhën bashkë me lirinë e zgjeruar me ardhjen e sistemit politik demokratik. Prostitucioni vazhdon të ketë rritje deri në vitin 2003 duke u bazuar në numrin e personave të akuzuar për ndërmjetësim në korrupsion. Më pas vitit 2003 vërehet një rënie e dukshme dhe ky në të njëjtën kohë shënon edhe rritjen e luftës së shtetit kundër prostitucionit. Nga këto vite prostitucioni në RMV në një masë të caktuar është vendosur nën kontroll të shtetit, megjithatë lufta kundër këtij fenomeni nuk është në nivelin e duhur sepse edhe më tej, gjatë gjithë periudhës pasardhëse gjejmë raste të kryerjes së kësaj veprimtarie.

Nga ana tjetër faktorët që ndikojnë në zhvillimin e kriminalitetit, në rastin konkret prostitucionit, janë një tregues kriminologjik me anë të së cilave duhet të organizohet veprimi i shtetit për të zvogëluar ose penguar zhvillimin e prostitucionit. Në këtë rast shteti-shoqëria,

mund të ndikojë në mënyrë direkte në uljen e kriminalitetit që buron nga prostitucioni duke aplikuar politika për rritje ekonomike dhe zhvillim ekonomik.

Shteti mund të ndikojë në uljen e kriminalitetit që buron nga prostitucioni duke aplikuar politika për rritjen e standardit jetësor, zvogëlimin e diskriminimit, rritjen e barazisë mes qytetarëve, garantimin e zbatimit të së drejtave të qytetarëve.

Konkludoj se niveli i arsimit është një nga faktorët që ndikojnë në zhvillimin e prostitucionit, megjithatë nëse e krahasojmë me faktorët e tjerë, ky është faktori i cili ndikon më pak në zhvillimin e prostitucionit. Kështu, edhe pse arsimimi ndikon në uljen e veprimtarisë së prostitucionit, përsëri ky është një faktor i cili nuk mund të mposhtë faktorët e tjerë si ato ekonomik, psikologjik dhe socio-kulturor. Gjithsesi, arsimi i shoqërisë do të ndikojë në pengimin e zhvillimit të prostitucionit pranadaj shteti duhet të promovojë në nivel më të lartë arsimimin e shoqërisë.

Në literaturën juridike kriminologjike theksohet se prostitucioni është faktor që ndikon në kryerjen e disa veprave tjera penale si: dhuna, përdorimi i mjeteve narkotike, trafikimi i mjeteve narkotike, vjedhja etj. Duke u bazuar edhe në të dhënat e anketës së realizuar konkludoj se: prostitucioni në nivel të lartë është i lidhur me ushtrimin e dhunës, përfshirë këtu dhunën fizike dhe psikologjike; përdorimi i lëndëve narkotike është fenomen dhe në të njëjtë kohë shkelje ligjore që është i lidhur me prostitucionin; krahas përdorimit edhe trafikimi i lëndëve narkotike është veprimtari kundërligjore e cila është e lidhur me prostitucionin; trafikimi i qënieve njerëzore është veprimtari e kundërligjshme e cila është e lidhur me prostitucionin; veprat penale kundër pasurisë janë të lidhura me prostitucionin në nivel më të ulët se sa veprat penale të sipër përmendura. Kështu, duke parandaluar prostitucionin ne kemi prandaluar edhe kryerjen e veprave tjera penale, pra kemi ulur nivelin e kriminalitetit.

Duke hulumtuar mbi fenomenin e prostitucionit, vjen natyrshëm nevoja për të sqaruar idenë e legalizimit të prostitucionit. Nga ana tjetër, duke e ditur se disa shoqëri e kontrollojnë prostitucionin duke e legalizuar atë dhe shumë të tjera nuk e lejojnë aspak zhvillimin e një veprimtarie të tillë, por përsëri çdo shoqëri përballlet me këtë fenomen. Si do që të trajtohet ky fenomen është e nevojshme dhe e patjetërsueshme që t'i kushtohet vëmendje dhe trajtim i veçantë për të vetmin fakt se prostitucioni ndikon në mirëqënien e përgjithshme shoqërore.

## SHTOJCA 1

Në shtojcën e këtij punimi është paraqitur përmbajtja e anketës së realizuar për mbledhjen e të dhënave që janë në interes të këtij punimi në raport me opinionin publik.

Zgjidhni gjininë tuaj:

- ☐ Gjinia mashkull
- ☐ Gjina femerore

Mosha juaj:

- ☐ 18 - 25
- ☐ 26 - 35
- ☐ 36 - 45
- ☐ > 46

Niveli juaj i edukimit

- ☐ Arsim të mesëm
- ☐ Arsim të lartë (Bachelor)
- ☐ Magjistraturë (MSc)
- ☐ Doktor shkence (PhD)
- ☐ Preferoj të mos përgjigjem

Rangoni si faktorët e mëposhtem ndikojnë në zhvillimin e prostitucionit:

|                         | Aspak                 | Mesatarisht           | Shume                 |
|-------------------------|-----------------------|-----------------------|-----------------------|
| Faktorët ekonomik       | <input type="radio"/> | <input type="radio"/> | <input type="radio"/> |
| Faktorët psikologjik    | <input type="radio"/> | <input type="radio"/> | <input type="radio"/> |
| Faktorët socio-kulturot | <input type="radio"/> | <input type="radio"/> | <input type="radio"/> |
| Niveli i arsimit        | <input type="radio"/> | <input type="radio"/> | <input type="radio"/> |



Sa eshte lidhur fenomeni i prostitucionit, me forma te tjera te kriminalitetit

|                                  | Aspak                 | Mesatarisht           | Shume                 |
|----------------------------------|-----------------------|-----------------------|-----------------------|
| Dhuna                            | <input type="radio"/> | <input type="radio"/> | <input type="radio"/> |
| Perdorimi i lendeve<br>narkotike | <input type="radio"/> | <input type="radio"/> | <input type="radio"/> |
| Trafikimi i lendeve<br>narkotike | <input type="radio"/> | <input type="radio"/> | <input type="radio"/> |
| Trafikimi me qenie<br>njerezore  | <input type="radio"/> | <input type="radio"/> | <input type="radio"/> |
| Vepra penale kunder<br>pasurise  | <input type="radio"/> | <input type="radio"/> | <input type="radio"/> |

Sa efekte negative shkakton prostitucioni ne shoqeri?

- ☐ Aspak
- ☐ Mesatarisht
- ☐ Shume

A duhet legalizuar prostitucioni?

- ☐ Po
- ☐ Jo
- ☐ Nuk preferoj te jap pergjigje

Legalizimi i prostitucionit dhe kontrolli i shtetit do te ule pasojat negative ne shoqeri?

- ☐ Po
- ☐ Jo
- ☐ Nuk preferoj te jap pergjigje

A duhet te sanksionohet me ligj edhe blerja e shembimeve te prostitucionit?

- ☐ Po
- ☐ Jo
- ☐ Nuk preferoj te jap pergjigje

Legalizimi i prostitucionit ndikon ne zhvillimin ekonomik dhe rritjen e turizmit?

- ☐ Aspak
- ☐ Mesatarisht
- ☐ Shume

Shoqeria mund ta eliminoje fenomenin e prostitucionit?

- ☐ Po
- ☐ Jo
- ☐ Nuk preferoj te jap pergjigje

Sa eshte i angazhuar shtetit ne luftimin e fenomenit te prostitucionit

- ☐ Aspak
- ☐ Mesatarisht
- ☐ Shume

Opinione tjera rreth prostitucionit?

## **BIBLIOGRAFIA**

### **Libra dhe artikuj**

- Arnaudovski, Lupco dhe Stojanovski Trpe, Tregtia me njerëz, Shkup, 2002
- Gruda, Zejnulla, Mbrojtja ndërkombëtare e të drejtave të njeriut, Prishtinë, 2010
- Halili, Ragip, Kriminologjia, botimi i shtatë, Prishtinë, 2011
- Halili, Ragip, Viktimologjia, Prishtinë, 2011
- Kambovski, Vlado, E drejta penale-pjesa e përgjithshme, Shkup, 2005
- Kambovski, Vllado, Krimi i Organizuar, Shkup, 2005
- Latifi, Vesel, Kriminalistika, zbulimi dhe të provuarit e krimit, Prishtinë, 2011
- Latifi, Vesel, Politika kriminale, Prishtinë, 2008
- Malaj, Nora & Sokoli, Lekë, “Probleme sociale bashkëkohore”, Tiranë, 2012
- Osmani, Afrim, “Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë, teksti integral, i përpunuar në gjuhën shqipe me udhëzime dhe sqarime, treguesi alfabetik”, Shkup, 2015
- Shasivari, Jeton, E drejta kushtetuese, Shkup, 2015
- Velkoska, Violeta, Pengimi i tregtisë me njerëz gjatë praktikës së gjykatave të vendit, Shkup, 2005
- Zejneli, Ismail, “E drejta penale, Pjesa e posaçme (cikël leksionesh)”, Tetovë, 2007
- Baxhaku, Fatos, Kapo, Klodiana, Gra të përgjithshme, Tiranë, 2014

### **Akte juridike**

- Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Gazeta Zyrtare nr. 52/91
- Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë së Veriut, Gazeta Zyrtare nr.80/99, 4/2002, 43/2003; 19/2004; 81/2005; 60/06; 73/06; 7/08; 139/08; 114/09; 51/11; 135/11; 185/11; 142/12; 166/12; 55/13; 82/13; 14/14; 27/14; 28/14; 115/14 и 132/14
- Ligji për procedurë penale, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nr. 150/2010
- Universal Declaration of Human Rights, United Nations General Assembly of its 183rd meeting, held in Paris on 10 December 1948

## Burime nga interneti

- [http://www.newr.bham.ac.uk/topics/Trafficking/trafficking\\_newr.htm](http://www.newr.bham.ac.uk/topics/Trafficking/trafficking_newr.htm) Network for European Women's Rights
- <http://www.ojp.usdoj.gov/> United states department of justice
- <http://www.legislationline.org/> Trafficking in Human Beings
- <http://www.usdoj.gov> United states department of justice
- “Од нас за нас”, Списание направено од сексуални работници за сексуални работници,  
[https://www.swannet.org/files/swannet/File/Documents/STAR\\_odnaszanas\\_september\\_2009.pdf](https://www.swannet.org/files/swannet/File/Documents/STAR_odnaszanas_september_2009.pdf)
- “Prostitucioni në mesjetë”, artikull online,  
[https://www.brown.edu/Departments/Italian\\_Studies/dweb/society/sex/prostitution.php](https://www.brown.edu/Departments/Italian_Studies/dweb/society/sex/prostitution.php)
- “The history of prostitution”, artikull online,  
[https://en.wikipedia.org/wiki/History\\_of\\_prostitution](https://en.wikipedia.org/wiki/History_of_prostitution)
- “The history of prostitution”, artikull online, <https://www.thoughtco.com/history-of-prostitution-721311>